

# LIGJ PËR TRANSPORT NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR

TEKST I KONSOLIDUAR <sup>1</sup>

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**  
Закон за превоз  
во патниот  
сообраќај

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe të atij ndërkombëtar.

### Neni 2

Transporti i udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor ndërkombëtar bëhet në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare që i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

Nëse me shtete të caktuara nuk është lidhur marrëveshje nga paragrafi (1) i këtij neni, transporti midis atyre shteteve dhe Republikës së Maqedonisë bëhet në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare multilaterale të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë duke e respektuar parimin e reciprocitetit.

Në procedurë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

### Neni 3

Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1. Transporti publik i udhëtarëve dhe mallit është transport i cili me kushte të njëjta u është i arritshëm të gjithë shfrytëzuesve;
2. Transporti në komunikacionin e brendshëm rrugor është çdo transport rrugor në territorin e Republikës së Maqedonisë;
3. Transporti në komunikacionin rrugor ndërkombëtar është çdo transport rrugor së paku përtej një kufiri shtetëror;
4. Licenca është dokument me të cilin lejohet kryerja e veprimtarisë - transport publik në komunikacionin, transport për nevoja personale dhe organizim për transport rrugor,

- 4-a. Ekstrakti i licencës është dokument të cilin e lëshon organi kompetent për lëshimin e licencave për çdo automjet motorik veças;
5. Transporti për nevoja vetjake është transporti të cilin personi juridik ose fizik e bën për përmbushjen e nevojave gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet gjegjësisht detyrave nga fushëveprimi i tij;
6. Transportues i vendit është personi juridik ose fizik me seli në Republikën e Maqedonisë i cili posedon licencë për kryerjen e transportit të udhëtarëve ose mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar dhe personi juridik dhe fizik me seli në Republikën e Maqedonisë i cili bën transportin e udhëtarëve ose mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar për të cilat në pajtim me dispozitat të këtij ligji nuk nevojitet licencë;
7. Transportuesi i huaj është person i huaj juridik ose fizik i cili bën transportin e udhëtarëve ose mallrave në komunikacionin rrugor ndërkombëtar dhe selia e të cilës gjendet jashtë kufijve të Republikës së Maqedonisë;
8. Marrëveshja ndërkombëtare është secila marrëveshje ndërkombëtare ose bilaterale, me të cilën rregullohet transporti ndërkombëtar dhe e cila e obligon Republikën e Maqedonisë;
9. Transporti bilateral i udhëtarëve dhe mallrave është transporti ndërkombëtar gjatë të cilit udhëtarët dhe mallrat transportohen midis territorit të Republikës së Maqedonisë dhe territorit të ndonjë shtetit të huaj;
10. Transporti transit i udhëtarëve dhe mallrave është transporti ndërkombëtar gjatë të cilit udhëtarët dhe mallrat transportohen përmes territorit të ndonjë shtetit të caktuar pa u shkarkuar paraprakisht ose ngarkuar në territorin e atij shteti;
11. Transporti i mallrave për dhe prej vendeve të treta është transporti ndërkombëtar që e bën transportuesi i cili nuk ka seli në vendin në të cilin fillon gjegjësisht mbaron transporti;
12. Kabotazh është çdo transport i udhëtarëve ose mallrave midis dy vendeve në Republikën e Maqedonisë të bërë nga ana e transportuesit të huaj;
13. Transporti i jashtëzakonshëm është transportimi i mallrave të cilat dimensionet e automjetit së bashku me mallin ose masa e përgjithshme e automjetit ose ngarkimit boshtor të tij janë më të mëdha se të përcaktuarat;
14. Linja është relacioni i caktuar dhe drejtimi i vozitjes nga stacioni i nisjes i kategorizuar i autobusëve deri në stacionin e fundit të kategorizuar të autobusëve ose stacion në të cilin transportohen udhëtarë në transportin rrugor në linjë, në pajtim me orarin e udhëtimit që më parë të përcaktuar, të regjistruar dhe shpallur dhe çmimi i transportit;
15. Relacioni është largësia midis cilave do dy vendeve të linjës, të cekur në orarin e udhëtimit si stacion ose ndalesë;
16. Orari i udhëtimit është dokument me të cilin përcaktohet linja, lloji i transportit, relacioni në të cilit bëhet transporti, radha e stacioneve dhe ndalesave, largësia midis tyre nga stacioni fillestar ose ndalesa, koha e arritjes, ndalimi dhe shkuarja në çdo stacion autobusi dhe ndalesë,

periudha gjatë së cilës transportuesi e bën transportin e linjës dhe koha e vlefshmërisë;

16-a. "Ndryshimi i orarit ekzistues të udhëtimit mund të bëhet nëse në orarin e ri të udhëtimit që propozohet bëhet vetëm ndryshimi i kohëve në stacionin fillestar, stacionet përgjatë rrugës ose stacionin e fundit dhe nëse bëhet ndryshimi i kohëve vetëm i nisjeve ekzistuese, pa u shtuar nisje të reja dhe pa u ndryshuar stacionet ose pa u shtuar stacione të reja në nisjet ekzistuese;

16-b. "Trolejbus" është mjet transporti motorik i dedikuar për transport të personave, që krahas ndenjësës së shoferit ka më shume se tetë ndenjësë dhe i cili për shkak të furnizimit të motorit me energji elektrike është i lidhur me përques elektrik;

16-v. "Tramvaj" është mjet transporti në shina me energji elektrike i dedikuar për transport të personave, i cili për shkak të furnizimit të motorit me energji elektrike është i lidhur me përques elektrik;

17. Transporti në linjë ndërkombëtare të udhëtarëve është transporti në një linjë të caktuar të cilin stacioni ose ndalesa e parë gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa e fundit në territorin e vendit të huaj, si dhe transporti në një linjë të caktuar e cila transiton nëpër vendin e huaj gjatë të cilit stacioni ose ndalesa e fundit është në Republikën e Maqedonisë;

18. Transporti në linjë ndërkombëtare të udhëtarëve është transporti publik që bëhet në linjë midis dy ose më tepër komunave, gjegjësisht midis qytetit të Shkupit dhe komunës së caktuar;

19. Transporti komunal i udhëtarëve është transporti publik që bëhet në territorin e një komune, gjegjësisht qytetin e Shkupit;

20. Transporti i lirë i udhëtarëve në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar është transporti për të cilin relacioni dhe kushtet tjera përcaktohen veçmas për secilin transport midis transportuesit dhe shfrytëzuesit të shërbimit;

21. Transporti auto - taksi i udhëtarëve është transporti që bëhet me vetura udhëtarësh me më së paku shtatë karrige duke llogaritur edhe karrigen e vozitësit;

21-a. Përzulimi i ekstraktit të licencës për kryerje të transportit auto taksi të udhëtarëve është periudhë kohore në të cilën transportuesi autotaksi nuk guxon të kryejë transport autotaksi të udhëtarëve me automjet të caktuar, për shkak të defektit, aksidentit në komunikacion, nevojës për punësimin e vozitësit e ngjashëm.

21-b. Certifikata për ngasës auto taksie është certifikatë që merret sipas nenit 8-s të këtij ligji e të cilën shoferi i auto taksisë detyrimisht duhet ta ketë në automjet gjatë kryerjes së transportit të auto taksisë.

22. Itinerari shënon një drejtim të caktuar të lëvizjes së mjetit transportues në linjë të caktuar;

23. Transporti i udhëtarëve është transporti i udhëtarëve të cilin udhëtarët në pajtim me orarin e udhëtimit hipin dhe zbresin në të gjitha stacionet e autobusëve dhe ndalesat;

24. Transporti i shpejtë është transporti i udhëtarëve të cilin udhëtarët në pajtim me orarin e udhëtimit hipin dhe zbresin në stacionet e autobusëve;

25. Transporti direkt është transporti i udhëtarëve të cilin udhëtarët në pajtim me orarin e udhëtimit hipin vetëm në stacionin e parë dhe zbresin vetëm në stacionin e fundit të autobusëve;

26. Stacioni i autobusëve është sipërfaqja e caktuar për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve dhe udhëtarëve, e cila duhet të ketë peronë të mbuluar, të rregulluar për hipje dhe zbritje të sigurt të udhëtarëve, lokale për qëndrim të udhëtarëve dhe të personelit vozitës, për ruajtjen e bagazhit, sanitarit, biro komunikacioni dhe me pajisje të veçanta sipas rregullave të përcaktuara;

27. Ndalesa e autobusëve është hapësira e caktuar për ndalesë autobusësh në pajtim me orarin e udhëtimit dhe për hipje të sigurt gjegjësisht zbritjen e udhëtarëve;

28. Terminali i autobusëve është hapësira e rregulluar e dedikuar për transferimin e udhëtarëve në transportin komunal të udhëtarëve dhe shërben për kthimin e automjeteve për shkak të ndërrimit të kahjes së lëvizjes;

29. Vendqarkimi i autobusit është hapësira e rregulluar në pikat e fundit (termikus) në linjat e transportit komunal të dedikuar për hipje dhe zbritje të udhëtarëve dhe shërben për kthimin e automjeteve për shkak të ndërrimit të kahjes së lëvizjes;

30. *E fshirë* 2

31. *E fshirë*

32. Taksi stacioni është hapësira e rregulluar e dedikuar për parkimin e taksi automjeteve për udhëtarë të cilët presin thirrje për vozitje;

33. Automjeti i huaj është automjeti me të cilin bëhet transporti në komunikacionin rrugor, i cili nuk është i regjistruar në Republikën e Maqedonisë;

34. Automjeti i vendit është automjeti me të cilin bëhet transporti në komunikacionin rrugor, dhe është i regjistruar në territorin e Republikës së Maqedonisë;

35. Leja për transport është emri i përbashkët për më shumë lloje të dokumenteve të përcaktuara me këtë ligj ose marrëveshje ndërkombëtare, me të cilin automjetit me regjistrim të huaj i lejohet qasje në rrugët maqedonase dhe vozitje nëpër to, gjegjësisht veturës me regjistrim maqedonas qasje në rrugët e vendit, organi i cili e ka dhënë lejen dhe vozitjen nëpër to;

36. Leje e Konferencës Evropiane e Ministrave të Transportit (KEMT) është leje multilaterale për kryerjen e transportit ndërkombëtar të mallrave në komunikacionin rrugor në territorin e shteteve anëtare të KEMT, me automjete të regjistruara në njërin nga shtetet anëtare të KEMT;

37. Fletudhëtimi është dokument i cili e shfrytëzon transportuesi gjatë kryerjes së transportit publik të udhëtarëve në transportin e lirë ndërkombëtar të udhëtarëve;

38. Fletëngarkesë është dokument i cili e përcjell transportin dhe përmban të dhëna për: firmën përkatësisht emrin dhe selinë e transportuesit, të dërguesit dhe të pranuesit të mallrave, vendin e ngarkimit dhe shkarkimit, emrin e mallit, kategorizimin dhe sasinë e tij, numrin e targës së automjetit, vërejtjet dhe udhëzimet e veçanta për transportuesin, kurse

përdoret gjatë kryerjes së transportit të mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar;

39. Urdhëruhetimi është dokument që përmban të dhëna për llojin e transportit, firmën gjegjësisht emrin dhe selinë e transportuesit, emrin dhe mbiemrin e vozitësit, të dhënat kryesore për kahjen e vozitjes, numrin e regjistrimit të automjetit, gjendjen e matësit në fillim dhe në fund të vozitjes dhe nënshkrimin e personit të autorizuar që e ka lëshuar urdhëresën.

40. Fletëlargësi është dokument me të cilin caktohet largësia ndërmjet stacioneve të autobusëve, përkatësisht vendqëndrimeve të autobusëve i lëshuar nga organi kompetent shtetëror për rrugë dhe shfrytëzohet gjatë lejimit të linjave të vozitjes për transport linjash të udhëtarëve;

41. Udhëtar është personi të cilin transportuesi për çmim të caktuar e transporton me automjet për transport në komunikacionin rrugor;

41-a. Biletë udhëtimi është dokumenti i lëshuar si llogari fiskale me relacion të theksuar ose biletë në formë të letrës me llogari fiskale me shtojcë të llogarisë fiskale ose në formë elektronike nga transportuesi për shërbimet transportuese, me të cilën udhëtari dëshmon se e ka paguar shërbimin transportues.

41-b. Mos mbajtje e linjës nënkuptohet nëse transportuesi nisjet, stacionet përgjatë rrugës dhe mbërritjet e definuara në orarin e udhëtimit, nuk i mban me hipje dhe zbritje të udhëtarëve nga stacionet e autobusit, përkatësisht mos mbajtje të linjës edhe kur transporti nuk kryhet edhe në njërin prej stacioneve të orarit të udhëtimit.

41-v) Organi për vlerësim të kompetencës së personit juridik nga neni 69 paragrafi 4 të këtij ligji është Instituti për Akreditim.

42. Transport i veçantë i linjës është transporti vetëm për një grup të caktuar udhëtarësh dhe i përjashton udhëtarët tjerë;

43. Transport i ndryshueshëm i udhëtarëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar është transporti i grupeve të udhëtarëve të organizuara më parë për më tepër udhëtime nga i njëjti vend i nisjes deri në vendin e njëjtë të arritjes, me ç'rast çdo grup i udhëtarëve që e kanë përfunduar udhëtimin në shkuarje, kthehet në vendin e nisjes me një vozitje të mëvonshme në përbërje të njëjtë sipas orareve nga cikli i udhëtimeve. Vozitja e parë gjatë nisjes dhe vozitja e fundit në shkuarje kryhet me automjet të zbrazët;

44. Komplet automjetesh me automjete me lidhje të ndërsjellë së paku prej një automjeti tërheqës dhe një rimorkioje të cilët në komunikacionin rrugor marrin pjesë si tërësi;

45. Masë më e madhe e lejuar, është masa e automjetit së bashku me bartjen e tij dhe

46. Vozitje bis është transporti në linjë të caktuar në komunikacionin rrugor ndërkomunal dhe ndërkombëtar i cili kryhet me më shumë automjete, në të cilët është theksuar mbishkrimi "vojitje bis" me theksimin e numrit dhe të orarit të autobusëve me numra romakë.

## II. KUSHTET PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR

## Neni 4

Transportuesi i vendit mund të kryejë transport të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar në bazë të licencës.

Licenca për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor ndërkombëtar lëshohet edhe në njërën nga gjuhët botërore.

Harxhimet e krijuara në lidhje me lëshimin e licencës dhe dokumentacionit tjetër të duhur për kryerjen e transportit në komunikacionin rrugor i bart transportuesi.

### Neni 4-a

Ekstrakti i licencës të cilin e jep organi kompetent për lëshimin e licencave për çdo automjet motorike veças përmban të dhëna për: organin që ia lëshon licencën, transportuesin, numri unik amë i subjektit-transportuesit, numrin e licencës dhe afatin e përdorimit, numrin e regjistrimit, numrin e shasisë dhe llojin e automjetit, llojin e transportit që mund të kryhet me automjetin në pajtim me licencën e lëshuar, datën e lëshimit dhe me nënshkrimin dhe vulën e personit të autorizuar.

## Neni 5

Grumbullimin dhe testimin e gjakut dhe komponentëve të gjakut, pa marrë parasysh synimin e tyre, si dhe përgatitjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e tyre me synim të transfuzionit dhe sigurisë së përcjelljes e bën Instituti i mjekësisë për transfuzion i Republikës së Maqedonisë, si institucion shëndetësor publik (në tekstin e mëtejme: institucioni i mjekësisë për transfuzion).

Për kompetencat, përbërjen, mënyrën e zgjedhjes gjegjësisht emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të këshillit drejtues, gjegjësisht të organit punëdrejtues, si dhe të kushteve më të afërta në raport me hapësirën, kuadrin dhe pajisjen të cilat duhet t'i plotësojë institucioni i mjekësisë për transfuzion, zbatohen dispozitat e mbrojtjes shëndetësore.

Vërtetimin për plotësimin e kushteve të veçanta teknike-eksploatuese për automjetet me të cilat kryhen lloje të veçanta të transportit në komunikacionin rrugor e lëshon shërbimi i autorizuar teknik për lejim individual të automjeteve për kategori të automjeteve në pajtim me Ligjin për automjete ose shërbimi i autorizuar teknik për lëshimin e certifikatave EKMT në pajtim me këtë ligj.

Gjatë kontrollit të automjeteve shërbimi i autorizuar teknik nga paragrafi 3 të këtij neni për secilin automjet të kontrolluar lëshon edhe vërtetim për standardet ekologjike të automjetit.

Personi juridik nga paragrafi 3 i këtij neni, është i detyruar që kontrollin ta bëjë në mënyrë profesionale dhe tërësisht në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, për çfarë arkëton kompensim.

Lartësinë e kompensimit për kontrollin e kryer për plotësimin e kushteve të veçanta teknike-eksploatuese për automjetet sipas klasës përkatësisht euro standardit e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Automjeteve që i përmbushin kushtet e veçanta teknike - eksploatuese, personi juridik nga paragrafi 3 i këtij neni u lëshon vërtetim.

Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit nga paragrafi 5 i këtij neni, e përcakton ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve.

## Neni 6

Gjatë kryerjes së transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar, transportuesi është i obliguar që në automjet të ketë:

- ekstrakt të licencës,
- leje për kryerje të transportit në komunikacionin rrugor, nëse kjo kërkohet në pajtim me ligjin, marrëveshje ndërkombëtare ose marrëveshje për transport të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor, të lidhur ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe vendit deri në, prej ose nëpër territorin e të cilit kryhet transporti.
- certifikatë për pjesëmarrjen e vozitësit në komunikacionin rrugor ndërkombëtar, dhe
- fletudhëtimi të plotësuar në mënyrë të rregullt.

Gjatë kryerjes së transportit autotaksi shoferi në automjet është i obliguar që në automjet të ketë certifikatë për shofer autotaksi.

Dispozitat nga paragrafi 1 alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij neni nuk kanë të bëjnë për transportin me autotaksi, për kryerje të transportit me automjete nga neni 7 paragrafi 2 të këtij ligji, me përjashtim të transportit për nevoja personale që kryhet me automjete fuqia më e madhe bartëse e të cilave nuk i tejkalon 3.500 kg duke e përfshirë edhe rimorkion.

Dispozita nga paragrafi 1 alineja 3 nuk ka të bëjë me kryerjen e transportit në komunikacionin e brendshëm rrugor.

Për urdhëruhdhëtimet e lëshuara, transportuesi doemos mban evidencë dhe të njëjtat është i obliguar t'i ruajë më së paku një vit.

Formën dhe përmbajtjen e urdhëruhdhëtimit e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## Neni 7

Për kryerjen e llojeve të caktuara të transportit në komunikacionin rrugor lëshohen këto lloje licencash:

1) në komunikacionin e brendshëm rrugor për:

- transport në linjë komunale të udhëtarëve, gjegjësisht për transportin e udhëtarëve në linjë për qytetin e Shkupit,
- transport në linjë ndërkomunale të udhëtarëve,
- transport i lirë i udhëtarëve dhe transport i linjës së veçantë të udhëtarëve,
- transport të udhëtarëve për nevoja personale,
- auto - taksi transport të udhëtarëve,
- transport publik të mallrave, dhe
- transport të mallrave për nevoja personale.

2) në komunikacionin ndërkombëtar rrugor për:

- transport në linjë ndërkombëtare të udhëtarëve,
- transport të lirë ndërkombëtar të udhëtarëve,
- transport ndërkombëtar të udhëtarëve për nevoja personale,
- transport publik ndërkombëtar të mallrave, dhe
- transport ndërkombëtar të mallrave për nevoja personale.

3) licencë për organizimin e transportit të mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar

Licenca nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është e nevojshme nëse bëhet fjalë për kryerjen e transportit me automjete të dedikuara për nevojat e sigurisë publike, mbrojtjen dhe nevojave të organeve shtetërore, për transport me automjete postale ose të veturave për intervenime, për transport medicinal ose humanitar, për transport të nevojave personale të cilat i bëjnë personat juridikë dhe fizikë që i bëjnë me automjete të cilat bartja më e madhe nuk tejkalon 3.500 kg duke e përfshirë edhe rimorkion përkatësisht automjete me më së shumti tetë ulëse duke llogaritur edhe ulësen e shoferit dhe për transport me automjete speciale, të cilat në mënyrë plotësuese janë adaptuar për dedikim të veçantë dhe me ato nuk mund të bëhet transport si me automjetet standarde dhe shërbejnë për transport të nevojave personale (biblioteka lëvizëse, kantina lëvizëse, punëtorja, objekte lëvizëse për fjetje dhe ngjashëm) dhe për transport të udhëtarëve në linja komunale me tramvaj, trolejbus ose mjete tjera transporti në shina që kryhet përmes marrëveshjes për vendosjen e koncesionit ose partneritetit privat publik.

Të gjitha kushtet tjera të përcaktuara me këtë ligj për kryerjen e transportit të mallrave në komunikacionin rrugor (fletudhëtimi, certifikata për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor, vërtetimi për plotësimin e kushteve të veçanta teknike eksploatuese etj.) janë të obliguara që t'i plotësojnë edhe automjetet për të cilat nuk nevojitet ekstrakti i licencës për kryerjen e transportit për nevoja personale.

Formën dhe përmbajtjen e licencës nga paragrafi 1 të këtij neni dhe ekstrakt të licencës për çdo automjet nga neni 4-a i këtij ligji e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## Neni 8

Licencë nga neni 7 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji mund të marrë person juridik ose fizik i vendit (në tekstin e mëtejme: transportues), nëse i plotëson këto kushte:

1. të jetë i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe të ketë të regjistruar veprimtari/kryesore prioritare, shifër të të hyrave kryerje të transportit të udhëtarëve dhe mallit në komunikacionin rrugor;

2. të jetë pronar i një ose më shumë automjeteve të regjistruara për transport ose të ketë marrëveshje për lizing, që i plotësojnë kushtet e veçanta teknike - të eksploatimit të përcaktuara për automjete për kryerje të llojeve të veçanta të transportit në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe/ose ndërkombëtar, me ç'rast për transport të linjave ndërkomunale ose ndërkombëtare të udhëtarëve të jetë pronar ose të ketë marrëveshje për lizing për së paku dy automjete me kapacitet prej së paku 22 karrige për

automjet, për transport të linjave komunale të udhëtarëve të jetë pronar i dy ose më shumë automjeteve të regjistruara ose të ketë marrëveshje për lizing për automjete me së paku 8+1 karrige, për transport të linjave të udhëtarëve në qytetin e Shkupit të jetë pronar i një ose më shumë automjeteve të regjistruara me së paku 8+1 karrige, ndërsa për transport të lirë dhe transport të veçantë të linjave të udhëtarëve të jetë pronar ose të ketë marrëveshje për lizing për së paku një automjet me kapacitet me së paku 8+1 karrige në automjet, i cili i plotëson kushtet e veçanta teknike-të eksploatimit të përcaktuara për automjete për kryerje të llojeve të veçanta të transportit;

3. të ketë të punësuar në marrëdhënie të rregullt të punës përkatësisht



shofer në varësi nga numri i automjeteve, minimum një shofer për automjet (autobus, automjet ngarkues) i cili i plotëson kushtet të përcaktuara me rregullat për siguri të komunikacionit në rrugë;

4. të ketë të punësuar auto - taksi shofer në varësi nga numri i automjeteve të cilat i posedon minimum një shofer për automjet, dhe të njëjtat të posedojnë certifikatë ndërkombëtare për njohje të gjuhës angleze në nivel A1 ose A2 sipas Kornizës së përbashkët referente evropiane për gjuhë (CERF) të Këshillit të Evropës;

5. në automjetin me të cilin bëhet transport auto-taksi i udhëtarëve të ketë të vendosur aparat fiskal dhe

6. drejtuesi ose personi i autorizuar përgjegjës për transport të ketë certifikatë për kompetencë profesionale;

7. të ketë gjendje solide financiare;

8. të ketë reputacion të mirë;

9. për kryerje të transporti ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallit të ketë të punësuar shoferë të cilët kanë certifikatë për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transport ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.

Licencë për transport të linjës ndërkombëtare të udhëtarëve dhe licencë për transport të linjave ndërkombëtare të udhëtarëve jepet vetëm për transportues të cilët posedojnë automjete me minimum Euro 2 standard ekologjik.

Dispozitat nga paragrafi 1 pika 6, të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për kryerje të taksi transportit të udhëtarëve për tregtar individual.

Dispozitat nga paragrafi 1 pika 7 të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për kryerje të transportit në komunikacionin e brendshëm rrugor.

Dispozitat nga paragrafi 1 pikat 1 dhe 7 të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për transport të udhëtarëve dhe mallit për nevoja personale në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Transportuesi parashtron kërkesë për marrje të licencës (të re ose të vazhduar) te Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ose te kryetari i komunës ose te kryetari i qytetit të Shkupit.

Dëshmitë dhe të dhënat për plotësim të kushteve nga paragrafi (1) pikat 1), 2), 3), 6), 7), 8) dhe 9) të këtij neni, i grumbullon personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve i cili e mban procedurën për dhënie të licencës është e obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

Dëshmitë dhe të dhënat për plotësim të kushteve nga paragrafi (1) pika 1, 4, 5 dhe 8 të këtij neni, i grumbullon personi i autorizuar zyrtar nga komuna, përkatësisht komuna e Shkupit si organ kompetent për dhënie të licencës për transportues komunal të udhëtarëve dhe taksi transport të udhëtarëve i cili është i obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik i cili është i obliguar dëshmitë të kërkuara nga paragrafët (7) dhe (8) të këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Personi i autorizuar zyrtar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, komuna, përkatësisht Qyteti i Shkupit është i obliguar të vendosë për kërkesën për licencë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Nëse transportuesi nuk i plotëson kushtet për marrje të licencës, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve përkatësisht kryetari i komunës përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit do të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa do të jetë e refuzuar.

Kundër aktvendimit të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve me të cilin kërkesa për dhënie të licencës refuzohet mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Komisionit Shtetëror për Vendosije në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve të Punës në Shkallë të Dytë.

Kundër aktvendimit të kryetarit të komunës përkatësisht kundër aktvendimit të kryetarit të Qytetit të Shkupit me të cilin kërkesa për dhënie të licencës refuzohet mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Komuna dhe qyteti i Shkupit nëse posedon në pronësi automjetet për transport të udhëtarëve me më shumë se 8+1 karrige për kryerje të transportit duhet të posedojë licencë.

Organizim të transportit mund të kryejë edhe personi juridik i cili posedon licencë për organizim të transportit, i cili në emër të tij, ndërsa për llogari të shfrytëzuesit të transportit lidh marrëveshje për transport me transportuesin dhe i cili nuk posedon automjetet me certifikata nga licenca në pajtim me këtë ligj. Organizuesi i transportit nuk mund të marrë pjesë në tenderë dhe furnizime publike dhe i njëjti nuk mund të jetë bartës i marrëveshjeve për transport të udhëtarëve ose të mallit.

Licencë për organizim të transportit të mallit në komunikacion rrugorë të brendshëm ose ndërkombëtar mund të marrë personi juridik ose fizik i cili ka regjistruar shifër të veprimtarisë, veprimtari përcjellëse në transport dhe i cili ka regjistruar kryegjë dhe rezerva nga minimum 100.000 euro në kundërvlerë me denarë në bilencin e gjendjes nga viti paraprak dhe/ose kryegjë e regjistruar për shoqërinë e re tregtare, përkatësisht garanci të dhënë nga banka ose nga shoqëria tregtare për sigurim të gjendjes financiare.

Dispozitat nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 10 të këtij neni nuk kanë të bëjnë për marrje të licencës për organizim të transportit të mallit në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## **Neni 8-a**

Certifikatën nga neni 8 paragrafi 1 pika 6 e këtij ligji, e lëshon Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve, në bazë të vërtetimit për provim të dhënë për kompetencë profesionale.

Aftësimin profesional të kandidatëve për fitimin e certifikatës për kompetencë profesionale të drejtuesit ose personit të autorizuar përgjegjës për transport e bën personi juridik i autorizuar nga ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve i cili ka në dispozicion:

- minimum 30 m<sup>2</sup> lokal të pajisur për realizimin e trajnimit,
- teknologji informatike dhe pajisje tjetër për mbajtje të evidencës, dhe
- minimum tre persona të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me arsim të lartë (fakultet ekonomik, të komunikacionit ose juridik), më së paku tre vjet pune në profesion në sferën e transportit që posedojnë certifikatë për trajnues për kompetencë profesionale të lëshuar nga

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, pas provimit të dhënë paraprakisht për trajnues për kompetencë profesionale në bazë të programit.

Provimi për marrjen e certifikatës nga paragrafi 1 të këtij neni jepet para Komisionit për dhënien e provimit për kompetencë profesionale (në tekstin e mëtejme: Komisioni) i formuar nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Komisioni nga paragrafi 3 i këtij neni përbëhet prej pesë anëtarësh, prej të cilëve tre anëtarë janë të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe dy anëtarë të formave të ndryshme të bashkimit të transportuesve.

Anëtarët e komisionit për punën e tyre marrin kompensim.

Provimi jepet në sesionin e provimeve që zbatohet çdo muaj.

Kandidatëve të cilët e kanë dhënë provimin u jepet vërtetim për provim të dhënë për kompetencë profesionale.

Për dhënien e provimit për kompetencë profesionale paguhet kompensim.

Lartësia e kompensimit duhet të jetë në kuadër të shpenzimeve të bëra për: trajnim, literaturë, materialin e shpenzuar, shpenzimet e komisionit për dhënien e provimit etj. Listën e shpenzimeve e përcakton personi juridik nga paragrafi 2 i këtij neni, me pëlqim paraprak të ministrit të Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Ministri i Transportit dhe Lidhjeve mban evidencën e personave që e kanë dhënë provimin për marrjen e certifikatës për kompetencë profesionale.

Mënyrën, procedurën dhe programin për dhënien e provimit për fitim të certifikatës për kompetencë profesionale të drejtuesit ose personit të autorizuar prej tij, përgjegjës për transport, formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për provim të dhënë dhe të certifikatës për kompetencë profesionale e përcakton ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve.

## **Neni 8-b**

Certifikatën nga neni 8 paragrafi 1 pika 10 e këtij ligji e lëshon Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve, në bazë të kopjes nga patenta valide e shoferit e vlefshme dhe vërtetimit për provim të dhënë për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor.

Certifikatën për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave e përpunon person juridik i zgjedhur nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve me furnizim publik, ndërsa shpenzimet për përpunimin e certifikatës janë në ngarkim të parashtruesit të kërkesës.

Lartësinë e kompensimit për përpunimin e certifikatës e përcakton personi juridik me pëlqim paraprak të ministrit të Transportit dhe Lidhjeve.

Certifikatën për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave lëshohet me afat vlefshmërie prej pesë vitesh dhe e njëjta vazhdohet para kalimit të afatit të vlefshmërisë në bazë të vërtetimit për provimin e dhënë për pjesëmarrje të vozitësve në komunikacion rrugor ndërkombëtar.

Aftësimin profesional të shoferëve për fitimin e certifikatës për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave e bën personi juridik i autorizuar nga ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve i cili ka në

dispozicion:

- minimum 30 m2 lokal të pajisur për realizimin e trajnimit,
- teknologji informatike dhe pajisje për mbajtje të evidencës, dhe
- minimum tre persona të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me arsim të lartë (fakultet ekonomik, të komunikacionit ose juridik), më së paku tre vjet pune në profesion në sferën e transportit që posedojnë certifikatë për trajnues për pjesëmarrje të shoferëve në transport ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve pas provimit të dhënë paraprakisht për trajnues për kompetencë profesionale në bazë të programit.

Provimi për marrjen e certifikatës nga paragrafi 1 të këtij neni, jepet para Komisionit për dhënien e provimit certifikatë për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave (në tekstin e mëtejme: Komisioni) i formuar nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve. <sup>3</sup>

Komisioni nga paragrafi 3 i këtij neni përbëhet prej pesë anëtarësh prej të cilëve tre anëtarë janë të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe dy anëtarë të formave të ndryshmet të bashkimit të transportuesve.

Provimi për marrjen e certifikatës nga paragrafi 1 jepet në sesionin pyetës e cila zbatohet çdo muaj.

Anëtarët e komisionit për punën e tyre marrin kompensim.

Kandidatëve të cilët e kanë dhënë provimin për fitimin e certifikatë për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave u jepet vërtetim.

Kandidatët për dhënien e provimit paguajnë kompensim.

Lartësia e kompensimit duhet të jetë në kuadër të shpenzimeve të bëra për trajnim: literaturë, materialin e shpenzuar, shpenzimet e komisionit për dhënien e provimit etj. Listën e shpenzimeve e përcakton personi juridik nga paragrafi 2 i këtij neni, me pëlqim paraprak të ministrit të Transportit dhe Lidhjeve.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mban evidencën e personave që e kanë dhënë provimin për marrjen e certifikatës për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.

Mënyrën, procedurën dhe programin për dhënien e provimit për fitim të certifikatë për kompetencë profesionale të shoferit për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për provim të dhënë dhe të certifikatës e përcakton ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve.

## Neni 8-v

### Gjendje solide financiare

Gjendje financiare solide në pajtim me këtë ligj ka transportuesi i cili ka kapital dhe rezerva në lartësi prej së paku 9 000 eurosh në kundërvlerë me denarë për automjetin e parë dhe nga 5.000 euro në kundërvlerë me denarë për çdo automjet të ardhshëm.

Gjendja financiare dëshmohet në bazë të njërit prej dokumenteve në vijim:

- të dhënat e regjistruara për kryegjë dhe rezervat në bilancin e gjendjes

për vitin paraprak ose

- garanci të lëshuar nga banka apo shoqëri sigurimesh me afat të vlefshmërisë identik afatin e vlefshmërisë së licencës ose
- vërtetimit nga banka për mjetet e depozituara monetare të afatizuara në afat i cili është në përputhje me afatin e vlefshmërisë së licencës, në shumën e dhënë në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe garancisë së automjeteve nën lizing të cilat nuk janë mjete bazë në firmë.

Dispozitat nga paragrafi 2 alineja 1 e këtij neni nuk kane të bëjnë me shoqëri tregtare të sapothemeluar për vitin e pare të themelimit, përkatësisht para afatit të përcaktuar ligjor për përpilim të llogarisë përfundimtare.

Transportuesi i cili gjendjen e vet financiare e dëshmon me të dhëna të regjistruara për kryegjënë <sup>4</sup> dhe rezervat në bilancin e gjendjes për vitin paraprak, në periudhën e vlefshmërisë së licencës është i obliguar që në afat prej gjashtë muajsh pas afatit të dorëzimit të bilancit të gjendjes te organi kompetent, ta korrigjojë gjendjen e kontos "kapitali i regjistruar dhe rezerva" nëse ka zvogëlim të vlerës në raport me vlerën nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **Autoriteti i mirë**

### **Neni 8-g**

Prestigj të mirë në pajtim me këtë ligj doemos duhet të këtë personi juridik dhe personi përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personi fizik i cili dëshiron të kryejë transport në komunikacionin rrugor.

Prestigj të mirë në pajtim me këtë ligj nuk kanë personat juridikë apo fizikë dhe personi përgjegjës në personin juridik nëse kundër tij është kumtuar:

- aktgjykim i plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale kundër pronës, ekonomisë dhe nga sfera e sigurisë në komunikacionin publik me dënim me burg prej një vit deri në dhjetë vjet, gjatë vuajtjes së dënimit dhe
- mase kundërvajtëse e sigurisë - ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës me dënim prej një vit deri në dhjetë vjet, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit.

Person i ri juridik i regjistruar është personi juridik që është i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, jo më shumë se gjashtë muaj dhe nuk është i obliguar që ta dëshmojë obligimin për prestigj të mirë.

### **Neni 8-d**

Certifikatën nga neni 8-a paragrafi 2 alineja 3 dhe neni 8-b paragrafi 3 alineja 3 të këtij ligji, e lëshon Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Programin për dhënien e provimeve dhe procedurën për marrjen e certifikatave nga paragrafi 1 i këtij neni, i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 8-gj**

Provimet nga nenet 8-a, 8-b dhe 8-z të këtij ligji, jepen në lokal për dhënien e provimit, të pajisur në mënyrë të veçantë për dhënien e provimit profesional me pajisje materiale-teknike dhe informatike, internet lidhje dhe pajisje për incizimin e dhënies së provimit.

Dhënia e provimit incizohet dhe drejtpërdrejt emitohet në ueb faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi nga i gjithë provimi vendoset në ueb faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Kriteret në lidhje me kushtet hapësinore dhe pajisjen materiale-teknike dhe informatike të hapësirave për dhënien e provimit i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve e krijon sistemin unik elektronik për dhënie të provimeve nga nenet 8-a, 8-b dhe 8-z të këtij ligji, më së voni deri në ditën e zbatimit të këtij ligji.

## **Neni 8-e**

Bazat e pyetjeve i përgatisin persona të autorizuar juridik nga nenet 8-a paragrafi 2 dhe 8-b paragrafi 3 nga ky ligj.

Pyetjet për provimin i verifikon Ministria e Transportit dhe Lidhjeve për çka formon Komision për verifikim të përbërë nga anëtarë nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (në tekstin e më poshtëm Komisioni). Komisioni kryen revizion dhe azhurnim të pyetjeve më së paku dy herë në vit, me ç'rast Komisioni vendos më së paku 30% nga pyetjet që të jenë të ndryshuara ose tërësisht të larguara nga bazat nga paragrafi 1 të këtij neni.

Dhënia e provimeve kryhet me përgjigjen me numër të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik të kompjuterit.

Pyetjet përmbajtur në testin për dhënien e provimit dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin elektronik për dhënien e provimit.

Sistem elektronik përmban edhe baza publikisht të arritshme më së paku 500 pyetje nga sfera.

Rezultatet nga dhënia e provimit i janë të arritshme kandidatit në kompjuter në të cilin e ka dhënë provimin menjëherë pas përfundimit të tij.

Në ditën e dhënies së provimit i jepet kandidatit kodi i qasjes, përkatësisht fjalëkalimi me të cilin i lejohet qasja në sistemin elektronik.

Pas lejimit të qasjes kandidati merr test elektronik për provimin.

Në rast të pengesës së zbatimit të provimit, për shkaqe që shpien në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik, dhënia e provimit ndërpritet.

Nëse shkaqet nga paragrafi 9 i këtij neni do të mënjanoen në afat prej 60 minutash nga ndërprerja e provimit ky vazhdon menjëherë pas mënjanimi të tyre.

Nëse shkaqet nga paragrafi 9 i këtij neni nuk mënjanoen në afat nga paragrafi 10 i këtij neni provimi caktohet për ndonjë termin tjetër.

Kandidatit gjatë kohës së dhënies së provimit nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatët apo personat tjerë, përveç me informatikanin në rast se ka problem teknik me kompjuterin. Kandidatit gjatë kohës së dhënies së provimit nuk i lejohet shfrytëzimi i ligjeve, akteve nënligjore apo materialeve tjera të shkruara, telefonit mobil apo pajisjeve tjera bartëse

kompjuterike dhe mjetet tjera teknike dhe informatike, lëndët e përgatitura paraprakisht dhe ngjashëm.

Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanohen në këtë afat provimi vetëm për atë kandidat ndërpritet dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tre ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

Nëse ka probleme me më tepër se pesë kompjuterë dhe këto nuk mënjanohen në afat prej pesë minutash provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tre ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

Nëse kandidati gjatë dhënies së provimit vepron në kundërshtim me paragrafin 12 të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënia e mëtejshme e provimit në atë sesion të provimit dhe i shqiptohet ndalim për dhënie të provimit në kohëzgjatje prej tre vitesh, për çka Ministria e Transportit dhe Lidhjeve miraton aktvendim kundër të cilit mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në rastet nga paragrafi 15 i këtij neni konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin dhe këtë e konstaton në procesverbalin për dhënie të provimit.

Me kërkesë të kandidatit Ministria e informon për gabimet e bëra në testin për dhënie të provimit, me mundësimin e shikimit të drejtpërdrejtë në testin.

## **Neni 8-zh**

Testet përdoren dhe i jepen kandidatit vetëm gjatë kohës së dhënies së provimit.

Materialet nga provimet e mbajtura, në veçanti versionet në letër dhe specimenet për kontrollin e saktësisë së përgjigjeve, si dhe incizimet nga provimi i mbajtur ruhen në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, formon Komision për revizionin e provimeve të mbajtura, i cili gjatë punës së vet përdor materiale nga paragrafi 2 të këtij neni dhe në të cilin, përveç anëtarëve tjerë, anëtar është edhe përfaqësuesi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe informaticienti nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, i përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Komisioni nga paragrafi 3 i këtij neni mblidhet pas çdo sesioni të katërt të provimit të mbajtur dhe kryen revizion të zbatimit të provimit duke përfshirë nëse edhe provimin e kanë dhënë kandidatët që i përmbushin kushtet për dhënie të provimit në pajtim me nenet 8-a dhe 8-b të këtij ligji, për çka dorëzon raport te Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Anëtarëve të komisionit nga paragrafi 3 i këtij neni u takon kompensim në para, që arrin një neto rrogë mesatare në Republikën e Maqedonisë në nivel vjetor, për çka Ministria e Transportit dhe Lidhjeve miraton aktvendim.

Nëse Komisioni konstaton parregullsi gjatë realizimit të provimit nga individë, propozon heqjen e vërtetimit për provim të dhënë.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve miraton aktvendim për heqjen e vërtetimit në bazë të propozimit të Komisionit në afat prej tri ditësh nga

pranimi i propozimit.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 7 të këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

### **Neni 8-z**

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e realizimit të provimeve profesionale i kryen Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, për çka ministri i Transportit dhe Lidhjeve cakton person përgjegjës që përcakton nëse kandidati i përmbush kushtet për dhënie të provimit ndërsa provimin teknikisht e realizon personi juridik i regjistruar në Regjistrin qendror dhe i zgjedhur nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Personit përgjegjës nga paragrafi 1 i këtij neni për çdo sesion të provimit të mbajtur i takon kompensimi në para, në shumë sa një e treta e neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Ministria e Transportit dhe Lidhjeve miraton aktvendim.

Personi i autorizuar juridik që teknikisht e zbaton provimin detyrohet ta bllokojë shtrirjen e radio frekuencave në lokalin për dhënie të provimit gjatë kohës së zbatimit të provimit.

Agjencia për Komunikime Elektronike (në tekstin e mëtejshëm AKE) kryen mbikëqyrje të vazhdueshme të bllokimit të shtrirjes së radio frekuencave në lokalin për dhënie të provimit, me qëllim të parandalohet çdo lloj i komunikimit elektronik me rrethinën jashtë lokalit për dhënie të provimit.

AKE-ja në lokalin për dhënie të provimit instalon pajisje matëse që siguron regjistrim elektronik nga matjet e kryera në kohëzgjatje prej 30 ditësh, dhe këto depozitohen në sistemin kontrollues qendror të AKE-së.

AKE-ja formon komision prej tre anëtarëve që harton raport në bazë të regjistrimit elektronik të depozituara në sistemin kontrollues qendror të AKE-së dhe këtë e dorëzon te organi i Ministria e Drejtësisë më së voni në afat prej 15 ditësh nga përfundimi i sesionit të provimit

### **Neni 8-x**

Certifikatën nga neni 8 paragrafi 1 pika 4 të këtij ligji e japin komunat ose Qyteti i Shkupi në bazë të vërtetimi për provim të dhënë për shofer autotaksi.

Aftësimin profesional të kandidatëve për marrje të certifikatës për shofer autotaksi e kryen person juridik nga komuna ose Qyteti i Shkupit, i cili disponon me:

- minimum 30 m<sup>2</sup> hapësirë të pajisur për mbajtje të trajnimit,
- teknologji informatike dhe pajisje tjetër për mbajtje të evidencës dhe
- minimum tre persona të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me arsim të lartë (fakulteti ekonomik, i komunikacionit ose juridik), me së paku tre vjet përvojë pune nga sfera e transportit.

Provimi për marrje të certifikatës nga paragrafi 1 i këtij neni jepet sipas Programi për dhënie të provimit për marrje të certifikatës për shofer autotaksi të përpiluar nga personi juridik nga paragrafi 2 të këtij neni para Komisionit për dhënie të provimi për shofer autotaksi (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i formuar nga kryetari i komunës përkatësisht kryetari i komunës së Qytetit të Shkupit.



Komisioni nga paragrafi 3 të këtij neni përbëhet prej pesë anëtarëve prej të cilëve tre anëtarë janë nga komuna ose Qyteti i Shkupit nga sfera të ndryshme të bashkimit të transportuesve.

Anëtarët e komisionit për punën e vet marrin kompensim.

Kandidatëve të cilit e kanë dhënë provimin u jepet vërtetim për provim të dhënë për shofer autotaksi.

Për dhënie të provimit për shofer autotaksi paguhet kompensim.

Lartësia e kompensimit duhet të jetë në kornizat e shpenzimeve të bëra për: trajnim, literaturë, material shpenzues, shpenzime për komisionin e provimit dhe të tjera. Listën e shpenzimit e përcakton personi juridik nga paragrafi 2 i këtij neni me pëlqim paraprak të kryetarit të komunës përkatësisht kryetarit të Qytetit të Shkupit.

Komunat përkatësisht Qyteti i Shkupit mban evidencë për personat të cilit e kanë dhënë provimin për marrje të certifikatës për shofer autotaksi.

Procedurën dhe programi për dhënie të provimit për marrje të certifikatës për shofer autotaksi, formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për provim të dhënë dhe të certifikatës për shofer autotaksi i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## Neni 9

Licencat dhe ekstraktin e licencës për çdo automjet motorik me të cilin do të bëhet transporti i paraparë me nenin 7 të këtij ligji, i lëshon Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, përveç licencës dhe ekstraktit të licencës për transport komunal dhe transport auto - taksi të udhëtarëve, të cilat i lëshon kryetari i komunës, përkatësisht për Qytetin e Shkupit kryetari i Qytetit të Shkupit.

Licencën dhe ekstraktin e licencës e lëshohen me afat vlefshmërie prej katër vjetësh.

Licenca për organizimin e transportit të mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar lëshohet me afat të vlefshmërisë prej dhjetë vjetësh.

Transportuesi është i obliguar më së voni 30 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së licencës të parashtrijë kërkesë për vazhdimin e saj te organi kompetent për dhënie të saj në pajtim me dispozitat e nenit 8 të këtij ligji. Organi kompetent gjatë veprimit për kërkesën nga ky paragraf me detyrë zyrtare e kontrollon besueshmërinë e të dhënave ekzistuese nga evidenca për transportuesin.

Të dhënat për licencat dhe për ekstraktet e licencave për çdo automjet motorik me të cilin do të kryhet transporti, të parapara me nenin 7 të këtij ligji dhe për licencat dhe për ekstraktet e licencave për transport komunal të udhëtarëve dhe transport autotaksi të udhëtarëve futen në bazën elektronike të të dhënave të cilën e mban Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Komunat, përkatësisht Qyteti i Shkupit janë të obliguar t'i futin të dhënat për licencat e lëshuara dhe ekstraktet e licencave për transport komunal të udhëtarëve dhe transport autotaksi të udhëtarëve në bazë ditore në bazën elektronike të të dhënave nga paragrafi 5 i këtij neni.

## Neni 9-a

Bartësit e ekonomisë bujqësore familjare të evidentuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të cilët kanë në pronësi ose me lizing më së shumti dy automjete për nevoja personale nuk duhet të posedojnë licencë në pajtim me këtë ligj, përkatësisht transportin e kryejnë në bazë të vërtetimi të dhënë për çdo automjet veçmas nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 9-b**

Vërtetimin nga neni 9-a të këtij ligji mund të marrë bartës i ekonomisë familjare bujqësore nëse i plotëson kushtet në vijim:

- 1) të posedojë vërtetim ose akt tjetër se është i evidentuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave si bartës i ekonomisë familjare bujqësore dhe
- 2) të jetë pronar ose të ketë lidhur marrëveshje për lizing të së paku dy automjeteve të regjistruara për transport që i plotëson kushtet e veçanta teknike-të eksploatimit të përcaktuara për automjete për kryerje të llojeve të veçanta të transportit në komunikacionin e brendshëm rrugor.

Vërtetimi nga neni 9-a të këtij ligji jepet me vlefshmëri prej pesë vitesh.

Vërtetimi nga neni 9-a të këtij ligji mund të vazhdohet për periudhë prej pesë vitesh, me parashtrim të kërkesës për vazhdim të vërtetimit para përfundimi të afatit të vlefshmërisë së vërtetimit valid.

Formën dhe përmbajtje e vërtetimit nga neni 9-a të këtij ligji i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 9-v**

Bartësi i ekonomisë familjare bujqësore i cili i plotëson kushtet nga neni 9-a të këtij ligji parashtron kërkesë për marrje të vërtetimit nga neni 9-a të këtij ligji në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, me dorëzim të dëshmive me shkrim për plotësim të kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve e lëshon vërtetimin më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së kompletuar për lëshimin e vërtetimit.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm nga paragrafi 1 të këtij neni i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve. Ministria e Transportit dhe Lidhjeve do të miratojë aktvendim për heqje të vërtetimit, nëse:

- bartësi i ekonomisë familjare bujqësore ka dorëzuar të dhëna të pasakta të cilat janë të nevojshme për dhënie të vërtetimit,
- bartësi i ekonomisë familjare bujqësore parashtron kërkesë për heqje dorë nga vërtetimi dhe
- bartësi i ekonomisë familjare bujqësore pushon t'i të plotësojë ndonjë nga kushtet e përcaktuara për dhënien e tij.

Kundër aktvendimit të miratuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në

Komisionin shtetëror për vendosje në procedurë administrative në shkallë të dytë dhe në procedurën për marrëdhënie të punës.

Bartësi i ekonomisë familjare bujqësore është i obliguar që pas plotfuqishmërisë së aktvendimit me të cilën i është hequr vërtetimi,

menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditësh t'ia kthejë vërtetimin Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

## Neni 9-g

Për vërtetimet e dhëna nga neni 9-a të këtij ligji Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mban evidencë.

## Neni 10

*I fshirë* 5

## Neni 10-a

Në komunat ose në qytetin e Shkupit ku ka numër të kufizuar të automjeteve që mund të marrin ekstrakt të licencës, transportuesi që posedon licencë për kryerjen e auto taksi transportit mund të parashtrojë kërkesë te organi që e ka lëshuar licencën për pezullim të ekstraktit të licencës për automjet të caktuar për periudhë më së shumti prej dy muajve. Gjatë një viti rrjedhës transportuesi vetëm një herë mund të parashtrojë kërkesë për pezullim të ekstraktit të licencës për një automjet të caktuar.

Komunat ose Qyteti i Shkupit në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për pezullim, miratojnë aktvendim me të cilin pranohet ose refuzohet kërkesa.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 2 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditëve nga pranimi i tij te ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Transportuesi nuk guxon të kryejë transport autotaksi të udhëtarëve me automjet për të cilin është miratuar aktvendimi nga paragrafi 2 i këtij neni.

Nëse një inspektor i autorizuar i komunës ose i qytetit të Shkupit, konstaton veprim në kundërshtim me paragrafin 4 të këtij neni, me propozim të inspektorit të autorizuar të komunës ose qytetit të Shkupit, komuna ose qyteti i Shkupit mund të miratojnë aktvendim për heqjen e ekstraktit të licencës për kryerjen e auto taksi transportit të udhëtarëve.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 5 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditëve nga pranimi i tij te ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## Neni 11

Transportuesi mund të fillojë të bëjë transportin e udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar pasi ta merr licencën dhe ekstrakt nga licenca.

Transport i udhëtarëve në linja komunale mund të kryhet edhe me mjete transporti në shina sipas marrëveshjes për vendosjen e koncesionit ose partneritetit privat publik. 6

Licenca dhe ekstrakti nga licenca jepet në emër të transportuesit dhe nuk mund t'i bartet transportuesit tjetër.

Personi juridik ose fizik i cili nuk ka në pronësi automjete, mund të kryejë organizim të transportit të mallrave në komunikacionin rrugor të

brendshëm ose ndërkombëtar, pasi të marrë licencë për organizimin e transportit.

Transportuesi është i detyruar që menjëherë, e më së voni brenda afatit prej 15 ditësh, për të gjitha ndryshimet e krijuara në aspekt të përmbushjes së kushteve për fitimin e licencës nga neni 8 i këtij ligji, ta njoftojë organin kompetent për lëshimin e saj.

Transportuesi është i detyruar që organit për kryerje të kontrollit t'i sigurojë kushte për kryerjen e kontrollit dhe t'ia japë në inspektim dokumentacionin e nevojshëm.

Për kontrollin e kryer dhe për gjendjen e konstatuar, inspektori paraqet raport me shkrim deri te organi kompetent që e ka lëshuar licencën.

## Neni 12

Organi kompetent për lëshimin e licencës dhe ekstrakt të licencës do të miratojë aktvendim për heqjen e tyre nëse:

- transportuesi ka paraqitur të dhëna të pasakta që janë të nevojshme për lëshimin e licencës ose ekstraktit të licencës;
- transportuesi parashton kërkesë për heqje dorë nga licenca ose ekstrakti i licencës,
- konstaton se transporti bëhet në kundërshtim me licencën e lëshuar, dhe
- transportuesi e ndërpret përmbushjen e ndonjërit prej kushteve të përcaktuara për lëshimin e tyre.

Një ekzemplar nga aktvendimi me të cilin licenca edhe ekstrakti i licencës hiqen i dërgohet Inspektoratit Shtetëror për Transport, përkatësisht inspektorit të autorizuar të komunës ose inspektorit të autorizuar të Qytetit të Shkupit për komunikacionin rrugor.

Kundër aktvendimit të miratuar nga Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit deri te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë nga fusha e transportit dhe ndërlidhjeve.

Kundër aktvendimit të miratuar nga kryetari i komunës përkatësisht nga kryetari i Qytetit të Shkupit, mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit deri te Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Transportuesi është i detyruar që pas plotfuqishmërisë së aktvendimit me të cilin hiqen licenca dhe ekstrakti i licencës, menjëherë e më së voni në afat prej 8 ditësh t'ia kthejë licencën dhe të gjitha ekstraktet nga licenca organit që e ka lëshuar.

## III. EVIDENCA

### Neni 13

Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve, përkatësisht komuna ose Qyteti i Shkupit janë të detyruar të mbajnë evidencë për transportuesit dhe automjetet e regjistruara për kryerje të transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor, varësisht nga lloji i transportit.

Evidenca nga paragrafi (1) i këtij neni mund të mbahet si bazë qendrore informative, në bazë të të cilave të dhëna i sigurojnë dhe i shfrytëzojnë Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, komuna ose Qyteti i Shkupit. Ministria

e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, Drejtoria Doganore, gjyqi kompetent i shkallës së parë dhe Fondi për sigurim pensional dhe invalidor.

## Neni 14

Evidenca nga neni 13 i këtij ligji ndahet në evidencë të transportuesve ndërkombëtar dhe evidencë të transportuesve të brendshëm.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve është e detyruar të sigurojë, përpunojë, ruajë, posedojë dhe shfrytëzojë të dhëna të nevojshme për dhënien e licencave për kryerjen e llojeve të caktuara të transportit në komunikacionin rrugor dhe regjistrim të orarit të udhëtimit të autobusëve si dhe të dhëna të nevojshme për ndarjen e lejeve për transport të udhëtarëve dhe mallrave.

Komuna përkatësisht Qyteti i Shkupit janë të detyruar t'i grumbullojnë, përpunojnë, ruajnë dhe t'i shfrytëzojnë të dhënat e nevojshme për lëshimin e licencave për transportin e udhëtarëve në linjë komunale ose për transport auto - taksi të udhëtarëve.

Evidentimi i përfshin të dhënat në vijim:

- numrin unik amë të subjektit, emrin dhe selinë të transportuesit,
- llojet e licencave që transportuesi i posedon, numrin serik dhe vlefshmërinë e tyre,
- emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës për transport dhe numrin e certifikatës për kompetencë profesionale të drejtuesit, përkatësisht personit të autorizuar përgjegjës për transport,
- markën, llojin dhe numrin regjistruar dhe të dhëna tjera për automjetet për të cilat është e lëshuar certifikatë e licencës,
- emrin dhe mbiemrin e shoferit, numrin unik amë (NUAQ) dhe certifikatën për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor ,
- nëse është në fuqi vendimi gjyqësor i plotfuqishëm për vepra penale kundër pronës, ekonomisë ose sigurisë në komunikacion,
- masa e shqiptuara kundër transportuesve në bazë të këtij ligji, përkatësisht të marrëveshjeve ndërkombëtare,
- lloje të lejeve që i janë lëshuar transportuesit për transport të udhëtarëve dhe mallrave, vlefshmëria e tyre, numri serik dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me lejet dhe
- të dhënat për stabilitetin financiar të transportuesit.

Të dhënat nga paragrafi 4 të këtij neni mund të sigurohen edhe nga evidencat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, Drejtoria Doganore, Ministrisë së Financave, gjyqit kompetent të shkallës së parë dhe të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Gjatë grumbullimit të të dhënave për transportuesin nga më shumë përmbledhje të të dhënave, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve nuk është kompetente ta informojë transportuesin për cila të dhëna ka të bëjë.

Organet, organizatat dhe personat të cilët disponojnë me të dhënat gjegjësisht përmbledhjet e të dhënave nga paragrafi 4 të këtij neni, janë të detyruar me kërkesë paraprake këto të dhëna t'ia dorëzojnë Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Për sigurimin e qasjes së të dhënave nga ky nen Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mund të vendosë lidhje të drejtpërdrejtë kompjuterike me të gjitha organet e përmendura dhe organizata të cilat mbajnë të dhëna të tilla ose përmbledhje të të dhënave.

## Neni 15

Të dhënat nga neni 14 të këtij ligji mbahen gjatë tërë kohës deri sa transportuesi është i regjistruar në evidencën e transportuesve.

Të dhënat ruhen edhe pesë vjet nga dita kur transportuesi është shlyer nga evidenca e transportuesve.

Të dhënat nga neni 14 të këtij ligji mund t'u jepen organeve tjera shtetërore, nëse ato e kërkojnë atë dhe nëse kërkesa e tyre është e lidhur ekskluzivisht me veprimtarinë transportuese me të cilën merren transportuesit.

## Neni 16

Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve, përkatësisht komuna ose Qyteti i Shkupit do ta shlyejë transportuesin nga evidenca nëse konstaton se transportuesi është shlyer nga Regjistri qendror, nëse i ka skaduar afati i vlefshmërisë së licencës, përkatësisht nëse i është hequr licenca për kryerje të llojit të caktuar të transportit në komunikacionin rrugor.

Shlyerja bëhet me ditën kur transportuesi është shlyer nga Regjistri qendror, me ditën e pushimit të vlefshmërisë së licencës përkatësisht me ditën e plotfuqishmërisë së aktvendimit me të cilin është hequr licenca.

# IV. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

## Neni 17

Transporti i udhëtarëve në komunikacionin rrugor të brendshëm mund të kryhet si transport i linjës, transport i lirë dhe i veçantë i udhëtarëve dhe transport i udhëtarëve për nevoja personale.

Transporti publik i udhëtarëve në komunikacionin rrugor të brendshëm mund të kryhet si transport i linjës komunale, transport i linjës ndërkomunale, transport i linjës së veçantë, transport i auto - taksive dhe transport i udhëtarëve për nevoja individuale.

Transporti i udhëtarëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor mund të kryhet si transport i linjës së udhëtarëve, si transport i lirë i udhëtarëve dhe transport i udhëtarëve për nevoja personale.

## Neni 17-a

Udhëtarët që shfrytëzojnë transport të linjës publike, gjatë tërë kohës së vozitjes duhet të kenë biletë për vozitje.

Udhëtari me kërkesën e inspektorit për komunikacion rrugor, si dhe kontrollorëve të transportuesit që e mban transportin doemos duhet t'ia japë biletën për ekspertizë.

Vozitësi i mjetit transportues është i obliguar që në bazë të ulëseve në dispozicion në automjet t'i vendosë udhëtarët dhe bagazhin e tyre personal.

Vozitësi i mjetit transportues nuk guxon të hipë ose të zbresë dhe të ngarkojë ose të shkarkojë bagazh jashtë stacioneve ose vendqëndrimeve të autobusit që janë caktuar në orarin e vozitjes.

# 1. TRANSPORTI NË LINJË I UDHËTARËVE

## 1.1. Transporti në linjë komunale i udhëtarëve

### Neni 18

Transport në linjë komunale të udhëtarëve mund të bëjnë transportues të cilët kanë licencë për kryerjen e llojit të tilli të transportit.

### Neni 19

Transport në linjë komunale të udhëtarëve kryhet në bazë të lejes për linjë të caktuar të cilën e lëshon prefekti i komunës, përkatësisht prefekti i Qytetit të Shkupit për rajonin e Qytetit të Shkupit.

Transportuesi i cili ka licencë për kryerjen e transportit në linjë komunale të udhëtarëve mund të fillojë me kryerjen e transportit, pasi që të marrë leje dhe të regjistrojë orar të udhëtimit për linjë të caktuar te prefekti i komunës ose te prefekti i qytetit të Shkupit.

Leja dhe orari i udhëtimit nga paragrafi 2 i këtij neni lëshohen me afat vlefshmërie prej pesë vjet.

Formën dhe përmbajtjen e lejes nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve.

### Neni 19-a

Gjatë caktimit të linjës së transportit komunal të udhëtarëve duhet të mbahet llogari për:

- lidhjen reciproke ndërmjet transportit ndërkomunal të udhëtarëve dhe transportit komunal të linjës dhe
- lidhjen reciproke të transportit komunal të udhëtarëve me lloje të tjera të transportit.

### Neni 19-b

Në komunat me mbi 100.000 banorë, komuna është e obliguar të organizojë transport të linjës komunale të udhëtarëve si shërbim publik.

### Neni 20

Gjatë kryerjes së transportit në linjë komunale të udhëtarëve, transportuesi është i detyruar në automjet të ketë ekstrakt të licencë, leje urdhëruddhëtimi në origjinal dhe orar udhëtimit të regjistruar në origjinal.

Transportuesi është i detyruar t'i përmbahet orarit të regjistruar për udhëtim dhe rregullisht ta mbajë linjën.

### Neni 21

Hipja dhe zbritja e udhëtarëve në transportin në linjë komunale të udhëtarëve bëhet në ndalesat e autobusit në pajtim me orarin e përcaktuar vozitës të regjistruar.

Autobusët në anën e djathtë të përparme anësore në vend të dukshëm duhet ta mbajnë numrin e linjës, stacionin fillestar dhe të fundit.

### Neni 22

Këshilli i komunës përveç këshillave të komunave të qytetit të Shkupit e rregullojnë transportin në linjë komunale të udhëtarëve në territorin e komunës, ndërsa transportin në linjë të udhëtarëve në territorin e të gjitha komunave të qytetit të Shkupit e rregullon Këshilli i Qytetit të Shkupit, gjatë së cilës veçanërisht e përcaktojnë:

- rrjetin unik të linjave,
- orarin të udhëtimit, mënyrën e vendosjes së saj, mbajtjen dhe ndryshimin,
- mënyrën e organizimit të kontrollit të komunikacionit të autobusëve dhe linjave si dhe evidencën për të,
- sistemin tarifor, sistemin e arkëtimit dhe mënyrën dhe kontrollimin e arkëtimit;
- lokacionin e terminalëve të autobusëve, vendqarkimin, ndalesat dhe procedura për ndryshimin e tyre,
- ndërtimin, shënimin, pajisjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e terminaleve të autobusëve, vendqarkimeve dhe ndalesave,
- caktimi i relacionit dhe vendi për transport me furgonë me së paku 9 karrige (8+1), dhe
- kriteret për mënyrën dhe procedurën për lëshimin dhe heqjen e lejes për kryerje të transportit në linjë komunale dhe ndarjen e linjave transportuesve në transportin në linjë komunale të udhëtarëve.

Sistemin unik tarifor dhe mënyrën e shitjes së biletave për vozitje përkatësisht kartelave elektronike për të gjithë transportuesit të cilët kryejnë transport në linjë të udhëtarëve në rajonin e qytetit të Shkupit e përcakton Këshilli i Qytetit të Shkupit me vendim.

Në biletat elektronike të shfrytëzuesve të linjës së transportit në qytetin e Shkupit, në varësi nga kategorizimi i shfrytëzuesit, vendosen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, NUAQ, adresa e vendbanimit, data e lindjes, fotografia për shkak kontrollit vizual, personi juridik përkatësisht institucioni në të cilin punon, emri i institucionit arsimor, klasa, viti shkollor, kategoria tarifore (nxënës, pensionist, i punësuar etj) vendbanimi dhe komuna.

## **Neni 22-a**

Qyteti i Shkupit mund të organizojë transport komunal në linjë të udhëtarëve edhe në territoret e komunave Haraçinë, Zelenikovë, Ilinden, Petrovec, Sopishtë, Studeniçan dhe Çuçer Sandevë nëse komunat e theksuara ose ndonjëra prej tyre nuk ka ose nuk mund të organizojë transport komunal prej Qytetit të Shkupit.

Për organizimin e transportit nga paragrafi 1 i këtij neni, Qyteti i Shkupit me komunën përkatëse mund të lidhë marrëveshje për përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, përcaktim të vendqarkimeve dhe stacioneve dhe për mënyrën e financimit të transportit.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni licencat, lejet dhe oraret e udhëtimit për kryerjen e transportit komunal në linjë të udhëtarëve do t'i lëshojë Qyteti i Shkupit.

## **Neni 23**

Një ose më shumë komuna me seli në fshat me komunën me seli në qytet të përcaktuara me ligj kah e cila gravitojnë, bashkërisht mund ta organizojnë kryerjen e transport në linjë ndërurbane me detyrim që ta ruajnë intervalin kohor të stacioneve nga pjesa e segmentit të përbashkët të orareve të vozitjeve të lejuara për transportin e linjës ndërkomunale gjatë lidhjes së marrëveshjes.



Mënyrën dhe kushtet për organizim të përbashkët për kryerjen e transportit të udhëtarëve në linjë nga paragrafi 1 i këtij neni, komunat i përcaktojnë me marrëveshje.

Marrëveshja nga paragrafi 2 i këtij neni, në veçanti përmban:

- rrjetin unik të linjave;
- itinerarin, mënyrën e bërjes publike të tij, mirëmbajtjen dhe ndryshimet;
- lokacionin e ndalesave të autobusëve, shënimin e të njëjtave, pajisjen e tyre, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin;
- sistemin tarifor dhe sistemin e arkëtimit; dhe
- kriteret dhe mënyrën e lëshimit dhe të heqjes së lejes për kryerje të transportit dhe përcaktimin e itinerarit të caktuar në rrjetin unik të linjave të transportuesve nga komunat të cilat kanë rënë dakord që bashkërisht ta organizojnë transportin e udhëtarëve në linjë në rajonet e tyre.

Pëlqimin për marrëveshjen nga paragrafi 2 të këtij neni e jep Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Një kopje e marrëveshjes për të cilën është dhënë pëlqim mbahet në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve.

Nëse komunat lidhin marrëveshje, kurse për të njëjtën nuk kanë marrë pëlqim nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve, e njëjta nuk ka veprim juridik, përkatësisht është e pavlefshme.

Shoferi që transportin e kryen në pajtim me marrëveshjen nga paragrafi 2 i këtij neni është i detyruar në pajtim me lejen dhe itinerarin për linjën dhe të veprojë në pajtim me nenin 34 të këtij ligji.

### **Neni 23-a**

Dispozitat e neneve 24, 25, 25-a, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 34 dhe 35 të këtij ligji zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për transport në linjë ndërrbane të udhëtarëve nga neni 23 i këtij ligji.

### **Neni 23-b**

Kryerja e transport në linje urbane të udhëtarëve me trolejbus, tramvaj ose lloje tjera mjetesh transporti në shina mund të jetë lëndë e koncesionit ose partneritetit privat publik në kushte dhe mënyrë të përcaktuara me Ligjin për koncesion dhe partneritetit privat publik dhe kushte të përcaktuara nga këshilli komunal përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Koncesioni ose partneriteti privat publik për transport në linje urbane të udhëtarëve me trolejbus, tramvaj ose lloje tjera mjetesh transporti në shina rregullohen me marrëveshje për vendosjen e koncesionit ose partneritetit privat publik.

Vendim për dhënie koncesioni ose partneriteti privat publik për transport në linje urbane të udhëtarëve me trolejbus, tramvaj ose lloje tjera mjetesh transporti në shina, miraton këshilli komunal përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Këshilli komunal përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit mund të miratojë vendim për kushtet që duhet të plotësohen në procedurë për koncesion ose partneritet privat publik për transport në linjë urbane të udhëtarëve me trolejbus, tramvaj ose lloje tjera mjetesh transporti në shina, për zhvillimin e transportit në komunë, përkatësisht qytet.

Marrëveshja për koncesion përkatësisht partneritet privat publik lidhet për periudhë prej më së shumti 35 vite.

Marrëveshja për koncesion përkatësisht partneritet privat publik mund të bartet me pëlqim me shkrim nga koncedenti, përkatësisht partneri publik, në kushte të përcaktuara me marrëveshje dhe pa e prishur kohëzgjatjen e marrëveshjes.

## 1.2. Transporti në linjë ndërkomunale i udhëtarëve

### Neni 24

Transport të udhëtarëve në linjë ndërkomunale mund të kryejë vetëm transportuesi i cili ka licencë për kryerje të këtij lloji të transportit.

Transporti i udhëtarëve në linjë ndërkomunale kryhet në linjë të caktuar sipas itinerarit paraprakisht të lejuar me çmim të përcaktuar e të shpallur të transportit.

Transporti i udhëtarëve në linjë ndërkomunale mund të kryhet si transport udhëtarësh, direkt dhe i shpejtë.

### Neni 24-a

Lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja ose ndryshimin e rendeve të vozitjes të linjave të lejuara bën Ministria e Transportit dhe Lidhjeve me kërkesë të transportuesve të interesuar.

Për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja ose ndryshim të linjave të vozitjes të linjave të lejuara, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve shpall konkurs në internet faqen e saj dhe në shtypin ditor.

Konkursi nga paragrafi 2 i këtij neni shpallet një herë gjatë vitit edhe atë në maj të vitit rrjedhës.

Procedura për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja ose ndryshimin e rendeve të vozitjes të linjave të lejuara bëhet në formë elektronike.

Të drejtë të pjesëmarrjes në konkurs kanë të gjithë transportuesit të cilit kanë licencë për transport të udhëtarëve në komunikacionin ndërkomunal dhe ndërkombëtar.

Gjatë kërimit elektronik për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja, përkatësisht për ndryshim të rendeve të vozitjes nga linja të lejuara, nëse në trasenë e linjës për tashmë rend të lejuar të vozitjes, ka dy stacione të përbashkëta, transportuesi duhet t'i ketë parasysh intervalet kohore të nisjes edhe atë: për transport të linjës ndërkomunale

gjatësia e linjës në km	dallime minimale kohore në minuta
	para/pas
0 - 40 km	30
41 - 80 km	50
81 - 120 km	60
mbi 120 km	90

Gjatë kërimit elektronik për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja, përkatësisht për ndryshim të rendeve të vozitjes nga linja të lejuara, nëse në trasenë e linjës për tashmë rend të lejuar të vozitjes ka dy stacione të

përbashkëta prej të cilave njëra në territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa tjetra në territorin e vendit të arritjes, dhe nëse aplikohet për rend të ri ndërkombëtar të vozitjes, transportuesi duhet t'i ketë parasysh intervalet kohore të nisjes për pjesën e territorit të Republikës së Maqedonisë, edhe atë: për transport të linjave ndërkombëtare

gjatësia e linjës në km	dallime minimale kohore në minuta
	para/pas
0 - 250 km	60
251 - 600 km	180
601 - 1800 km	240
mbi 1801 km	360

Gjatë kërkimit elektronik për leje të rendit të ri të vozitjes për linjë ndërkombëtare në territorin e Republikës së Maqedonisë nëse linja është me gjatësi deri në 250 km transportuesi doemos duhet të aplikojë së paku 1 stacion, nëse linja është me gjatësi deri në 600 km transportuesi doemos duhet të aplikojë së paku 2 stacione, nëse linja është me gjatësi mbi 601 km transportuesi doemos duhet të aplikojë së paku 3 stacione.

Gjatë kërkimit elektronik për lejim të rendit të ri të vozitjes për linja të reja, nëse në trasenë e linjës për tashmë rend të lejuar të vozitjes ka dy stacione të përbashkëta, për nisje nga Velesi, Kumanova dhe Tetova kah Shkupi në periudhën prej 6:00 deri në 8:00 çdo ditë dhe për nisje nga Shkupi në Veles, Kumanovë dhe Tetovë në periudhë prej 15:30 deri në 17:30 çdo ditë, intervali kohor prej njëres deri në nisjen tjetër është 10 minuta.

Gjatë kërkimit elektronik për lejim të rrezeve të vozitjes për linja të rreja, përkatësisht për ndryshim të rrezeve të vozitjes të linjave të lejuara transportuesi duhet t'i ketë parasysh rendet e lejuara të vozitjes të shpallura në internet faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe rendet e lejuara të vozitjes me marrëveshje ndërmjet dy komunave.

Nëse rendi i vozitjes për linjën për transport ndërkombëtar dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe me më shumë nisje të cilat nuk mund të mbahen me një automjet, transportuesi për ato rende të vozitjes duhet të posedojë aq automjete sa që është e nevojshme për të mundur t'i mbajë të gjitha nisjet për të cilat i është dhënë leje duke i konsideruar edhe automjetet të cilat i janë të nevojshme për mbajtje të rrezeve të reja të lejuara të vozitjes për transport të udhëtarëve.

Transportuesi në varësi nga fitimi i realizuar për vitin rrjedhës paraprak e ka të drejtën të aplikojë për transport ndërkombëtar dhe ndërkombëtar të udhëtarëve edhe atë:

- prej 1,000,000 deri në 2,000,000 denarë më së shumti 3 aplikime
- prej 2,000,001 deri në 4,000,000 denarë më së shumti 5 aplikime
- prej 4,000,001 deri në 6,000,000 denarë më së shumti 7 aplikime dhe
- mbi 6,000,001 denarë më së shumti 9 aplikime

Transportuesi i cili është pajisur me licencë adekuate në vitin në të cilin zbatohet konkursi përkatësisht para afatit të përcaktuar me ligj për përpilim të llogarisë përfundimtare ka të drejtë të aplikojë për transport ndërkombëtar dhe ndërkombëtar të udhëtarëve aq aplikime sa që posedon leje me certifikatë për licencë.

Procedurën për lejim të rrezeve të vozitjes për linja të reja dhe për ndryshim të rrezeve të vozitjes për linja të lejuara e përcjell dhe

kontrollon Komisioni për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja dhe për ndryshim të rendeve të vozitjes për linja të lejuara (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i formuar nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Dëshmitë dhe të dhënat për plotësim të kushteve nga paragrafët 11 dhe 12 të këtij neni, i grumbullon Komisioni i cili është i obliguar në afat prej tri ditësh nga dita e aplikimit t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

Në bazë të rezultateve të mara nga kërkesat e punuara në kompjuter, Komisioni nga paragrafi 14 i këtij neni përpilon propozim-listë të kërkesave të lejuara, përkatësisht refuzuara dhe e dorëzon te ministri i Transportit dhe Lidhjeve në lejim.

Në bazë të listave të lejuara Ministria e Transportit dhe Lidhjeve miraton aktvendim me të cilin rendi i vozitjes për linjë lejohet ose kërkesa refuzohet.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 17 i këtij neni mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punesë në Shkallë të Dytë.

Komisioni nga paragrafi 14 i këtij neni përbëhet nga pesë anëtarë prej të cilëve tre anëtarë janë nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe dy anëtarë nga shoqatat e transportuesve në komunikacionin rrugor.

Mënyrën dhe kushtet më të afërta për lejim të rendeve të vozitjes për linja të reja dhe për ndryshim të linjave të lejuara në transportin ndërkomunal dhe ndërkombëtar të udhëtarëve, dhëniën, vazhdimin dhe marrjen e lejes për linja të lejuara, formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes dhe të rendit të vozitjes, i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## **Neni 24-b**

Dispozitat e nenit 24-a të këtij ligji në mënyrë përkatëse zbatohen edhe mbi procedurën e dhënies së pëlqimit të itinerareve për linja të reja ose për ndryshimin e linjave që kanë pëlqim në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.

## **Neni 25**

Transportuesi me kryerjen e transportit të udhëtarëve në linjë ndërkomunale mund të fillojë pas marrjes së lejes për linjë të caktuar të lëshuar Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Leja nga paragrafi 1 i këtij neni jepet me afat vlefshmërie prej pesë viteve.

Lejen nga paragrafi 1 të këtij neni mund ta shfrytëzojë vetëm transportuesi të cilit i është dhënë.

Leja për kryerjen e transportit në linjë ndërkomunale të udhëtarëve përmban: emrin e linjës, emrin dhe selinë e transportuesit, si dhe afatin e vlefshmërisë.

Pjesë përbërëse e lejes është edhe orari i lejuar i udhëtimit për linjën i regjistruar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve.

Transportuesi gjatë kryerjes së transportit detyrimisht duhet të posedojë urdhërudhëtimi.

## Neni 25-a

Bartja e lejeve ose aktvendimeve nga njëri transportues në tjetrin lejohet vetëm në rastin kur transportuesi i ri është pasardhës juridik i transportuesit që ka pushuar së ekzistuari, nëse ekziston ndarja e pronës së transportuesit në dy ose më shumë transportues të rinj në pajtim me marrëveshjen për ndarje, të verifikuar te noteri ose në pajtim me aktvendimin e gjykatës kompetente ose në bazë të marrëveshjes për shitblerje ndërmjet dy transportuesve për ndryshim të pronësisë së transportuesit ose të ndonjë akti tjetër me të cilin do të përcaktohet ndryshimi i pronësisë së transportuesit.

## Neni 25-b

Nëse leja me orarin e udhëtimit është me më shumë nisje transportuesi mund të parashtrojë kërkesë për ndarje të nisjeve të veçanta ose të gjitha nisjeve nga orari i udhëtimit në leje të veçanta.

Transportuesi mund të parashtrojë kërkesë edhe për bashkimin e dy ose më shumë orareve të udhëtimit për të cilat ka leje të posaçme të cilat janë me stacion të njëjtë fillestar dhe të fundit, të njëjtat të jenë në një leje dhe një orar të udhëtimit.

## Neni 26

Për lejet e dhëna mbahet evidencë.

Evidencën e lejeve të dhëna e mban Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Ministria është e detyruar t'i informojë stacionet e autobusëve, për lejet e dhëna dhe për çdo ndryshim të bërë.

Transportuesi është i detyruar ta bëjë transportin në linjë ndërkomunale të linjës në pajtim me lejen e dhënë dhe orarin e udhëtimit të regjistruar.

Për kohën e kryerjes së linjave ndërkomunale të transportit të udhëtarëve, në automjetin patjetër duhet të gjendet ekstrakti nga licenca, leja, orari i regjistruar i vozitjes dhe fletudhëtimi në origjinal.

## Neni 27

Transportuesi në mënyrë të pavarur e përcakton çmimin e transportit.

Transportuesi është i detyruar ta dorëzojë listën e çmimeve në stacionet e autobusëve që i shfrytëzon në pajtim me orarin e caktuar për udhëtim.

Transportuesi është i detyruar përmes mjeteve të informimit publik ta shpall fillimin e transportit në linjë ndërkomunale sipas orarit të udhëtimit.

## Neni 27-a

Transportuesi gjatë kryerjes së transportit të udhëtarëve në automjet nuk mund të ketë më tepër udhëtarë se sa ka ndenjës në automjet.

## Neni 28

Orari i vozitjes dhe drejtimi i lëvizjes (itinerari) mund të ndryshohen vetëm një herë gjatë vlefshmërisë së lejes me zbatimin e procedurës nga neni 24-a të këtij ligji.

Me përjashtim nga paragrafi 1 të këtij neni, pa zbatimin e procedurës nga neni 24-a të këtij ligji, orari i vozitjes dhe drejtimi i lëvizjes (itinerari) mund të ndryshohet para skadimit të vlefshmërisë së lejes, nëse:

- transportuesi heq dorë nga një numër i caktuar i nisjeve në orarin e vozitjes,
- në procedurën për dhënien e lejeve transite për linjat e rregullta në komunikacionin rrugor ndërkombëtar, shteti që duhet të bëjë transit, kërkon ndryshimin e gjatësisë së trasesë dhe/ose kohës së udhëtimit, ose kalimeve kufitare për hyrje dhe dalje,
- transportuesi i huaj ka marrë pëlqim për ndryshim të orarit të udhëtimit nga organi kompetent i shtetit të huaj, përveç për shtimin e stacioneve në orarin e udhëtimit dhe nisjeve në territorin e Republikës së Maqedonisë,
- kjo është e nevojshme për shkak të forcës madhore,
- ka ndryshime të shkaktuara për arsye të rikonstruktimit dhe lëshimit në komunikacion të rrugëve të reja ose për arsye të ndodhive të tjera të jashtëzakonshme,
- me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit vendqëndrime të caktuara të autobusëve në qytet janë caktuar si stacione përgjatë rrugës për kryerje transporti ndërrurban të udhëtarëve,
- ndryshohet itinerari pa ndryshimin e orarit të nisjes,
- transportuesi kërkon shlyerje të stacioneve të caktuara në orarin e udhëtimit, nëse pa stacionet të cilat kërkohet të shlyhen në orarin e ri të udhëtimit, stacioni fillestar dhe i fundit janë stacione të autobusit të kategorizuara, ndërsa për transport ndërkombëtar të udhëtarëve në orarin e ri të udhëtimit stacioni fillestar të jetë stacion i autobusit i kategorizuar,
- transportuesi kërkon shkurtimin e relacionit ose ndryshimin e mënyrës së mbajtjes së linjës nga linja ekzistuese në linjë sezonale dhe anasjelltas me këtë rast duke pasur parasysh intervalet kohore të përcaktuara në nenin 24-a paragrafët 6 dhe 7 të këtij ligji.
- transportuesi heq dorë nga dita/ditët në regjimin e mbajtjes së orarit të udhëtimit.

Për rastet nga paragrafi 2 të këtij neni, në bazë të kërkesës me shkrim nga transportuesi me aktvendim vendos Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Transportuesi është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve të dorëzojë kërkesë për regjistrimin e orarit të udhëtimit të miratuar dhe për lëshimin e lejes për linjën për të cilën orari i udhëtimit është miratuar.

Nëse transportuesi kërkesën për regjistrimin e orarit të udhëtimit të miratuar dhe për lëshimin e lejes, nuk e dorëzon në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, do të konsiderohet se i njëjti nuk është i interesuar për mbajtjen e linjës kurse orari i udhëtimit për linjën e miratuar hiqet.

## Neni 29

Gjatë kohës sa vlen leja, transporti mund përkohësisht të ndërpritet nëse paraqiten dhe deri sa zgjasin arsyet të cilat transportuesi nuk ka mundur t'i parasheh dhe pasojat të cilat nuk ka mundur t'i largojë (fuqia madhore).

Ndërprerjen e përkohshme nga paragrafi 1 të këtij neni transportuesi është i detyruar ta paraqet në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, menjëherë pas paraqitjes së shkaqeve të cilat e kanë shkaktuar.

## Neni 30

Nëse transportuesi nuk mund ta bëjë transportin në linjë ndërkomunale të udhëtarëve, për të cilën ka marrë leje, është i detyruar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve të paraqesë kërkesë për lejim të ndërprerjes së përkohshme ose për ndërprerje të përhershme të transportit.

Transporti mund përkohësisht të ndërpritet më së shumti për periudhë prej gjashtë muajve gjatë vlefshmërisë së lejes ose të ndërpritet përgjithmonë në bazë të vendimit të Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Me miratimin e aktvendimit për ndalesën e përhershme të transportit të udhëtarëve në linja të caktuara, tërhiqet leja dhe bëhet shlyerja e orarit të vozitjes nga evidenca e orareve të regjistruara të udhëtimit.

### **Neni 31**

Transportuesi është i detyruar ndërprerjen e përkohshme ose ndërprerjen e përhershme të transportit dhe ndryshimin e orarit për udhëtim në linjë të caktuar ta shpall në mjetet e informimit publik dhe në stacionet e autobusëve, të cilat gjenden në orarin e udhëtimit.

### **Neni 32**

Transportuesi nuk mund në linjë të caktuar për të cilën ka leje ta ndërpresë transportin për shkaqe të paarsyeshme dhe pa lejen e Ministrisë të Transportit dhe Lidhjeve.

Nëse transportuesi për shkaqe të paarsyeshme nuk e bën transportin në linjë ndërkomunale të linjës së caktuar më shumë se pesë ditë pandërprerë ose me ndërprerje në periudhë prej dy muajve gjatë vitit, me propozim të inspektorit shtetëror për transport rrugor Ministria e Transportit dhe Lidhjeve do të marrë vendim për heqjen e lejes. Me plotfuqishmërinë e aktvendimit për tërheqjen e lejes së orarit të vozitjes shlyhet nga evidenca e orareve të regjistruara të vozitjes.

Nëse inspektorit shtetëror për transport rrugor gjatë kontrollit të stacionit të autobusëve nga ditari i komunikacionit për nisje dhe arritje të autobusëve në stacionin e autobusëve, konstaton se transportuesi që posedon leje dhe orar të udhëtimit të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve për kryerje transporti të udhëtarëve në linja ndërrbane dhe ndërkombëtare në periudhë jo më të gjatë se 60 ditë për shkaqe të paarsyeshme nuk e mban linjën e caktuar më shumë se pesë ditë pandërprerë ose me ndërprerje në periudhë prej dy muajsh gjatë vitit, me propozim të inspektorit shtetëror për transport rrugor ministri i Transportit dhe Lidhjeve do të marrë aktvendim për heqjen e lejes. Pas përfundimit të aktvendimit për heqjen e lejes, orari i udhëtimit shlyhet nga evidenca e orareve të regjistruara të udhëtimit.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mund të miratojë aktvendim për heqjen e lejes nëse nga raportet nga neni 60 paragrafi 2 që i dërgojnë stacionet e autobusëve, konstaton se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni.

Kundër vendimit nga paragrafët 2, 3 dhe 6 të këtij neni mund të paraqesë ankesë në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të vendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve është e obliguar që një ekzemplar të aktvendimit nga paragrafi 2 të këtij neni t'ia dërgojë Inspektoratit

Shtetëror për Transport më së voni në afat prej shtatë ditësh pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mund të miratojë aktvendim për heqje të lejes, nëse në mënyrë të konsiderueshme nga sistemi elektronik i evidencës që e mban Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë, e në të cilin është e lidhur Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, konstatohet se janë përmbushur kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni.

### Neni 33

Biletat e udhëtimit shiten ekskluzivisht nëpërmjet sistemit të unifikuar elektronik me pagesë elektronike të biletave

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni transportuesi mund të shesë bileta udhëtimi edhe në autobus, atje ku nuk ka vende të organizuara për shitje, me ç'rast është i obliguar të japë llogari fiskale për biletat e shitura.

Biletat e udhëtimit mund të shiten vetëm për vetëm për linjat e lejuara për të cilat i është dhënë leje me orarin e lejuar të vozitjes dhe çmimin. <sup>8</sup>

Transportuesi dhe stacioni i autobusëve detyrohen që personave plotësisht të shurdhër me vërtetim për anëtarësim dhe karton të vozitjes nga Lidhja nacionale e personave të shurdhër, personave me pengesë të rëndë dhe të thellë mentale dhe përcjellësit të tij me vërtetim për anëtarësim dhe karton të vozitjes të lëshuar nga Qendra republikane për përkrahje të personave me pengesë intelektuale personit të verbër me dëmtim të të parit mbi 90% dhe shoqëruesit të tij me vërtetim për anëtarësi dhe kartelë udhëtimi të lëshuar nga Lidhja e Personave të Verbër dhe personit me invaliditet trupor prej 90% dhe shoqëruesit të tij me vërtetim për anëtarësi dhe kartelë udhëtimi të lëshuar nga Lidhja e Personave me Invaliditet, t'u lëshojnë biletë për udhëtim në të dyja drejtimet (biletë kthyesë) pa kompensim dhe në librezën e udhëtimit të evidentojë se personi i verbër dhe personi me invaliditet e kanë shfrytëzuar transportin. Personit të verbër me dëmtim të të parit mbi 90% dhe shoqëruesit të tij dhe personit me invaliditet dhe shoqëruesit të tij gjatë një viti kalendarik mund t'u lëshohen bileta për maksimalisht gjashtë bileta kthyesë për udhëtim në transportin e brendshëm të udhëtarëve, është në shpenzim të transportuesit.

Bileta e vozitjes të cilën e jep transportuesi përmban:

- emrin e transportuesit,
- vendin e nisjes dhe të arritjes, përkatësisht të zonës së kryerjes për transportin komunal të linjës,
- periudhën e vlefshmërisë së biletës, dhe
- çmimin e transportit.

Transportuesi në tërë linjën mund të kryejë transport edhe me shumë automjete (vojitje bis). Nëse linja mbahet me vozitje bis atëherë nuk është e domosdoshme që tërë automjetet të nisen nga stacioni fillestar ose stacionet përgjatë rrugës nëse në ato stacione ka vende të mjaftueshme në automjetet që nisen nga ato stacione që të transportohen të gjithë udhëtarët të linjës në fjalë.

### Neni 34

Në transportin në linjë ndërkomunale të udhëtarëve, hipja dhe zbritja e udhëtarëve, gjegjësisht ngarkimi dhe shkarkimi i bagazhit, mund të bëhet vetëm në stacionet e autobusëve të kategorizuara dhe ndalesat e autobusëve që janë përfshirë në leje dhe orarin e udhëtimit për linjën.



Në vendet ku ekzistojnë stacionet e autobusëve të kategorizuara, transportuesi i cili ka leje për kryerjen e transportit në linjë ndërkomunale të udhëtarëve, hipja dhe zbritja e udhëtarëve mund të bëhet vetëm në ato stacionet e autobusit.

### **Neni 35**

Shoferi që e drejton automjetin është i detyruar të ndalet në stacion të autobusit të kategorizuar, gjegjësisht ndalesën e autobusit në pajtim me lejen dhe orarin e udhëtimit të linjës, kushtet në stacion dhe rregullat për siguri.

Shoferi që e drejton automjetin është i detyruar ta vërtetojë fletudhëtimin në çdo stacion të autobusëve të kategorizuar të lejuar në itinerarin dhe lejen për linjë të caktuar.

## **1.3. Transporti në linjë ndërkombëtare i udhëtarëve**

### **Neni 36**

Transporti në linjë ndërkombëtare i udhëtarëve midis Republikës së Maqedonisë dhe shtetit të huaj (bilaterale) dhe transporti transit përmes territorit të Republikës së Maqedonisë vendoset në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, e në bazë të lejet e lëshuara paraprake nga ministrat kompetent për transport në shtetet nëpër të cilat kalon linja.

Transporti nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet në bazë të lejes që e jep Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 37**

Transporti i udhëtarëve në linjë ndërkombëtare në territorin e Republikës së Maqedonisë mund të bëhet në bazë të lejes që e lëshon Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Leja lëshohet me kërkesë të transportuesit të vendit dhe të huaj. Transportuesit, janë të obliguar që kërkesës t'ia bashkëngjitin orarin e nisjes, listën e çmimeve, itinerarin, plan për vozitje të vozitësve, kontratën për mbajtjen e përbashkët të transportit dhe shtojca të tjera të përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare.

Transportuesi i huaj, kërkesën për lëshimin e lejes e dërgon përmes organit kompetent të shtetit në të cilin është regjistruar automjeti.

Pjesë përbërëse e lejes me orar të vozitjes së përcaktuar, listën e çmimeve, itinerarin, dhe planin për vozitje të vozitësve.

Leja nuk do të lëshohet nëse transportuesi nuk i përmbush kushtet për lëshimin e saj të parapara me këtë ligj, me rregullat më të përafërta të nxjerra në bazë të këtij ligji dhe me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Nëse në afat prej 12 muajsh nga dita e fillimit të procedurës për lëshim të lejes bilaterale e njëjta nuk lëshohet nga ane organit kompetent të vendit të huaj, itinerari i miratuar për linjën e autobusëve shlyhet nga evidenca e itinerareve.

Nëse është i plotësuar kushti nga paragrafi 6 i këtij neni, ministria miraton aktvendim për shlyerje të itinerarit.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 7 i këtij neni mund të ngrihet kontekst administrativ.

Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve mban regjistër për lejet e lëshuara dhe itinerar të regjistruar për vijat ndërkombëtare.

Formën dhe përmbajtjen e regjistrit nga paragrafi 9 i këtij neni i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 38**

Transporti në linjë ndërkombëtare i udhëtarëve në transportin rrugor ndërkombëtar doemos të bëhet në pajtim me orarin e udhëtimit, leja, plani i vozitjes së vozitësve, itinerarin dhe listën e çmimeve që i kanë vërtetuar ministritë e Transportit ku gjenden selitë e transportuesve.

Leja, plani për vozitje të vozitësve, orari i udhëtimit, itinerari dhe lista e çmimeve në origjinal doemos të gjinden në automjetin me të cilin bëhet transporti.

Krahas dokumenteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni në automjete doemos duhet të gjendet edhe lista e evidentimit për transport të udhëtarëve. Listën e evidentimit për transport të udhëtarëve e mban transportuesi në tre ekzemplarë për çdo transport të kryer të udhëtarëve, e ruan në afat prej 24 muajsh dhe një ekzemplar në mënyrë të obligueshme lihet në Drejtorinë Doganore në kalimet kufitare të Republikës së Maqedonisë.

Formën dhe përmbajtjen e listës së evidentimit për transport të udhëtarëve, të dhënat të cilat i përmban, mënyrën e ruajtjes dhe mbajtjes së tij i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 38-a**

Transportuesi vendas dhe i huaj me marrëveshje e përcaktojnë regjimin e mbajtjes së itinerarit në bazë të principit të reciprocitetit përkatësisht mundet me regjimin e mbajtjes të përcaktohet nisjen e itinerarit t'i mbajnë dy transportuesit njëkohësisht ose dy transportuesit reciprokisht ose vetëm transportuesi vendas ose vetëm transportuesi i huaj.

Nëse transportuesit transportin nga paragrafi 1 të këtij neni nuk e kryejnë në pajtim me lejen e lëshuar dhe orarin e lejuar të vozitjes, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve do ta tërheqë lejen dhe orarin e vozitjes dhe të njëjtit do t'i shlyejë nga regjistri i lejeve të lëshuara.

### **Neni 38-b**

Nëse transportuesit të vendit i është tërhequr leja, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve e lajmëron organin kompetent të shtetit të huaj ku e ka selinë transportuesi i huaj.

Transportuesi i huaj është i obliguar që në afat prej tri muajsh nga lajmërimi nga paragrafit 1 të këtij neni, të lidhë marrëveshje për mbajtjen e përbashkët të linjës lëndore me transportues tjetër të vendit.

Nëse transportuesi huaj në afat prej 3 muajsh nga lajmërimi nga paragrafi 1 të këtij neni lidh marrëveshje për mbajtjen e përbashkët të linjës lëndore me tjetër me transportues të vendit, transportuesit të vendit i cili ka lidhur marrëveshje me transportuesin e huaj, do t'i lejohet orari i vozitjes dhe do t'i lëshohet leje në pajtim me nenin 24-a të këtij ligji.

Nëse në afatin nga paragrafi 3 të këtij neni transportuesi i huaj nuk lidh marrëveshje të re me transportues të ri të vendit, i tërhiqet leja dhe orari i vozitjes edhe transportuesit të huaj.

### **Neni 38-v**

Nëse linja ndërkombëtare mbahet njëanshëm vetëm nga transportuesi i huaj, gjatë parashtrimit të kërkesës për vazhdimin e lejes para skadimit të vlefshmërisë së lejes, transportuesi i huaj është i obliguar që të dorëzojë marrëveshje për mbajtjen e linjës me transportues të vendit.

Nëse gjatë mbajtjes së linjës për transport të udhëtarëve në linja ndërkombëtare ekziston njoftimi në organin kompetent për shkëputjen e dyanshme të marrëveshjes për mbajtjen e përbashkët të linjës, secili nga partnerët që paraprakisht e kanë mbajtur orarin e regjistruar të udhëtimit, obligohet që më së voni në afat prej tre muajsh nga dorëzimi i njoftimit të lidh marrëveshje me partnerin e ri. Në këtë rast partnerët që paraprakisht e kanë mbajtur orarin e regjistruar të udhëtimit, janë të obliguar që në njoftim të përcaktojnë se cili transportues cilën nisje do ta mbajë, që të mundën të parashtrorjnë kërkesë para organit kompetent me partnerin e ri për lëshimin e lejes dhe miratimin e orarit të udhëtimit.

Nëse në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni, transportuesit nuk dorëzojnë marrëveshje me partnerin e ri, leja dhe orari i regjistruar i udhëtimit hiqen dhe shlyhen nga evidenca.

Nëse nga organi kompetent i shtetit të huaj ka njoftim se për linjën nuk ka pajtim sipas dispozitave në fuqi në shtetin e huaj, procedura për lëshimin ose vazhdimin e lejes do të ndërpritet, ndërsa orari i regjistruar i udhëtimit hiqet.

### **Neni 38-g**

Transportuesi mund të parashtrorjë kërkesë për bashkimin e dy apo më shumë orareve të vozitjes për transport ndërkombëtar në linjë të udhëtarëve për të cilët ka aktvendim të plotfuqishëm të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve apo leje të veçanta të vlefshme për oraret e vozitjes për të cilat kërkohet bashkim të cilët kanë stacion të njëjtë të nisjes apo të fundit lejet e veçanta të jenë në një leje dhe një orar të vozitjes.

### **Neni 39**

Transportuesi huaj nuk mund të kryejë transport të brendshëm të udhëtarëve (kobotazh) gjatë kryerjes së transportit të linjës ndërkombëtare të udhëtarëve, nëse me marrëveshje dhe kontratë ndërkombëtare nuk i është përcaktuar ndryshe.

Nëse me marrëveshje dhe kontratë ndërkombëtare është përcaktuar se mund të kryejë transport nga paragrafi 1 i këtij neni, në atë rast transportuesi i huaj duhet të posedojë leje të dhënë nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 40**

Transportuesi i huaj mund të bëjë transport në linjë transit të udhëtarëve përmes territorit të Republikës së Maqedonisë vetëm në bazë të lejes që e jep Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Me lejen për transit nuk mund të lejohet hipja dhe zbritja e udhëtarëve në territorin e Republikës së Maqedonisë nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe.

## Neni 41

*I fshirë* 9

## Neni 42

Dispozitat nga neni 24 deri 35 të këtij ligji, që kanë të bëjnë për transportin në linjë ndërkombëtare të udhëtarëve kanë të bëjnë edhe për transportin në linjë ndërkombëtare të udhëtarëve nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe.

### 1.4. Transporti në linjë të posaçme i udhëtarëve

## Neni 43

Transport i veçantë i linjës së udhëtarëve është transporti vetëm i një grupi të caktuar të udhëtarëve me përjashtim të udhëtarëve të tjerë. Me transport të linjës së veçantë të udhëtarëve kryhet transporti i nxënësve prej shtëpie deri në shkollë dhe anasjelltas, i punëtorëve nga shtëpia deri në vendin e punës dhe anasjelltas, punëtorëve të cilët kryejnë punë sezonale nga shtëpia deri në vendin e punës dhe anasjelltas, i personave ushtarakë nga shtëpia deri në vendin e punës dhe anasjelltas, transporti i personave që kanë nevojë për kurim mjekësor nga shtëpia deri tek institucioni shëndetësor dhe anasjelltas, nëse transportin e atyre personave e organizon i njëjti. Udhëtarët që transportohen duhet të shënohen në listën e udhëtarëve që është pjesë përbërëse e marrëveshjes për kryerjen e llojit të tillë të transportit, me ç'rast në automjet mund të ketë maksimum 10% të udhëtarëve që nuk janë shënuar në listën e udhëtarëve. Udhëtarët duhet me vete të kenë dokument identifikimi të lëshuar nga porositësi i transportit.

Transport i veçantë i linjës së udhëtarëve është edhe transporti që është i domosdoshëm për kryerjen e llojit tjetër të transportit (transport nga dhe deri tek aeroporti) me ç'rast udhëtarët që barten nuk duhet të jenë të shënuar në listën e udhëtarëve që është pjesë përbërëse e marrëveshjes për kryerjen e këtij lloji të transportit.

Për kryerjen e transportit të veçantë të linjës së udhëtarëve nga neni 1 të këtij neni, porositësi i transportit mund të jetë shkolla në të cilën mësojnë nxënësit që barten, ndërmarrja ose organi ku janë të punësuar punëtorët të cilët barten, institucioni shëndetësor ku shërohen personat të cilët barten dhe ndërmarrja që bën shërbime të aeroportit.

Porositësi i transportit dhe transportuesi lidhin marrëveshje me shkrim me të cilën rregullohet të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

Pjesë përbërëse e marrëveshjes për kryerjen e transportit është lista e udhëtarëve që transportohen dhe e njëjta duhet doemos të verifikohet nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ose nga komunat ose Qyteti i Shkupit. Gjatë kryerjes së transporti në linje të veçantë nga paragrafi 2 i këtij neni nuk nevojitet listë e udhëtarëve.

Me përjashtim për transport të personave ushtarakë nga shtëpia deri në punë dhe anasjelltas lista e udhëtarëve nuk është pjesë përbërëse e marrëveshjes për kryerje të transportit. Gjatë transportit të personave ushtarakë nga shtëpia deri në punë dhe anasjelltas është e obligueshme

që në automjet nga ana e shfrytëzuesit të transportit të ketë person i cili do të jetë i obliguar me listën e udhëtareve të cilët transportohen.

Me përjashtim të paragrafit 5 të këtij neni për transport të punëtorëve të cilët kryejnë punë sezonale prej shtëpisë deri në punë dhe anasjelltas lista e udhëtarëve nuk është pjesë përbërëse e marrëveshjes për kryerje të transportit, por ajo detyrimisht gjendet në automjet gjatë kryerjes së transportit.

Transport i veçantë i linjës së udhëtarëve kryhet me autobusë, kurse mund të kryhet edhe me automjete udhëtimi 8+1 ulëse, në bazë të marrëveshjes së lidhur me shkrim ndërmjet personit juridik që e porosit transportin dhe transportuesit person juridik. Marrëveshja doemos duhet të lidhet ekskluzivisht me transportues ose me konsorcium të transportuesve të cilët kanë në pronësi ose në mënyrë të ndërsjellë kanë lidhur marrëveshje për shfrytëzimin e numrit të mjaftueshëm të automjeteve për eksploatim të relacioneve të cilat janë theksuar në marrëveshjen. Transportuesi ose konsorciumi i transportuesve, transportin do ta kryejë ekskluzivisht me automjetet të cilat i kanë theksuar gjatë lidhjes së marrëveshjes për transport dhe të cilët i plotësojnë standardet minimale teknike-eksploatuese të caktuara në konkursin publik ose të cilët plotësojnë standarde teknike – eksploatuese të njëjta ose më të larta nga ato të cilat janë ofruar në konkursin publik. Mosrespektimi i dispozitave nga ky paragraf paraqet bazë për prishjen e marrëveshjes për transport.

Gjatë kryerjes së transportit të veçantë të linjës së udhëtarëve nga paragrafi 1 të këtij neni, në automjet patjetër duhet të gjendet certifikata e licencës, leja me orar të udhëtimit me stacione dhe termine për nisje dhe arritje, urdhëruddhëtimi në origjinal dhe marrëveshja me listën e udhëtarëve.

Gjatë kryerjes së transportit të veçantë të linjës nga paragrafi 2 të këtij neni në automjet patjetër duhet të gjendet ekstrakti i licencës, leja urdhëruddhëtimi në origjinal dhe marrëveshja.

Transportuesi mund të kryejë transport në linjë të veçantë nëse posedon licencë përkatëse sipas këtij ligji dhe nëse posedon automjete me ekstrakte të licencës aq sa nevojitet që të mund t'i mbajë të gjitha nisjet sipas lejes për transport në linje të veçantë duke i përfshirë edhe automjetet që i nevojiten për mbajtjen e orarit të udhëtimeve transport në linje ndërurbane, ndërkombëtare ose të veçantë që tanimë i posedon.

## **Neni 44**

Për realizimin e transportit nga neni 43 i këtij ligji, transportuesi doemos duhet të sigurojë leje.

Nëse transporti bëhet ndërmjet dy ose më shumë komunave, lejen e lëshon Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Kundër vendimit nga paragrafi 2 të këtij neni, me të cilin refuzohet kërkesa për lëshimin e lejes për kryerjen e transportit të udhëtarëve në linjë të veçantë, mund të paraqitet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, pranë nga sfera e transportit dhe ndërlidhjeve.

Nëse transporti kryhet në rajonin e komunës, respektivisht të Qytetit të Shkupit, lejen e lëshon kryetari i komunës respektivisht kryetari i Qytetit të Shkupit.

Kundër vendimit nga paragrafi 4 të këtij neni, me të cilin kërkesa refuzohet, mund të paraqitet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e

pranimit të vendimit, pranë Ministrisë të Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Formën dhe përmbajtjen e lejes për transport të udhëtarëve në linjë të veçantë e përcakton ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Kërkesës për lëshimin e lejes, transportuesi është i obliguar t'i bashkëngjijë:

- marrëveshje të lidhur me personin juridik me listën e udhëtarëve të cilët do të transportohen,
- terminë kohorë për nisjen dhe kthimin në të cilët realizohet transporti, dhe **10**

Leja lëshohet me afat vlefshmërie për të cilin janë marrë vesh transportuesi dhe porositësi i transportit, e më së gjati për periudhë njëvjeçare.

Me përjashtim të paragrafit 8 të këtij neni leja për transport të punëtorëve të cilët kryejnë punë sezonale lëshohet për periudhë jo më të gjatë se tre muaj.

Udhëtarët të cilët transportohen me llojin e këtillë të transportit, doemos të kenë pranë vetes provë për identifikim.

### **Neni 45**

*I fshirë* **11**

## **2. TRANSPORTI I LIRË I UDHËTARËVE**

### **Neni 46**

Transporti i lirë i udhëtarëve mund të kryhet në komunikacion rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar nëse transportuesi posedon licencë për transport të lirë të udhëtarëve dhe licencë për transport të lirë ndërkombëtar të udhëtarëve.

Transporti lirë i udhëtarëve në komunikacionin rrugor të brendshëm mund të kryhet me autobusë ose me automjete me 8+1 ulëse, kurse transporti i lirë i udhëtarëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar mund të kryhet me autobusë (automjete me mbi 8+1 ulëse).

Transporti i lirë i udhëtarëve në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar rrugor është transport i grupit të organizuar më parë të udhëtarëve, pa hipje dhe zbritje të udhëtarëve gjatë rrugës, për të cilët kryerja, çmimi i transportit dhe i kushteve të tjera verifikohen me marrëveshje ndërmjet transportuesit dhe porositësit të transportit si person juridik.

Transporti i lirë i udhëtarëve nuk guxon të ketë elemente të transportit të linjës dhe transportit të veçantë të linjës siç janë: relacioni, koha e nisjes dhe arrijtes, vend hyrjet dhe vend daljet e udhëtarëve.

Transporti i lirë ndërkombëtar i udhëtarëve mund të kryhet si i përkohshëm dhe i ndryshueshëm.

### **Neni 47**

Transporti i përkohshëm mund të bëhet si:

- "vojitje qarkore" – sistem i dyerve të mbyllura (ekskursione, udhëtime turistike etj.) e cila fillon dhe mbaron në vendin e nisjes, gjatë së cilës

grupi i njëjtë i udhëtarëve transportohet me të njëjtin automjet në tërë rrugën;  
- transport i udhëtarëve me automjet të mbushur në nisje dhe automjeti i zbrazët në kthim,  
- transporti i udhëtarëve me automjet të zbrazët në nisje dhe automjet të mbushur gjatë kthimit.

### **Neni 48**

Transporti periodik është transporti i grupeve të organizuara paraprakisht për më shumë udhëtime nga i njëjti vend i nisjes deri te i njëjti vend i arritjes.

Secili grup i udhëtarëve i cila e ka kryer udhëtimin në nisje kthehet në vendin e nisjes me ndonjë vozitje të më vonshme në të njëjtën përbërje sipas terminëve nga cikli i udhëtimit në pajtim me programin me ç'rast terminët e udhëtimit nuk mund të jenë në intervale më të vogla se shtatë ditë. Vozitja e parë gjatë kthimit dhe vozitja e fundit në nisje bëhen me automjet të zbrazët.

Gjatë kryerjes së transportit të pandryshueshëm, në automjetin duhet të gjenden listat e udhëtimit nga të gjitha transportet e kryera nga cikli i udhëtimit.

### **Neni 49**

Gjatë kryerjes së vozitjes së lirë të udhëtarëve në komunikacionin rrugor të brendshëm në autobus doemos të gjendet ekstrakti i licencës, fletudhëtimi në origjinal, marrëveshja e lidhur midis transportuesit dhe porositesit të shërbimit dhe listës së udhëtarëve të nënshkruar nga transportuesi.

Gjatë kryerjes së transportit të lirë të udhëtarëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar, transportuesi doemos të ketë ekstrakt të licencës, fletudhëtimi në origjinal, listë e evidentimit për transport të udhëtarëve, marrëveshje të lidhur midis transportuesit dhe porositesit të shërbimit dhe listën e udhëtimit të plotësuar drejtë dhe saktë në formularë të përcaktuar, të nënshkruar dhe vërtetuar nga transportuesi dhe të vërtetuar nga organet kompetente doganore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Drejtoria doganore).

Formulari i listës së udhëtimit nga paragrafi 2 i këtij neni dhe mënyrën e plotësimit të saj e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe. <sup>12</sup>

### **Neni 50**

Transporti i lirë i udhëtarëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar nga neni 47 i këtij ligji, mund të bëhet pa leje, ndërsa transporti nga neni 48 i këtij neni bëhet me leje, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është përcaktuar më ndryshe.

Lejen nga paragrafi 1 të këtij neni me kërkesë të transportuesit e jep Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Formularin e lejes nga paragrafi 1 të këtij neni e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve. Ministria e Transportit dhe Lidhjeve lejet për transport të lirë të linjave në komunikacionin rrugor ndërkombëtar i shkëmben me organin kompetent të shtetit tjetër në bazë të marrëveshjes ose kontratës ndërkombëtare, në fund të vitit në vijim për vitin vijues.

## Neni 51

Nëse transporti i lirë ndërkombëtar i udhëtarëve bëhet me lejen në automjet doemos ta ketë edhe lejen në origjinal.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mban regjistër për lejet e lëshuara për transport të lirë në komunikacionin rrugor ndërkombëtar.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi 2 të këtij neni e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

### 2.1. Transporti i udhëtarëve auto - taksi

## Neni 52

Transporti me auto - taksi bëhet në bazë të licencave.

Me transportin auto - taksi barten udhëtarë brenda komunës së caktuar me licencë.

Me transportin auto taksi mund të transportohen edhe udhëtarët nga komuna e përcaktuar në licencë deri në komunën tjetër ose deri në qytetin e Shkupit

Formën dhe përmbajtjen e ditarit nga paragrafit 3 të këtij neni, e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## Neni 53

Përveç kushteve për kryerjen e transportit auto - taksi të udhëtarëve të përcaktuar me dispozitat e këtij ligji, autotaksi transportuesit doemos t'i plotësojnë edhe kushtet nga ana e Këshillit të komunës ose të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

## Neni 54

Me aktin e Këshillit të komunës ose të Këshillit të Qytetit të Shkupit veçanërisht përcaktohen kushtet në lidhje me:

- lokacionin dhe kapacitetet e taksi stacioneve;
- shënimi dhe pajisja e taksi stacioneve,
- ngjyra e veturave,
- shenja dhe pajisje të unifikuara të automjetit për taksi,
- tarifa dhe mënyra e shfrytëzimit të taksi stacioneve.
- numri maksimal i automjeteve taksi me të cilat mund të bëhet transporti i udhëtarëve me auto - taksi,

Stacionet e përcaktuara të taksive mund t'i shfrytëzojnë vetëm transportuesit auto - taksi të cilët kanë licencë nga komuna në rajonin e së cilës kanë seli.

Në komunat ku ka aeroport, stacion të taksive, nuk mund të përcaktohet në hapësirën me të cilën ekonomizon ndërmarrja me aeroportin.

Ndërmarrja e cila ekonomizon me aeroportin mund të lidhë marrëveshje për shërbim për transportin e udhëtarëve prej dhe deri në aeroport me një ose më tepër taksi kompani me ç'rast mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës me të cilën ekonomizon ndërmarrja do ta rregullojë me marrëveshje për shërbime.



Ndërmarrja e cila ekonomizon me aeroportin, është e obliguar të sigurojë qasje deri te udhëtari i aeroportit për shkak të zbritjes pa pengesa të udhëtarëve, të cilët transportohen deri në aeroport. Kompanitë auto - taksi të cilat bëjnë transportim të këtyre deri në aeroport kurse nuk kanë lidhur marrëveshje me ndërmarrjen e cila ekonomizon me aeroportin, pas shërbimit të kryer janë të obliguara që menjëherë të largohen nga aeroporti.

### **Neni 55**

Gjatë kryerjes së transportit auto - taksi, në veturë doemos të ketë certifikatë për shofer autotaksi, taksimetër në gjendje të rregullt, të plombuar dhe të bazhduar.

Gjatë kryerjes së transportit doemos duhet të jetë i aktivuar taksimetri dhe çmimi i transportit të paguhet në bazë të shumës së caktuar në taksimetër me dhënien e llogarisë fiskale.

Në kulmin e veturës dhe në pjesët anësore me të cilën bëhet transporti auto - taksi i udhëtarëve doemos të jetë spikatur emri "TAXI", ndërsa në pjesët anësore krahas emrit taksi edhe numri nga regjistri i transportuesve taksi.

Në automjetet detyrimisht në vend të dukshëm mbi taksimetrin duhet të jetë e theksuar lista e çmimit me tarifa të përcaktuara sa kushton transporti dhe ekstrakti i licencës për automjetin me të cilin kryhet transporti të vënë në xhamin e përparmë nga ana e vozitësit.

Gjatë kryerjes së transportit auto taksi kur automjeti taksi është i zbrazët, pa pasur udhëtarë dhe pa pasur ftesë të paralajmëruar duhet të marrë udhëtar, transportuesi mund të qëndrojë ekskluzivisht në vendqëndrime auto taksi të caktuara nga ana e komunave ose Qyteti i Shkupit.

## **3. STACIONET E AUTOBUSËVE**

### **Neni 56**

Personi juridik ose fizik që menaxhon me stacionin e autobusëve është i detyruar të bëjë pranimin dhe përcjelljen e autobusëve në kohën e paraparë me orarin e vozitjes të udhëtarëve dhe bagazhit, shitjen e biletave, marrjen dhe ruajtjen e bagazhit, t'u japë informata udhëtarëve dhe transportuesve dhe të bëjë shërbime tjera lidhur me transportin e udhëtarëve.

Personi juridik ose fizik që menaxhon me stacionin e autobusëve mund të kryejë rezervime dhe shitje të biletave vetëm për linjat për të cilat është lëshuar leje dhe është regjistruar itinerar.

### **Neni 57**

Personi juridik ose fizik i cili menaxhon me stacionin e autobusëve të kategorizuar është i obliguar të japë shërbime nën kushtet e njëjta për të gjithë transportuesit të cilët bëjnë transport të udhëtarëve në linjë.

Për shfrytëzimin e shërbimeve të stacionit të kategorizuar të autobusëve stacionit të autobusëve, transportuesit paguajnë kompensim. <sup>13</sup>

Lartësinë e kompensimit për shfrytëzimin e shërbimeve të stacionit të autobusëve e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë varësisht nga kategoria e stacionit dhe nga lloji i transportit (transport udhëtarësh në

linjë ndërkomunale dhe transport të lirë udhëtarësh dhe transport udhëtarësh në linjë ndërkombëtare dhe transport të lirë udhëtarësh).

Transportuesi nuk paguan kompensim në emër të provizionit në rastin e shitjes personale të biletave të udhëtimit për transport në linja ndërkombëtare të udhëtarëve për linja personale ndërkombëtare të autobusëve nëpërmjet sistemit unik për shitje të biletave të autobusit, e kompensimi nga shitja e biletave paguhet drejtpërdrejt në llogarit të transportuesit.

Stacionet e autobusëve kategorizohen në katër kategori edhe atë e para, e dyta, e treta dhe e katërta.

Kategorizimin nga paragrafi 5 i këtij neni e përcakton Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve në varësi nga: pajimi i tyre, sipërfaqet e komunikacionit të dedikuara për pranimin dhe për përcjelljen e autobusëve, hapësira e parkingut e dedikuar për qëndrimin e automjeteve kur janë në pushim dhe përmbajtjet e tjera shoqëruese të cilat funksionojnë në hapësirën e stacionit të autobusëve.

Personi juridik ose fizik i cili menaxhon me stacionin e autobusëve ose të cilit i është ngarkuar menaxhimi me stacionin e autobusëve, dorëzon kërkesë për përcaktimin e kategorisë së stacionit të autobusëve në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve.

Me kërkesë nga paragrafi 7 i këtij neni detyrimisht bashkëngjitet shtojcë e planit valid urbanistik ose projektit urbanistik me dedikim konkret të tokës sipërfaqe publike për komunikacion ose të stacionit të autobusëve ose leje të plotfuqishme për ndërtim të stacionit të autobusit ose sipërfaqes publike të komunikacionit ose dëshmi për pronësi ose aktvendim për legalizim të objektit të ndërtuar pa leje për ndërtim të stacionit të autobusit ose sipërfaqes publike të komunikacionit.

Nëse është bërë kategorizimi i stacionit të autobusëve, kërkesë e re nga personi juridik ose fizik i cili udhëheq me stacionin e autobusëve për kategori më të lartë, nuk mund të paraqitet para skadimit të 60 ditëve nga plotfuqishmëria e aktvendimit për kategorizim. Për kërkesën e re nuk është e obligueshme dorëzimi i dëshmisë nga paragrafi 8 i këtij neni.

Pajisjen e duhur dhe mënyrën e përcaktimit të kategorisë së stacioneve të autobusëve i përcakton ministri i Transportit dhe Ndërlidhjeve.

## **Neni 57-a**

Kategorizimi i stacionit të autobusëve mundet të hiqet nëse:

- personit juridik ose fizik që menaxhon me stacionin e autobusëve parashtrohet kërkesë për heqjen e kategorizimit të stacionit të autobusëve,
- personi juridik ose fizik që menaxhon me stacionin e autobusëve pushon t'i plotësojë kushtet për kategorizim të stacionit të autobusëve dhe
- në komuna ku ka kategorizim të dy stacioneve të autobusëve, personi juridik ose fizik që menaxhon me njëri stacion të autobusëve parashtrohet kërkesë për heqjen e kategorizimit të stacionit tjetër të autobusëve për shkak të mos plotësimit të kushteve të kategorizimit".

Në rast të kërkesës së parashtuar për heqjen e kategorizimit në bazë të paragrafit 1 alinesë 3 të këtij neni, ministria me detyrë zyrtare i grumbullon dëshmitë për përcaktimin e bazimit të kërkesës.

Me kërkesën e parashtuar për heqjen e kategorizimit të stacionit të autobusëve Ministria e Transportit dhe Lidhjeve do të miratojë aktvendim në afat prej 15 ditësh nga dita e kompletimit të kërkesës.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 3 i këtij neni mund të ngritët kontekst administrativ.

### **Neni 57-b**

Kategorizim në kategori më të ulët të stacionit të autobusëve mund të caktojë nëse:

- personi juridik apo fizik i cili menaxhon me stacionin e autobusëve parashtron kërkesë për kategorizimin e stacionit të autobusëve në kategori më të ulët,
- personi juridik apo fizik i cili menaxhon me stacionin e autobusëve ka pushuar t'i plotësojë kushtet për kategorizimin e stacionit të autobusëve në kategorinë në të cilën është kategorizuar përkatësisht kur plotëson kushte për kategorizim më të ulët,
- në komunat ku ka dy stacione të kategorizuara të autobusëve, personi juridik apo fizik i cili menaxhon me njërin stacion të autobusëve parashtron kërkesë për ndryshimin e kategorizimit në kategori më të ulët të stacionit tjetër të autobusëve për shkak të plotësimit të kushteve për kategori më të ulët.

Në rast të kërkesës së parashtruar për ndryshimin e kategorizimit në bazë të paragrafit 1 alinesë 3 të këtij neni, Ministria me detyrë zyrtare siguron dëshmi për shkak të përcaktimit të bazës së kërkesës.

Pas kërkesës së parashtruar për ndryshimin e kategorizimit të stacionit të autobusëve Ministria do të miratojë aktvendim në afat prej 15 ditësh nga dita e kompletimit të kërkesës.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 3 i këtij neni mund të ngritet kontest administrativ.

### **Neni 58**

Personi juridik apo fizik i cili menaxhon me kategorizimin e stacionit të autobusëve mund të pranojë dhe pajisë edhe autobusë me të cilët bëhet transporti falas i udhëtarëve në pajtim me numrin në dispozicion të peroneve të veçanta për këtë dedikim që duhet të jenë të shënuar në mënyrë të veçantë.

### **Neni 59**

Orari i punës i stacionit të kategorizuar të autobusit stacioneve të autobusit doemos duhet të jetë i harmonizuar me kohën e nisjes dhe arritjes së autobusëve edhe atë së paku 15 minuta para nisjes dhe 15 minuta pas arritjes së autobusit të linjën së fundit. 14

### **Neni 60**

Personi juridik apo fizik i cili menaxhon me stacionin e kategorizuar të stacionit është i detyruar të mbajë ditar në formë elektronike apo në letër për arritjen dhe nisjen e autobusëve.

Personi juridik apo fizik i cili menaxhon me stacionin e kategorizuar të autobusëve është i detyruar njëherë në muaj ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror për Transport për moskryerjen e transportit në linjë të caktuar.

Shoferi i autobusit është i detyruar ta paraqesë kohën e secilës arritje dhe nisje të autobusit në stacionin e kategorizuar të autobusëve, gjatë së cilës në urdhëresën rrugore stacioni i autobusit e vërteton kohën e arritjes dhe nisjes së automjetit.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit nga paragrafi 1 dhe raportin nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 61**

Transportuesi doemos duhet ta informojë stacionin më të afërt të autobusit nëse gjatë kohës së transportit ndodhin pengesa për shkak të së cilave parashihet vonesa mbi 60 minuta.

Stacioni i autobusëve që do ta pranojë informatën e tillë është i detyruar për atë menjëherë ta informojë stacionin e vijues të linjës.

## **V. TRANSPORTI I MALLRAVE**

### **Neni 62**

Transporti i mallrave mund të bëhet si transport i mallrave të brendshëm dhe ndërkombëtar në komunikacionin rrugor.

### **Neni 63**

Transporti i mallrave në komunikacionin e brendshëm mund të bëhet si transport publik i mallrave dhe si transport i mallrave për nevoja personale.

### **Neni 64**

Transport publik i mallrave në komunikacionin rrugor është transporti për të cilin relacioni, çmimi i transportit dhe kushtet tjera të transportit përcaktohen me marrëveshje midis transportuesit dhe porositësit të transportit.

Transportuesi mund të fillojë me kryerjen e transportit pasi që të fitojë licencë.

Transportuesi është i detyruar ekstraktin e licencës gjithmonë ta mbajë në automjet.

Gjatë kryerjes së transportit të brendshëm të mallit, përveç ekstraktin e licencës transportuesi është i detyruar në automjet të ketë edhe urdhëruhdëtimin edhe fletëngarkesën për mallin i cili është në automjet.

Formën dhe përmbajtjen e fletëngarkesës për transportin e brendshëm të mallrave e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 65**

Transporti ndërkombëtar i mallrave në komunikacionin rrugor mund të bëhet si transport bilateral, transit dhe transport për në vende të treta dhe nga vendet e treta.

### **Neni 66**

Transportuesi i vendit mund të bëjë transport ndërkombëtar të mallrave nëse paraprakisht ka licencë për transport ndërkombëtar të mallrave.

Krahas ekstraktit të licencës, në automjet transportuesi doemos duhet të ketë certifikatë për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin rrugor

ndërkombëtar, fletudhëtim, fletëngarkesës ndërkombëtar dhe leje për transport ndërkombëtar të mallit nëse ajo kërkohet në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare ose me kontratën për transport të udhëtarëve dhe të mallrave në komunikacionin rrugor të lidhur ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe vendit deri te i cili ose prej të cilit ose përmes territorit të të kryhet transporti (në tekstin e mëtejme: leje transportuese individuale).

Transporti ndërkombëtar i mallrave mund të kryhet edhe në bazë të lejeve të kuotës multilaterale të lejeve të Konferencës Evropiane të Ministrave të Transportit (KEMT) (në tekstin e mëtejme: KEMT leje). Sipas afatit të vlefshmërisë KEMT leja mund të jetë mujore, me vlefshmëri prej 30 ditësh, dhe vjetore me vlefshmëri prej një viti kalendarik.

## **Neni 67**

Ministria e Transportit dhe Lidhje i merr lejet për transport ndërkombëtar të mallrave nga organi kompetent i vendit tjetër në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të lidhur.

Lejet multilaterale (EKMT) Ministria e Transportit dhe Lidhjeve i merr prej Sekretariatit të Konferencës Evropiane të Ministrave të Transportit.

## **Neni 68**

Ndarjen e lejeve nga neni 67 nga ky ligj e bën Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Ndarja dhe distribuimi i lejeve kryhet në mënyrë elektronike në bazë të kriterëve vijuese:

- 1) numrit të automjeteve motorike për bartje të regjistruara për transport ndërkombëtar të mallrave për të cilat ka ekstrakt të licencës;
- 2) numrit dhe kualitetit të parkut vozitës: për lejet transportuese individuale nga EO - E5 dhe më tepër, kurse për KEMT lejet nga E5-E6 dhe më tepër;
- 3) numrit të vozitësve në marrëdhënie të rregullt pune, që posedojnë certifikatë adekuate;
- 4) numrit të lejeve transportuese të shfrytëzuara individualisht, përkatësisht të shfrytëzuara në mënyrë efikase të KEMT lejeve;
- 5) lartësisë së fitimit nga puna pas tatimit (bilanci i suksesit nga viti paraprak);
- 6) lartësisë së të ardhurave të përgjithshme nga veprimtaria kryesore (formulari i strukturës së të ardhurave nga veprimtaria - formulari - SPD për vitin paraprak) dhe
- 7) minimum një vit të kryerjes së veprimtarisë themelore, transport publik ndërkombëtar për pjesëmarrje në përndarjen e KEMT lejeve.

Mënyrën e ndarjes, distribuimit dhe revizionit të shfrytëzimit të lejeve për transport ndërkombëtar të mallrave, në pajtim me kriteret nga paragrafi 2 të këtij neni, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

## **Neni 69**

Lejen për transport ndërkombëtar të mallrave mund ta marrë transportuesi që ka licencë për kryerjen e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe që i plotëson kriteret nga neni 68 paragrafi 2 i këtij ligji.

Kërkesa për marrjen e lejes nga paragrafi 1 të këtij neni i parashtrohet Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Për marrjen e KEMT lejeve, transportuesi krahas kritereve të nenit 68 paragrafi 2 i këtij ligji, doemos duhet të posedojë edhe KEMT test certifikatën për gatishmëri të qarkullimit të automjeteve ngarkuese motorike dhe shoqëruese.

Shërbimi teknik për lejimin individual të automjeteve, që të kryejë punë të lëshimit të certifikatës nga paragrafi 3 i këtij neni, duhet të jetë i autorizuar nga ana e Ministrisë, ndërsa në bazë të akreditimit nga ana e organit për vlerësimin e kompetencës.

Subjektet juridike nga paragrafi 4 i këtij neni dorëzojnë me kërkesën për marrjen e autorizimit nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dokument se kërkuesi ka autorizim për shërbim teknik për lejim individual të automjeteve dhe certifikatë nga Instituti për Akreditim për kryerjen e punëve nga paragrafi 3 i këtij neni.

Dëshmitë për plotësimin e kushteve nga paragrafi 5 i këtij neni, i siguron personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve i cili e udhëheq procedurën për marrjen e autorizimit për kryerjen e punëve nga paragrafi 3 i këtij neni, i cili është i detyruar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi 5 i këtij neni t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Personi i autorizuar zyrtar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve është i detyruar të vendosë për kërkesën për marrjen e autorizimit në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Kundër aktvendimit të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve me të cilin kërkesa për marrjen e autorizimit refuzohet mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Për lëshimin e certifikatës nga paragrafi 4 i këtij neni personi juridik arkëton kompensim.

Lartësinë e kompensimit për kontrollin e kryer për gatishmëri për komunikacion të automjeteve sipas euro standardit e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Mënyra e zbatimit të kontrollit të automjeteve në bazë të të cilit jepet certifikata nga paragrafi 3 i këtij neni, formën dhe përmbajtjen e certifikatës, si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi 5 i këtij neni i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

## Neni 69-a

Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve do t'i përjashtojë nga përndarja e lejeve KEMT dy vjet rresht të gjithë transportuesit për të cilët është marrë aktgjykim i plotfuqishëm se kanë bërë keqpërdorim të lejeve.

Për keqpërdorim të lejes CEMT nga paragrafi 1 i këtij neni do të konsiderohet transportuesi, nëse:

- ka bërë çfarëdo lloj ndryshimesh në të dhënat e shënuara në lejen ose ka falsifikuar leje,
- lejen nuk e ka përdorur në përputhje me dedikimin e saj ose ia jep transportuesit tjetër, dhe

- nuk e ka kthyer lejen e hequr CEMT, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit me të cilin e njëjta i është hequr.

### **Neni 69-b**

Bartja e tërë planit të përgjithshëm vjetor për ndarjen e lejeve ndërkombëtare nga një transportues në tjetër lejohet vetëm në rastin kur transportuesi është trashëgues juridik i transportuesit i cili ka pushuar të ekzistojë.

Nëse ekziston ndarje e pronës së transportuesit në dy ose më tepër transportues, lejohet bartja e planit të përgjithshëm për ndarje të lejeve ndërkombëtare për çdo transportues të ri në pajtim me marrëveshjen për ndarje të verifikuar te noteri ose në pajtim me aktvendimin e gjykatës kompetente.

### **Neni 69-v**

Bartja e ndërsjellë e lejeve transportuese ndërkombëtare dhe shkëmbimi i të njëjtave ndërmjet transportuesve nuk lejohet.

Shkëmbimi i KEMT lejeve në procesin e ndarjes lejohet me deklaratë me shkrim nga subjektet të parashtruar Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 69-g**

KEMT leja shfrytëzohet për transport ndërmjet shteteve anëtare të organizatës KEMT dhe transitit nëpërmjet territoreve të tyre. Shfrytëzuesi i lejes doemos duhet t'i respektojë dispozitat e Rezolutës së KEMT për mënyrën e shfrytëzimit të lejeve.

Me KEMT lejen nuk lejohet kryerja e kabotazhit brenda një vendi të caktuar anëtar i KEMT, si dhe transportit të mallrave ndërmjet vendeve anëtare dhe vendeve që nuk janë anëtare të KEMT-së.

Udhëzimin për shfrytëzimin e KEMT lejeve, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve e shpall në ueb faqen e vet të internetit.

### **Neni 69-d**

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, me aktvendim do të tërheqë KEMT lejen, nëse:

- transportuesit i ka skaduar afati i vlefshmërisë së licencës për kryerjen e transportit ndërkombëtar të mallrave ose me aktvendim i është tërhequr licenca,
- transportuesi dy herë radhazi nuk parashtron raport për shfrytëzimin e KEMT lejes dhe
- transportuesi i vendit nuk e shfrytëzon lejen në pajtim me udhëzimin e KEMT për shfrytëzim. Transportuesi patjetër duhet që në afat prej tetë ditësh nga dorëzimi i aktvendimit për tërheqje, t'ia kthejë lejen KEMT. Nëse nuk e kthen në afatin e caktuar, transportuesit nuk i distribuohen leje transportuese individuale deri në momentin e kthimit të lejes.

Transportuesit të cilit është tërhequr leja, ka të drejtë që serish të parashtrorë kërkesë për pjesëmarrje në ndarjet e KEMT lejeve për vitin vijues.

Leja e tërhequr nga paragrafi 1 të këtij neni i ndahet transportuesit tjetër nga lista e verifikuar gjatë ndarjes së lejeve.

Në rastin kur transportuesi e ka asgjësuar, humbur ose i është vjedhur leja patjetër duhet që të njëjtën ta shpallë të pavlefshme në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë". Pas parashtrimit të kërkesës me shkrim dhe vërtetimit për shpalljen e KEMT lejes të pavlefshme, Ministria e Transportit dhe Lidhje i lëshon KEMT leje të re nga kuota rezervë dhe për atë informon Sekretariatit e KEMT, Drejtorinë Doganore dhe Inspektoratin Shtetëror për Transport.

### **Neni 69-gj**

Lejet ndërkombëtare për transport, transportuesi mund t'i shfrytëzojë vetëm për mjet transportues për të cilin posedon certifikatë të licencës për transport të mallit për komunikacion ndërkombëtar.

Leja për transport ndërkombëtar patjetër duhet të qëndrojë në automjet gjatë tërë kryerjes së transportit dhe t'i jepet për kontroll organit kompetent me kërkesën e tij.

Transportuesi, lejen për transport ndërkombëtar nuk mund t'ia japë transportuesit tjetër e as ta shkarravisë ose t'ia ndryshojë të dhënat e shkruara.

### **Neni 70**

Transportuesi i huaj i regjistruar në vendin me të cilin Republika e Maqedonisë ka lidhur marrëveshje për transport ndërkombëtar të mallrave në komunikacionin rrugor, bën transportin ndërkombëtar të mallrave në Republikën e Maqedonisë në bazë të lejes për transport të mallrave të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është përcaktuar që transporti të bëhet pa leje.

Ministria i Transportit dhe Lidhjeve, lejet për transport ndërkombëtar të mallrave ia jep organit përgjegjës të vendit në të cilin transportuesi i huaj është regjistruar.

Transportuesi i huaj mundet transportin ndërkombëtar të mallrave ta kryejë edhe në bazë të lejes EKTM

Transporti ndërkombëtar i mallrave me automjet të huaj dhe rimorkio (grup automjete) bëhet në bazë të një lejeje.

Nëse automjeti i huaj dhe rimorkio, në grupin e automjeteve, kanë shenja regjistruese të vendeve të ndryshme, nevojitet vetëm leja për automjetin.

Transportuesi i huaj lejen ndërkombëtare të nuk guxon t'ia japë transportuesit tjetër as t'i korrigjojë t'i ndryshojë të dhënat e shkruara. Leja në mënyrë rregullt dhe të plotë plotësohet para fillimit të transportit territorin e Republikës së Maqedonisë.

Leja për transport ndërkombëtar të mallrave e plotësuar në mënyrë të rregullt. doemos duhet të gjendet në automjetin e huaj gjatë tërë kohës deri sa gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa kontrollin e bëjnë drejtoria doganore, inspektorët për komunikacion rrugor dhe policia. 15

Transportuesi i huaj është i detyruar transportin ndërkombëtar të mallrave ta bëjë në pajtim me lejen e lëshuar për transport ndërkombëtar dhe kushteve të përcaktuara nga Sekretariati i Konferencës Evropiane të Ministrave të Transportit dhe Lidhjeve për shfrytëzimin e EKMT lejeve.



Formën dhe përmbajtjen e lejeve për transport ndërkombëtar të mallit e përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Gjatë kryerjes së transportit në territorin e Republikës së Maqedonisë, transportues i huaj doemos duhet të ketë në dokumente origjinale për automjetin dhe për shoferin në pajtim me rregullat e shtetit të regjistrimit të transportuesit për kryerje të veprimtarisë dhe aftësim profesional të shoferit, nëse rregulla të tilla janë në fuqi.

Transportuesi i huaj nëse është nga shteti nënshkrues i konventës CMR, për mallin të cilin e transporton doemos duhet të ketë në automjet formular CMR të fletëngarkimit të plotësuar në mënyrë të rregullt, ndërsa të dhënat e shënuara në lejen e përkohshme të komunikacionit (COLL) dhe/ose lejen e komunikacionit për automjetin, definojnë nga cili shtet është transportuesi.

## Neni 70-a

Personat juridikë, tregtarë individë, persona fizikë, të cilët në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari, gjatë kryerjes së qarkullimit ndërkombëtar të mallit, janë të obliguar para ngarkimit ose shkarkimit të malli të kontrollojnë nëse transportuesi i huaj ka leje ndërkombëtare të transportit, nëse në mënyrë të rregullt është e përdorur, e plotësuar dhe/ose nëse leja EKMT është adekuate.

Personat e theksuar në paragrafin 1 të këtij neni, doemos duhet në lejen e kontrolluar individuale të transportit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni nga ana e pasme e lejes të shënojnë nëse bëhet fjalë për ngarkim ose shkarkim, datën, nënshkrimin dhe vulën dhe ta kopjojnë të njëjtën. Leja EKMT kontrollohet nëse i plotëson kufizimet territoriale dhe kopjohet. Kopje të lejes individuale të transportit dhe/ose lejes EKMT, respektivisht kanë vërtetuar janë të obliguar ta ruajnë dy vjet pas datës së transportit të realizuar të mallit.. **16** Kopjet nga lejet ndërkombëtare rruhen me dokumentacionin e nevojshëm për përfundim të veprimit të lejuar doganor në procedurë të eksporti dhe/ose importit në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave.

## Neni 71

Nëse transportuesi për transport bilateral dhe transit i huaj është nga vendi me të cilin Republika e Maqedonisë nuk ka lidhur marrëveshje për transport ndërkombëtar të mallrave, Drejtoria Doganore në vendkalimin kufitar ku kryhet mbikëqyrja doganore, transportuesit do t'i lëshojë leje të veçantë me arkëtimin e taksës administrative.

Transport për vendet e treta dhe nga vendet e treta nuk lejohet.

## Neni 72

Nëse Drejtoria Doganore përcakton se transportuesi i huaj gjatë hyrjes ose daljes nga Republika e Maqedonisë përkatësisht në terminalin doganor në brendinë e shtetit, i njëjti nuk posedon leje për transport ndërkombëtar të mallrave ose leja ndërkombëtare nuk është në mënyrë të rregullt e plotësuar, ndërsa transportuesi është prej vendit me të cilin Republika e Maqedonisë ka lidhur marrëveshje për transport ndërkombëtar të mallrave me të cilën është paraparë transporti të kryhet në bazë të lejeve, do ta ndalojë hyrjen, përkatësisht daljen e automjetit nga territori i Republikës së Maqedonisë.

## Neni 72-a

*I fshirë* 17**Neni 73**

Me përjashtim të dispozitave nga neni 71 nga ky ligj, leja nuk është e nevojshme për:

- 1) transportin e mallrave nga aeroporti publik dhe deri te aeroporti publik nëse ndodh avari ose fatkeqësi tjetra aeroplanit ose nëse aeroplani duhet të zbresë për shkak të drejtimit të ndërruar të fluturimit të dhunshëm ose nëse janë anuluar linjat e aeroplanit,
- 2) transportin e automjetit të dëmtuar dhe të rimorkios së tij,
- 3) transportin e kufomës,
- 4) transportin e sendeve gjatë shpërnguljes me leje adekuate speciale,
- 5) transportin e letrave postale,
- 6) transportin e eksponimeve të dedikuara për panaire dhe ekspozita,
- 7) transportin e pajisjeve dhe nevojave tjera teatrale, muzikore dhe manifestimeve tjera kulturore, shfaqjeve të cirkut ose filmit, incizimeve televizive dhe të radios.
- 8) transportin e kafshëve të ngordhura, përveç nëse bëhet fjalë për përpunim industrial,
- 9) transportin e bletëve dhe peshqve të vegjël,
- 10) transportin e materialit tjetër dhe atë të medicinës, si ndihmë në rast të fatkeqësive natyrore dhe transportin e mallrave për qëllime humanitare,
- 11) automjetet e zbrazëta me të cilat zëvendësohen automjetet e prishura dhe të cilat për transport, i marrin mallrat nga automjetet e prishura në Republikën e Maqedonisë ose vende të treta,
- 12) automjetet për ndihmë teknike për riparim të automjeteve të prishura (automjete remont - servisi),
- 13) transportin e ngarkesave ekskluzivisht për qëllime propagandistike ose për mësim,
- 14) transporti i mallrave me automjet me bartje të lejuar deri në 3.500 kg. duke përfshirë dhe rimorkion, ose me automjetin i cili nuk e tejkalon masën e lejuar maksimale 6.000 kg duke përfshirë dhe rimorkion
- 15) për automjete rimorkio me targa të përkohshme të ngarkuara me mallra komerciale;
- 16) transportin e automjeteve të blera pa ngarkim deri në vendin e destinacionit të tyre të fundit, dhe
- 17) për automjet tërheqëse dhe rimorkio me targa col, të ngarkuara me mallra që i dedikohet të njëjtit transportues, përkatësisht shfrytëzuesit të mallrave me përjashtim të automjeteve me rimorkio në cilësi të mallit.

Me përjashtim të nenit 72 dhe nenit 73 paragrafi 1 të këtij ligji, lirimi për shfrytëzim të lejes së transportit për transportues të huaj kryhet në bazë të llojeve të definuara të transporteve për lirim nga leja e transportit në pajtim me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare të lidhur me vendin e regjistrimit të transportuesit. 18

Për transportet nga paragrafi 1 të këtij neni, vozitësi në automjet duhet të ketë dokumente dhe dokumente tjera prej të cilave mund të shihet se bëhet fjalë për një nga transportet e përmendura.

**Neni 74**

Transportuesi i huaj mund të bëjë transport të brendshëm të mallrave midis vendeve të veçanta në Republikën e Maqedonisë (kabotazhë) vetëm nëse fiton leje për transport të tillë të veçantë. Transportuesi i huaj kërkesën për leje ia paraqet organit kompetent për transport në vendin në të cilin e ka selinë, ndërsa të njëjtën ia paraqet Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në Republikën e Maqedonisë.

Leja nga paragrafi 1 nga ky nen mund të jepet nëse për shkak të mungesës së kapaciteteve adekuate transportuese në vend është e domosdoshme që transportin ta bëjë transportuesi i huaj.

Lejen nga paragrafi 1 të këtij neni e jep Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 75**

Transportuesi i vendit dhe i huaj me automjet në rrugë publike që është i zbrazët ose së bashku me ngarkesën i tejkalon kushtet e përcaktuara në drejtim të dimensioneve, masës së përgjithshme, ngarkesës së boshtit, mund të bëjë transport në bazë të lejes për transport të jashtëzakonshëm.

Lejen për transport të jashtëzakonshëm me kërkesën e transportuesit të vendit dhe të huaj e jep Ndërmarrje Publike për Rrugë Shtetërore. pas marrjes së mendimit nga Ministria e Punëve të Brendshme. 19

Në lejen për transport të jashtëzakonshëm përcaktohen mënyra dhe kushtet për kryerjen e transportit dhe afati i lejes.

Procedura për dhënien e lejes është urgjente.

Leja për transport në origjinal të jashtëzakonshëm doemos duhet të gjendet në automjet.

### **Neni 76**

Transportuesit të vendit dhe të huaj që kryen transport ndërkombëtar me automjet i cili i zbrazur ose bashkë me barrën i tejkalon kushtet e përcaktuara në pikëpamje të dimensioneve, masës së përgjithshme dhe me ngarkimin e boshtit nuk do t'i lejohet hyrje, përkatësisht dalje në Republikën e Maqedonisë dhe nga Republika e Maqedonisë nëse nuk posedon leje për transport të çrregullt.

## **VI. TRANSPORTI PËR NEVOJA PERSONALE**

### **Neni 77**

Transporti për nevoja personale i udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor, është transporti që e bëjnë të vendit dhe të huaj, personat juridikë dhe fizikë për shkak të kënaqjes së nevojave, nevojat në suazat e veprimtarisë së vet.

Si transport i mallrave për nevoja personale që e bëjnë të vendit dhe të huaj, persona juridikë dhe fizikë, konsiderohet transporti, me ç'rast transportohen ekskluzivisht mallra, të cilat janë në lidhje me kryerjen e veprimtarisë së tyre themelore, me ç'rast mallrat që transportohen janë në pronësi të tyre ose janë nga ato të prodhuara dhe të shitura, të dhëna në përpunim ose ripërpunim, përmirësim ose nga ato janë dhënë për deponim etj.

Si transport i udhëtarëve për nevoja personale që e kryejnë persona të vendit dhe të huaj, fizikë dhe juridikë, konsiderohet transporti me të cilin transportohen vetëm udhëtarë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së tyre prioritare, me ç'rast udhëtarët që transportohen janë të punësuar në personin juridik që e kryen transportin.

Gjatë kryerjes së transportimit të mallrave për nevojat personale, pronari i automjetit njëkohësisht është edhe pronar i mallrave, të cilat

transportohen, ndërsa vozitësi është i punësuar te ai. Gjatë kryerjes së transportit të udhëtarëve për nevoja personale, personi juridik është pronar i automjetit me të cilën kryhet transporti, ndërsa shoferi dhe udhëtarët janë të punësuar në personin juridik.

Personat të vendit juridik dhe fizik transportin nga paragrafi 1 të këtij neni doemos duhet ta bëjnë me automjete të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara me dispozitat nga neni 5 paragrafi 2 i këtij ligji.

## Neni 78

Gjatë kryerjes së transportit të brendshëm dhe ndërkombëtar të udhëtarëve për nevoja personale, udhëtarët të cilët transportohen doemos duhet të kenë dëshmi për identifikim të lëshuar nga ai që e kryen transportin për nevoja personale.

Gjatë kryerjes së transporti nga paragrafi 1 i këtij neni., përveç dëshmisë për identifikim në automjet doemos duhet të gjendet ekstrakti i licencës në origjinal, urdhërudhëtimi dhe lista e udhëtarëve, ndërkaq për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve për nevoja personale shoferi doemos duhet të ketë certifikatë për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar. 20

## Neni 79

Gjatë kryerjes së transportit të mallrave për nevoja individuale në komunikacionin ndërkombëtar dhe të brendshëm në automjet doemos duke të gjendet:

- ekstrakti i licencës në origjinal,
- fletudhëtimi,
- certifikatë për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor, nëse kryhet transport ndërkombëtar për nevoja personale,
  - leje për transport ndërkombëtar të mallrave, nëse ajo kërkohet në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare ose marrëveshjen për transport të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor, e lidhur ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe vendit deri, prej ose nëpërmjet territorit të të cilit kryhet.
- fletëngarkimi, dhe
- dëshmia se mund të vërtetohet se bëhet fjalë për transport nga neni 77, paragrafi 2 i këtij ligji.

Dispozitat nga paragrafi 1 alineja 1 i këtij neni, nuk zbatohen për automjetet kapaciteti bartës i të cilave nuk i tejkalon 3,5 ton duke e përfshirë edhe rimorkion, të cilat shfrytëzohen për transport personal.

Për transportues të huaj dispozitat nga paragrafi 1 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen nëse ka të përcaktuara obligime ligjore nga vendi i regjistrimit të automjetit.

## VII. KOMPENSIM PËR RRUGËT

### Neni 80

Automjetet e vendit dhe të huaja për shfrytëzimin e rrugëve në Republikën e Maqedonisë paguajnë kompensim në pajtim me Ligjin për rrugët publike nëse me marrëveshje ose kontratë ndërkombëtare nuk është paraparë ndryshe.

## VIII. AUTORIZIMET E DREJTORISË DOGANORE

### Neni 81

Drejtoria Doganore, në kalimin kufitar, përkatësisht në vend tjetër ku kryhet mbikëqyrja doganore kontrollon nëse transportuesi i vendit dhe i huaj kanë leje ndërkombëtare të transportit dhe dokumente tjera dhe dokumente për automjetin, shoferin, mallin dhe/ose (fletëngarkim CMR ose plan për vozitje të shoferëve ose certifikatë nga licenca ose certifikatë për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor dhe të ngjashme), të përcaktuara në këtë ligj për kryerje të llojit përkatës të transportit dhe nëse transportuesi e kryen transportin në pajtim me ato dokumente.

Nëse drejtoria doganore përcakton se transportuesi i huaj ose i vendit nuk ka në automjet leje ndërkombëtare të transportit dhe dokumente tjera të nevojshme dhe dokumente ose ato nuk i shfrytëzon në mënyrë të përcaktuar, do të ndalojë hyrje të automjetit në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht dalje nga ajo.

Nëse drejtoria doganore gjatë kontrollit të dokumenteve për zbatim të procedurës doganore në hapësira afariste të person juridik, tregtar individual dhe person fizik të cilët kryejnë qarkullim ndërkombëtar të mallrave nuk gjen kopje nga leja ndërkombëtare e transportit dhe/ose konstaton shkelje të dispozitave nga paragrafi 1 i këtij neni në mënyrë të obligueshme e informon Inspektoratin Shtetëror për Transport.

## IX. MARRJA DHE VENDOSJA JASHTË LIGJIT E LEJES DHE NDALIMI I PËRKOHSHËM I QASJES NË RRUGËT E TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

### Neni 82

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mund të miratojë aktvendim për heqjen dhe vendosjen jashtë fuqie të lejeve nga neni 25 paragrafi 1 dhe neni 36 paragrafi 2 nëse transporti nuk kryhet në pajtim me lejen e lëshuar me propozim të Inspektoratit Shtetëror për Transport ose stacion i kategorizuar i autobusëve ose nga organ kompetent i një shteti tjetër me të cilin Republika e Maqedonisë ka lidhur Marrëveshje nga sfera e transportit në komunikacionin rrugor që është e ratifikuar.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mund të miratojë aktvendim për heqjen dhe vendosjen jashtë fuqie të lejeve nga neni 66 paragrafët 2 dhe 3 dhe neni 70 paragrafët 1 dhe 3 të këtij ligji nëse transporti nuk kryhet në pajtim me lejen e lëshuar me propozim të Inspektoratit Shtetëror për Transport ose nga organ kompetent të një shteti tjetër me të cilin Republika e Maqedonisë ka lidhur Marrëveshje nga sfera e transportit në komunikacionin rrugor dhe Komiteti EKMT në Paris që janë të ratifikuara.

Leja për transportin nga neni 36 paragrafi 2, neni 70 paragrafët 1 dhe 3 nga ky ligj e dhënë transportuesit të huaj mund t'i merret dhe të vendoset jashtë fuqisë dhe në rast nëse organi kompetent në shtet në të cilin transportuesi është regjistruar, refuzon të japë leje adekuate për transportuesin maqedonas dhe nëse transportuesi i huaj nuk e shfrytëzon lejen në pajtim me udhëzimin e KEMT për shfrytëzim.

Me vendim nga paragrafi 1 të këtij neni, leja mund të merret dhe të vendoset jashtë fuqisë në kohëzgjatje prej 1 deri 12 muaj, deri sa me vendimin nga paragrafi 2 nga ky nen leja mund të merret edhe përgjithmonë në bazë bilaterale, e leja e hequr EKMT në afat prej 30 ditësh i kthehet organit që e ka lëshuar lejen.

Me vendimin e Ministrisë të Transportit dhe Lidhjeve me të cilin merret leja për transport të udhëtarëve dhe vihet jashtë fuqisë, transportuesit i merren të gjitha kopjet e lejes për linjën në fjalë.

### **Neni 83**

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve me vendim përkohësisht do t'ia ndalojë qasjen në rrugët e territorit të Republikës së Maqedonisë transportuesit të huaj në rast të kundërvajtjeve të rënda ose përsëri të kryera në bazë të këtij ligji.

Ndalesa e përkohshme nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej 1 deri 12 muaj.

### **Neni 84**

Aktvendimin nga nenet 82 dhe 83 të këtij ligji, nëse bëhet fjalë për transport ndërkombëtar, e zbaton Ministria e Punëve të Brendshme në vendkalimet kufitare.

### **Neni 85**

Kundër vendimit nga neni 82 dhe 83 nga ky ligj mund të paraqitet ankesë në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të vendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë. 21

Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

## **X. MBIKËQYRJA**

### **Neni 86**

Mbikëqyrjen e realizimit të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij e bën Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

### **Neni 86-a**

Mbikëqyrje mbi punën e personave juridikë nga nenet 5, 8-a, 8-b dhe 69 të këtij ligji kryen Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Nëse Ministria e Transportit dhe Lidhjeve gjatë kryerjes së mbikëqyrjes përcakton se personi juridik nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në bazë të të cilave e ka marrë autorizimin ta kryejë veprimtarinë ose kandidatët nuk i aftëson sipas programit të përcaktuar ose trajnimet i zbaton personi i cili nuk ka arsim adekuat në pajtim me këtë ligj për kryerjen e trajnimit ose personi i cili nuk ka certifikatë për kryerjen e trajnimit apo nëse lëshon vërtetim për trajnim të përfunduar pa u zbatuar paraprakisht trajnim i kandidatit ose certifikatat për përgatitje të automjeteve për komunikacion i lëshon në vendin e provimit për të cilin nuk ka autorizim, mund me aktvendim në mënyrë të përhershme t'i hiqet autorizimi për kryerjen e aftësimit të kandidatëve për lëshimin e certifikatës për kompetencë profesionale të drejtorit përkatësisht personit të autorizuar për transport,

certifikata për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor përkatësisht ose lëshim të certifikatave për përgatitje të automjeteve për komunikacion.

Aktvendimi nga paragrafi 2 i këtij neni është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngrihet kontest juridik pranë gjykatës kompetente.

Ngritja e kontekstit juridik në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni 9 nuk e shtyn zbatimin e aktvendimit. 22

## **Neni 87**

Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji që kanë të bëjnë për transportin ndërkomunal të udhëtarëve të veçantë në linjë midis dy dhe më shumë komunave dhe transportit rrugor ndërkombëtar, e bën Inspektorati shtetëror për transport, përmes inspektorëve shtetërorë për transport rrugor.

Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji që kanë të bëjnë me transportin komunal të udhëtarëve, auto-taksi transportit të udhëtarëve dhe transportin e veçantë në linjë të udhëtarëve që bëhet në territorin e komunës, e bëjnë inspektorët e autorizuar për komunikacion rrugor të komunës.

Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji që kanë të bëjnë me transportin komunal të udhëtarëve, transportit auto - taksi të udhëtarëve dhe transportit të veçantë në linjë të udhëtarëve që bëhet në territorin e Qytetit të Shkupit, e bëjnë inspektorët e autorizuar për komunikacion rrugor të Qytetit të Shkupit.

Inspektorët nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni kryejnë mbikëqyrje inspektuese edhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndalim dhe parandalim të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar.

Për inspektor shtetëror të komunikacionit rrugor, për inspektor të autorizuar për komunikacion rrugor për komunën dhe inspektor të autorizuar të komunikacionit rrugor për Qytetin e Shkupit, mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj.

## **Neni 87-a**

Mbikëqyrja inspektuese të transportuesit vendor mund të kryhet në selinë e transportuesit, në hapësirat afariste të transportuesit, ose gjatë kryerjes së transportit, me ç`rast inspektorët nga neni 87 të këtij ligji kanë të drejtë ta ndalojnë dhe ta kontrollojnë automjetin.

Mbikëqyrje inspektuese e transportuesit të huaj kryhet me ç`rast inspektorët nga neni 87 i këtij ligji kanë të drejtë ta ndalin dhe kontrollojnë automjetin që qarkullon nëpër rrugët e territorit të Republikës së Maqedonisë, terminal doganor ose në vendkalimet kufitare gjatë hyrjes apo dalje nga Republika e Maqedonisë.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët nga neni 87 të këtij ligji shfrytëzojnë automjete zyrtare të shënuara në mënyrë të veçantë.

Në pajtim me dispozitat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, vozitësi që drejton automjetin me të cilin kryhet transporti, është i obliguar të

ndalohet në vend, të cilin do ta caktojë inspektori me dhënien e shenjave të caktuara.

Kontrrolli i automjetit nënkupton kontrollin e automjetit, të udhëtarëve dhe të mallrave të cilat transportohen në periudhën e kontrollit dhe të gjithë dokumentacionit transportues të paraparë me këtë ligj dhe me marrëveshjen dhe kontratën ndërkombëtare

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët nga neni 87 të këtij ligji mund të kërkojnë ndihmë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë.

### **Neni 87-b**

Inspektorati Shtetëror për Transport është organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në cilësinë e personit juridik, ka llogarinë e vet si shfrytëzues buxhetor i vijës së parë, në mënyrë të pavarur zbaton procedura për punësim në pajtim me ligjin dhe vendos për të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës.

Me Inspektoratin shtetëror për transport udhëheq drejtori të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Për emërimin e drejtorit shpallet konkurs publik në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, prej të cilëve një nga gazetatat të cilat botohen në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilit flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Për drejtor të Inspektoratit shtetëror për transport mund të emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose ka përfunduar shkallën VII/1 nga sfera teknike ose shkencave juridike,
- ka së paku pesë vjet përvojë pune nga sfera e komunikacionit ose shkencave juridike,
- posedon një nga certifikatat ndërkombëtarisht të pranuar si në vijim ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
- TOEFEL IBT më së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
- BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë dhe
- ka dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

### **Neni 87-v**

Inspektor mund të jetë personi, i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- është person i rritur,
- ka gjendje shëndetësore të përgjithshme,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose obligimeve,
- ka të paktën 240 kredi sipas EKTS ose ka kryer shkallën VII/1 nga sfera teknike ose shkencave juridike, që vërtetohet me vërtetim,
- ka pesë vjet përvojë pune në komunikacion dhe shkencat juridike,



- i plotëson kushtet e përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës,
- posedon certifikatë ndërkombëtarisht të njohur për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë, si vijojnë:
  - 1) Certiport: IC3 GS4 Key Applications- të dhënë;
  - 2) Microsoft: MOS Word ose MOS Excell- të dhënë ose
  - 3) ECDL: Core- të dhënë,
- ka marrë mendim pozitiv si i përshtatshëm për vendin e punës përmes dhënies së testit psikologjik dhe testit të integritetit, në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërorë dhe
- ka licencë për inspektor në fushën e kompetencës së shërbimit inspektues.

## **Neni 87-g**

Drejtori përpilon propozim-program vjetor për punën e inspektorit dhe të njëjtin e dorëzon te Këshilli inspektues, më së voni deri më 31 tetor të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm.

Drejtori, e miraton programin vjetor për punën e inspektorit në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të pajtimit nga Këshilli inspektues, respektivisht më së voni deri më 10 dhjetor gjatë vitit rrjedhës nëse Këshilli inspektues nuk e shqyrton dhe nuk jep pëlqim, respektivisht vërejtje në afatin e përcaktuar me ligj.

Në bazë të programit vjetor të miratuar, drejtori përpilon plane tremujore për punën e secilit inspektor, të cilat së bashku i paraqet për shqyrtim te Këshilli inspektues më së voni dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik e atë deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë të vitit të ardhshëm, deri më 15 mars për të dytin, deri më 15 qershor për të tretin, respektivisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt gjatë vitit rrjedhës.

Në planet tremujore për punën e secilit inspektor, drejtori në mënyrë të detyrueshme e vendos numrin e inspektimeve të planifikuara gjatë tre muajve të ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlikueshmërisë të secilës prej mbikëqyrjeve.

Në bazë të planeve tremujore, për secilin inspektor drejtori përpilon plan mujor për punë, i cili plan i përmban edhe orarin e inspektimeve me datë dhe subjektet e inspektimit.

Drejtori më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit kalendarik për të kaluarin, te Këshilli inspektues në përmbledhje paraqet raporte tremujore për punën e secilit inspektor, edhe atë deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit të kaluar, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për të dytin, respektivisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

Drejtori, më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës, te Këshilli inspektues paraqet raport vjetor për punën e inspektoratit për vitin paraprak.

## **Neni 88**

Inspektorët shtetërorë për komunikacion rrugor bëjnë mbikëqyrjen e:

- transportit të udhëtarëve në komunikacionin ndërkomunal,
- përmbushja e kushteve për marrjen e licencës për transport ndërkomunal dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave,
- zbatimin e marrëveshjes nga neni 23 të këtij ligji.
- përmbushja e kushteve të veçanta teknike eksploatuese të automjeteve

- për kryerjen e llojeve të caktuara të transportit,
- transportit të mallrave në transportin e brendshëm rrugor,
  - zbatimi i aktiviteteve nga neni 70-a i këtij ligji,
  - transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor ndërkombëtar,
  - transportit të veçantë në linjë të udhëtarëve që bëhet midis dy e më shumë komunave dhe që kryhet vetëm në komuna, dhe
  - transporti i përcaktuar në nenin 52 paragrafi 3 të këtij ligji
  - stacioneve të autobusëve dhe ndalesave.

Nëse inspektorët shtetërorë për komunikacion rrugor gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese vërteton ekzistimin e çfarëdo qoftë shkaku të shënuar në nenin 12 të këtij ligji, ose se transportuesi nuk i mban të gjitha linjat për të cilat ka marrë leje ose vërteton se janë bërë ndryshime në pikëpamje të plotësisht të kushteve në bazë të së cilave i është lejuar linja e caktuar, për të cilën është dhënë leje (zvogëlim i numrit të automjeteve, të vozitësve dhe të ngjashme), do t'i paraqesë propozim ministrit të Transportit dhe Lidhjeve që të miratojë aktvendim për tërheqjen e licencës, përkatësisht për tërheqjen e përhershme të lejes dhe shlyerjen e orarit të vozitjes nga regjistri i orareve të vozitjes.

### 23

Nëse inspektorët shtetërorë për transport rrugor gjatë kryerjes së mbikëqyrjes për kryerje të transportit në linje të veçantë, konstaton se transportuesi transporton udhëtarë në kundërshtim me nenin 43 paragrafi 5 të këtij ligji, do të paraqesë propozim të ministri i Transportit dhe Lidhjeve për të marrë aktvendim për heqjen e licencës dhe heqjen e lejes për transport në linjë të veçantë. Transportuesit që në këtë bazë i hiqet licenca për transport në linjë të veçantë nuk ka të drejtë që të kërkojë përsëri t'i lëshohet ky lloj licencë.

Inspektori i autorizuar i komunës ose inspektorët e autorizuar të Qytetit të Shkupit për komunikacion rrugor bëjnë mbikëqyrjen e:

- përmbushja e kushteve të veçanta teknike eksploatuese të automjeteve me të cilat kryhet transporti komunal i udhëtarëve dhe transporti i auto - taksive,
- transportit komunal të udhëtarëve në linjë,
- përmbushja e kushteve për marrjen e licencës për transportin komunal dhe për transport të udhëtarëve me auto - taksii,
- transportit të udhëtarëve auto - taksii,
- transportit të veçantë të udhëtarëve në linjë që bëhet në territorin e komunës ose në territorin e Qytetit të Shkupit,
- taksii stacioneve,
- parkinglokalëve për automjete ngarkuese dhe autobusëve. 24

Nëse inspektori komunal i autorizuar ose inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit për komunikacion rrugor, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese vërteton ekzistimin e çfarëdo qoftë shkaku të shënuar në nenin 12 të këtij ligji ose veprim në kundërshtim me rregullin unik të përcaktuar të linjave, itinerarin e përcaktuar të udhëtimit, sistemin e përcaktuar tarifor, sistemin e arkëtimit dhe mënyrën dhe kontrollin e arkëtimit, lokacionin e përcaktuar të terminaleve të autobusëve, kthesave, vendqëndrimeve, ose se transportuesi nuk i mban të gjitha linjat për të cilat ka marrë leje ose vërteton se janë bërë ndryshime në pikëpamje të plotësisht të kushteve në bazë të së cilave është lejuar ndonjë linjë e caktuar për të cilën është dhënë leje (zvogëlim i numrit të automjeteve, vozitësve dhe të ngjashme), do t'i paraqesë kryetarit të komunës, përkatësisht kryetarit të Qytetit të Shkupit propozim që të miratojë aktvendim për tërheqjen e licencës, përkatësisht për tërheqjen e

përhershme të lejes dhe shlyerjen e orarit të vozitjes nga regjistri i orareve të vozitjes. <sup>25</sup>

Nëse inspektori i autorizuar komunal ose inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese përcakton se kryerësi i transportit auto taksi qëndron jashtë nga vendqëndrimi auto taksi, e për të cilin paraprakisht i janë lëshuar dy aktvendime për kundërvajtje të bërë në bazë të nenit 99-a paragrafi 1 pika 9 të këtij ligji, do të parashtrojë propozim te kryetari i komunës përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit të miratojë aktvendim për heqje të përhershme të certifikata për ngasës auto taksie që e ka kryer kundërvajtjen.. <sup>26</sup>

Nëse inspektori i autorizuar komunal ose inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese konstaton se kryerësi i veprimtarisë së transportit auto taksi kryen veprimtari auto taksi ngasësi pa poseduar certifikatë për ngasës auto taksi, do të parashtrojë propozim te kryetari i komunës përkatësisht kryetari i qytetit të Shkupit të miratojë aktvendim për heqje të përhershme të ekstraktit të licencës për kryerje të veprimtarisë së transportit auto taksi të automjetit me të cilin është kryer kundërvajtja.

Në qoftë se komuna respektivisht Qyteti i Shkupit nuk janë në mundësi ta bëjnë mbikëqyrjen inspektuese, me kërkesë të tyre, mbikëqyrjen mund ta bëjnë inspektorët shtetërorë për komunikacion rrugor. Shpenzimet për bërjen e mbikëqyrjes janë në barrë të komunës respektivisht të Qytetit të Shkupit.

Kontrolloret nga neni 17-a paragrafi 2 të këtij ligji kontrollojnë nëse udhëtarët posedojnë bileta për transport publik në qytetin e Shkupit.

Inspektori për komunikacion rrugor dhe kontrollorët kanë autorizim ta ndalojnë udhëtarin pa biletë në automjetin dhe të bëjnë përcaktimin e identitetit të tij.

Nëse kontrolloret konstatojnë se udhëtari nuk ka biletë për transport publik, do të paraqesin propozim për ngritje të procedurës kundërvajtëse te organi kompetent i inspeksionit.

## Neni 89

Inspektori shtetëror për komunikacion rrugor ka të drejtë të marrë vendim për:

- përjashtim i automjetit nga komunikacioni, me marrjen e lejes së qarkullimit, në qoftë se bëhet transporti para regjistrimit të veprimtarisë në Regjistrin qendror ose në qoftë se transportuesi nuk ka licencë për kryerjen e llojit përkatës të transportit të paraparë me këtë ligj,
- heqjen e automjetit nga komunikacioni, me marrjen dhe lejen e trafikut, nëse transportuesi bën transportin e udhëtarëve në linjë pa leje adekuate ose pa orar për vozitje të regjistruar;
- përjashtim i automjetit nga komunikacioni, me marrjen e lejes së qarkullimit, në qoftë se bën transport udhëtarësh me auto - taksi jashtë rajonit të komunës, nëse transporti bëhet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji,
- marrjen e përkohshme të lejes transportuesit të vendit nëse nuk u përmbahet dispozitave dhe orarit për vozitje të regjistruar gjatë kryerjes së transportit ndërkomunal të udhëtarëve,, <sup>27</sup>
- marrjen e përkohshme të lejes së transportuesit të vendit ose të huaj për kryerjen e transportit ndërkombëtar në linjë të udhëtarëve, nëse nuk u përmbahet dispozitave dhe orarit për vozitje të regjistruar, itinerarit dhe plani i vozitjes i shoferëve,

- heqja e licencës për transport auto-taksi nëse transportuesi vepron në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 3 të këtij ligji
- përjashtim i automjetit nga komunikacioni, me marrjen e lejes për qarkullim, në qoftë se transportuesi bën transport të udhëtarëve në linjë të veçantë ndërmjet dy ose më shumë komunave pa leje,
- marrjen e lejes transportuesit, për transport të veçantë në linjë të udhëtarëve që bëhet midis dy komunave nëse udhëtarët që transportohen nuk disponojnë me dëshmi për identifikim nga kërkuesi i transportit,
- ndalimin e lëvizjes së mëtejme të automjetit të huaj në territorin e Republikës së Maqedonisë me udhëzimin e automjetit deri te një nga kalimet kufitare, për shkak të lëshimit të vendit, nëse në automjet nuk gjendet dokumentacioni i caktuar për transportin e llojit adekuat të përcaktuar me këtë ligj dhe marrëveshjen ndërkombëtare,
- marrjen e lejes transportuesit të vendit dhe të huaj për kryerjen e transportit ndërkombëtar të mallit nëse transportuesi nuk u përmbahet kushteve të të njëjtës dhe kushteve të përcaktuara nga Sekretariati i Konferencës Evropiane të Ministrave të Transportit nëse transporti bëhet me EKMT leje 28 si dhe të japë propozim te ministri i Transportit dhe Lidhjeve për heqjen e kategorizimit të stacionit të autobusëve ose për kategorizim një kategori më poshtë nga kategorizimi ekzistues,
- evitimin e mangësive në afat të caktuar në drejtim të realizimit të kushteve të përcaktuara për kryerjen e transportit në komunikacionit rrugor, kushteve për punë të stacioneve të autobusëve dhe përmbajtjes së orarit për vozitje,
- ndalimin e përkohshëm për përdorimin e stacioneve të autobusit dhe ndalesës të autobusit nëse në afat të përkohshëm nuk mënjanohen mangësitë që i ka përcaktuar inspektori për komunikacion rrugor.

Me tërheqje të lejes për transport të linjave të udhëtarëve, nënkuptohet tërheqja e të gjithë ekzemplarëve të lejeve me të cilat disponon transportuesi për mbajtjen e linjës konkrete për të cilën është kryer kundërvajtja.

Transportuesi është i obliguar që në afat prej 24 orësh nga marrja e aktvendimit për heqjen e lejes, të gjithë ekzemplarët e lejeve për linjën lëndore t'i dorëzojë te Inspektorati Shtetëror i Transportit.

Tërheqja përkohësisht e lejes nga paragrafi 1 alinetë 4 dhe 5 të këtij neni zgjat 30 ditë, por nëse në afat prej një viti transportuesi e përsërit shkeljen, inspektori do t'i paraqesë propozim për tërheqje përgjithmonë të lejes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Për lejen përkohësisht të tërhequr nga paragrafi 1 alineja 5 të këtij neni dhe për ndalimin e mëtejshëm të transportit të automjetit të huaj në territorin e Republikës së Maqedonisë nga paragrafi 1 alineja 8 të këtij neni, informohet Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë në pikën kufitare.

Leja e tërhequr e komunikacionit nga paragrafi 1 alinetë 1, 2, 3 dhe 6 të këtij neni i dorëzohet Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për lejen e tërhequr të komunikacionit, transportuesit i jepet vërtetim.

Mënjanimi i automjetit nga komunikacioni me tërheqjen e lejes së komunikacionit nga paragrafi 1 alinetë 1, 2, 3 dhe 6 të këtij neni zgjat 30 ditë.

Ndalesa e përkohshme nga paragrafi 1 alineja 11 e këtij neni, mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej 10 deri në 30 ditë.

## Neni 90

Inspektori i autorizuar për transport rrugor të komunës ose inspektori i autorizuar për komunikacion rrugor për Qytetin e Shkupit ka të drejtë të marrë vendim për:

- përjashtim i automjetit nga komunikacioni me marrjen e lejes së qarkullimit, në qoftë se bëhet transport udhëtarësh në linjë komunale dhe transport udhëtarësh me auto - taksi para regjistrimit të veprimtarisë në Regjistrin qendror ose në qoftë se transportuesi i cili është regjistruar në Regjistrin qendror nuk ka licencë për lloj të tillë transporti,
- heqjen e automjetit nga komunikacioni me marrjen e lejes së trafikut nëse transportuesi bën transport komunal të udhëtarëve pa licencë, leje dhe pa orar për vozitje të regjistruar,
- heqjen e auto - taksi automjetit nga komunikacioni me marrjen e lejes e trafikut nëse transporti bëhet pa licencë adekuate, nëse nuk ka të instaluar taksimetër në rregull, të plombuar dhe të paguar ose nëse i njëjti nuk është aktivizuar,
- përjashtim i automjetit nga komunikacioni, me marrjen e lejes së qarkullimit, në qoftë se transportuesi bën transport të udhëtarëve në linjë të veçantë në rajonin e komunës respektivisht të Qyteti të Shkupit, pa leje për atë lloj transporti,
- marrjen e lejes transportuesit për transport të veçantë të udhëtarëve në linjë që bëhet në rajonin e komunës, nëse udhëtarët që transportohen nuk kanë dëshmi për identifikim nga porositësi i transportit,
- mënjanimin e mangësive në afat të caktuar në drejtim të realizimit të kushteve të përcaktuara për kryerjen e transportit komunal të udhëtarëve në linjë dhe respektimin e orarit për vozitje dhe transportin e udhëtarëve auto - taksi,
- ndalimin e përkohshëm për përdorimin e terminaleve vendqëndrim të autobusit dhe vendkthimit dhe taksi stacioneve nëse në afatin e caktuar nuk mënjanohe mangësitë që i ka përcaktuar inspektori dhe heqje të ekstraktit të licencës për transport autotaksi personit juridik i cili angazhon shofer të automjetit autotaksi i cili nuk ka certifikatë për shofer autotaksi.

Marrja e lejes së trafikut nga alineja 1, 2, 3 dhe 4 nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Për marrjen e lejes së trafikut transportuesit i jepet vërtetim.

Heqja e automjetit nga komunikacioni me marrjen e lejes së trafikut zgjat 30 (tridhjetë) ditë.

Ndalesa e përkohshme nga paragrafi 1 alineja 7 e këtij neni mund të jetë në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve deri 30 (tridhjetë ditë). 29

## Neni 90-a

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektorët nga neni 87 i këtij ligji konstatojnë se është bërë parregullsi nga neni 96 paragrafi 1 pika 2-a, neni 97 paragrafi 1 pikat 1, 3, 4, 11, 11-a, 13, 14, 15-a dhe 16, nga neni 98 paragrafi 1 pikat 2-a, 3, 7 dhe 15 dhe neni 99-a paragrafi 1 pika 10 të këtij ligji, janë të obliguar që të përpilojnë procesverbal në të cilin do të përcaktohet parregullsia e kryer me sugjerim për mënjanim të parregullsisë së kryer në afat të caktuar dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizim edukimi të personit ose subjektit ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri për Transport dhe Lidhje.

Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror për Transport, përkatësisht inspektorët e autorizuar për komunikacion rrugor të komunave përkatësisht të qytetit të Shkupit, në afat jo më të gjatë se tetë ditë prej ditës së realizimit të mbikëqyrjes inspektuese.

Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të ngjashme, për një apo më shumë subjekte.

Në rast se në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të llogaritet se edukimi është realizuar.

Në rast se personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtin e mbaron, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e konstatuar.

Nëse inspektorët nga neni 87 i këtij ligji gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese vërtetojnë se janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi 1 i këtij neni, miratojnë konkluzion me të cilin ndërpritet procedura e mbikëqyrjes inspektuese.

Nëse inspektorët nga neni 87 të këtij ligji gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstatojnë se nuk janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi 1 i këtij neni, parashtrojnë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente përkatësisht Komisionit për Kundërvajtje në Ministrinë për Transport dhe Lidhje.

Inspektorati Shtetëror për Transport dhe Lidhje, përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës përkatësisht inspektori i autorizuar i qytetit të Shkupit për komunikacion rrugor, mbajnë evidencë për edukimin e realizuar në mënyrë të përcaktuar nga ministri për Transport dhe Lidhje.

## **Neni 90-b**

Ministria për Transport dhe Lidhje për mbikëqyrjen e realizuar inspektuese nga ana e Inspektoratit Shtetëror për Transport është e obliguar që në faqen e vet në internet të publikojë raport tremujor.

Komunat përkatësisht qyteti i Shkupit për mbikëqyrjen e realizuar inspektuese nga ana e inspektorit të autorizuar të komunës, përkatësisht inspektorit të autorizuar të qytetit të Shkupit për komunikacion rrugor, janë të obliguar që në faqen e vet të internetit të publikojnë raport tremujor.

## **Neni 91**

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektori shtetëror, inspektori i autorizuar i komunës ose Qytetit të Shkupit për komunikacion rrugor arrin në njohuri se ekziston bazë e dyshimit se është kryer kundërvajtje me të cilën është bërë cenimi i këtij ligji ose dispozitë tjetër, janë të detyruar pa shtyrje të paraqesin kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente përkatësisht para Komisionit për Kundërvajtje në Ministrinë për Transport dhe Lidhje.

## **Neni 92**

Kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror për komunikacion rrugor mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit të Komisioni shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrës inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse.

Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të komunës ose të inspektorit të autorizuar të qytetit të Shkupit, mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Komisioni shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrës inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse.

Pas botimit të aktit nënligjor nga paragrafi 4 i këtij neni në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve. 30

Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Neni 93**

Transportuesit, poseduesi i automjeteve, personi juridik i cili administron me stacionin e autobusëve dhe shfrytëzuesit e transportit janë të detyruar që inspektorëve nga neni 87 nga ky ligj t'u mundësojë kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, t'ua japin informatat e duhura dhe t'ua japin në shikim dokumentacionin e duhur.

### **Neni 94**

*I fshirë* 31

### **Neni 95**

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve bën mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës dhe organeve të Qytetit të Shkupit.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi 1 nga ky nen Ministria e Transportit dhe Lidhjeve i bën punët vijuese:

- vlerëson se organet e komunës a kanë organizuar transport në rajonin e komunës, në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë ligj,
- paralajmëron për mangësitë e caktuara materiale dhe procedurale në punën e organeve të komunës, të cilët do ta pamundësojnë kryerjen e transportit në komunikacionin rrugor,
- ju jep rekomandime organeve komunale me kërkesë të tyre për zbatimin e përpiktë të punëve të cilat duhet t'i kryejnë në pajtim me këtë ligj;
- jep mendim dhe ndihmë profesionale sipas propozim dispozitave nga lëmi i komunikacionit rrugor me kërkesë të komunës, dhe
- në kohë i informon organet e komunës për gjendjet e konstatuara në punën e tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

Nëse Ministria e Transportit dhe Lidhjeve gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi 1 i këtij neni konstaton se komuna, përkatësisht Qyteti i Shkupit nuk kanë inspektorë të emëruar komunalë, përkatësisht inspektorë të Qytetit të Shkupit, ose numri i tyre është i pamjaftueshëm, mbikëqyrjen inspektuese me autorizimin e ministrit të Transportit dhe Lidhjeve mund ta kryejnë inspektorët shtetërorë për komunikacion rrugor.

### **Neni 95-a**

*I fshirë* 32

## **XI DISPOZITAT NDËSHKUESE DHE KUNDËRVAJTËSE**

## Neni 96

Gjobë në lartësi prej 5000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- 1) bën transport të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar pa licencë ekstrakt nga licenca (neni 4 paragrafi 1, neni 4-a paragrafi 1 dhe neni 70 paragrafi 10),
  - 1-a) kryen transportit auto taksi me ngasës që nuk posedon certifikatë për ngasës auto taksi (neni 3 paragrafi 1 pika 21-b).
- 2) bën transportin e udhëtarëve në linjë në komunikacionin rrugor komunal, ndërkomunal dhe ndërkombëtar pa leje (neni 19 paragrafi 1, neni 25 paragrafi 1, neni 36 paragrafi 2 dhe neni 44 paragrafi 1),
  - 2-a) Në kohën e kryerjes së transportit të udhëtarëve në linjë ndërkomunale nuk ka ekstrakt nga licenca, leje, orar të regjistruar të udhëtimit dhe fletudhëtim në origjinal (neni 26 paragrafi 5);
- 3) bën kabotazhë në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve në linjë (neni 39),
- 4) bën transportin e udhëtarëve transit përmes territorit të Republikës së Maqedonisë pa leje përkatësisht në kundërshtim me lejen e dhënë (neni 40),
  - 4-a) kryen transport të lirë të udhëtarëve që ka elemente të transportit në linjë dhe linjë të veçantë (neni 25 paragrafi 4);
- 5) bën transport periodik të udhëtarëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar pa leje nëse me marrëveshje ndërkombëtare është paraparë ai transport të bëhet me leje (neni 50 paragrafi 1),
  - 5-a) kryen rezervim dhe shitje të biletave në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 2 të këtij ligji;
  - 5-b) kryen transport auto-taksi në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 3 të këtij ligji
- 6) transportuesi i huaj kryen transport ndërkombëtar të mallit pa leje (neni 70 paragrafët 1 dhe 3 dhe neni 79). 33
- 7) transportuesi i huaj bën transportin e mallrave në transportin rrugor të brendshëm pa leje (neni 74 paragrafi 1).
- 8) kryen organizim të transportit të mallrave dhe pa licencë për organizim të transportit (nenet 4 dhe 7 paragrafi 1 pika 3);
- 9) gjatë kryerjes së transportit ndërkombëtar lejen për transport të mallrave dhe udhëtarëve ia jep apo lëshon transportuesit tjetër ose nëse me leje të transportuesit tjetër kryen transport në komunikacionin rrugor;
- 10) transportuesi i huaj kryen shlyerje apo përmirësim të të dhënave të regjistruara në leje për transport ndërkombëtar;
- 11) në automjetin e transportuesit të huaj të marrë me qira nuk gjendet marrëveshja për qira origjinale ose e vërtetuar te noteri në gjuhën zyrtare të vendit të selisë së transportuesit dhe e përkthyer në gjuhën angleze;
- 12) në automjetin e transportuesit të huaj nuk ka vërtetim ose marrëveshje për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës të nënshkruar ndërmjet vozitësit dhe transportuesit që kryen transport të udhëtarëve ose mallit në gjuhën zyrtare të vendit të selisë së transportuesit dhe e përkthyer në gjuhën angleze dhe
- 13) nëse në automjetin e transportuesit të huaj dhe vendor ka leje transporti të veçanta dhe/ose leje EKMT si dhe ditar udhëtimit të falsifikuara. 34

Për kundërvajtje nga paragrafi 1, pikat 1 dhe 2 të këtij neni, krahas gjobës, kryerësit do t'i kumtohet edhe masë e veçantë kundërvajtëse, sekuestrim i automjetit me të cilin bëhet transporti.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 pika 1 nga ky nen përveç gjobës personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksioni kundërvajtës i marrjes së të mirës materiale të fituar me kundërvajtje.



Për të njëjtën kundërvajtje nga paragrafi 1 të këtij neni të bërë për herë të dytë, personit juridik i cili bën veprimtari në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përveç gjobës, do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës, ndalim i përkohshëm i kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej 6 muajve deri në 1 vit.

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni gjobë në lartësi prej 30% të dënimit të matur për personin juridik do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik dhe do t'i shqiptohet sanksioni i kundërvajtjes ndalim për ushtrim të detyrës deri më së shumti 30 ditë.

Për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin 1 pikat 2-a dhe 4-a të këtij neni ndalimi nga paragrafi 5 të këtij neni mund të zëvendësohet me kompensim me para nëse kundërvajtja është kryer për herë të parë.

Kompensimi me para nga paragrafi 6 i këtij neni paraqet shumë të dyfishtë nga shuma e gjobës së matur për kundërvajtje.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12 dhe 13. të këtij neni transportuesit të huaj i jepet urdhërpagesë e mandatit në shumë prej 1.500 në kundërvlerë me denarë, përkohësisht i merret leja e komunikacionit dhe i kumtohet masë plotësuese ndalim për qarkullimin e automjetit në territorin e Republikës së Maqedonisë deri në pagesën e gjobës së kumtuar. Inspektori i komunikacionit rrugor detyrimisht i njofton shërbimet kompetente kufitare për masën plotësuese të kumtuar ndalim për qarkullimin e automjetit në fjalë në territorin e Republikës së Maqedonisë. 35

## Neni 97

Gjobë në lartësi prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- 1) bën transport në komunikacionin rrugor me automjete që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me dispozitat për siguri të komunikacion rrugor dhe kushtet e përcaktuara të veçanta eksploatuese teknike (neni 5 paragrafi 1 dhe neni 70 paragrafi 8),
- 2) fillon të bëjë transport të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar para se të fitojë licencë dhe ekstrakt të licencës (neni 11 paragrafi 1, neni 70 paragrafi 10 dhe neni 79 paragrafët 1 dhe 3),
- 3) gjatë kryerjes së transportit të udhëtarëve në linjë komunale, në automjet nuk ka ekstrakt nga licenca dhe leje (neni 20, paragrafi 1);
- 4) transportuesi nuk i përmbahet orarit për vozitje dhe rregullisht nuk e mban linjën (neni 20 paragrafi 2 dhe neni 23),
- 5) transportin nuk e kryen në pajtim me lejen e dhënë dhe orarin vozitës të vërtetuar (neni 26 paragrafi 4),
- 6) e ndryshon orarin e vozitjes dhe drejtimin e lëvizjes (itinerarin) para skadimit të afatit të lejes (neni 28 paragrafi 1),
- 7) pa shkaqe të arsyeshme dhe pa leje të organit kompetent e ndërpret transportin e linjës së caktuar (neni 32 paragrafi 1),
- 8) biletat për vozitje nuk i jep në pajtim me nenin 33 nga ky ligj,
- 9) bën transportin e veçantë në linjë nga neni 43 i këtij ligji pa leje të dhënë nga organi kompetent (neni 44),
- 10) bën transportin e udhëtarëve në linjë në transportin rrugor ndërkombëtar në kundërshtim me orarin e vozitjes, itinerarin dhe listës së çmimit (neni 38 paragrafi 1),
- 11) në automjet me të cilin bëhet transporti nuk gjendet origjinali ose kopja e vërtetuar e lejes, orarit të vozitjes, itinerarit dhe listës së çmimit (neni 38 paragrafi 2),
- 11-a) gjatë kryerjes së transportit të veçantë në linjë të udhëtarëve në

automjetin nuk posedon ekstrakt nga licenca, leje, urdhër për udhëtim në origjinal dhe marrëveshje me listë të udhëtarëve në pajtim me nenin 43 paragrafët 7 dhe 8 të këtij ligji;

12) gjatë kryerjes të vozitjes së lirë të udhëtarëve në komunikacionin rrugor të brendshëm në autobus nuk gjendet marrëveshja e lidhur midis transportuesit dhe shfrytëzuesit të shërbimit dhe lista e udhëtarëve që transportohen e vërtetuar nga transportuesi (neni 49 paragrafi 1),

13) gjatë kryerjes së transportit të lirë ndërkombëtar të udhëtarëve në automjet nuk gjendet lista e udhëtimit dhe marrëveshja e lidhur midis transportuesit dhe porositësit të shërbimit (neni 49 paragrafi 2),

14) në automjet nuk ka leje nëse është i paraparë transporti të bëhet me leje,

15) nuk u jep shërbime me kushte të barabarta të gjithë transportuesve të cilët bëjnë transportin e udhëtarëve në linjë (neni 57 paragrafi 1 dhe neni 79 paragrafi 1),

15-a) në automjet nuk ka ekstrakt nga licenca (neni 64 paragrafi 3);

16) automjeti nuk ka fletudhëtim dhe/ose fletëngarkesë (neni 64 paragrafi 4 dhe neni 79 paragrafi 1);

17) në automjet nuk ka fletëngarkim CMR për mallin i cili transportohet dhe/ose leje ndërkombëtare të transportit nëse ajo kërkohet (neni 66 paragrafi 2, neni 70 paragrafët 7 dhe 11). <sup>36</sup>

18) nuk i dorëzon të gjitha ekzemplarët nga lejet për linjën lëndore në Inspektoratin Shtetëror të Transportit, në afatin e përcaktuar (neni 89 paragrafi 3).

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni gjobë në lartësi prej 30% të dënimit të matur për personin juridik do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 4, 5, 6, 7, 10, 11, 12, 13, 14, 15-a, 16 dhe 17 të këtij neni transportuesit të huaj i jepet urdhërpagesë e mandatit në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë, përkohësisht i merret leja e komunikacionit dhe i kumtohet masë plotësuese ndalim për qarkullimin e automjetit në territorin e Republikës së Maqedonisë deri në pagesën e gjobës së kumtuar. Inspektori i komunikacionit rrugor detyrimisht i njofton shërbimet kompetente kufitare për masën plotësuese të kumtuar ndalim për qarkullimin e automjetit në fjalë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

## Neni 98

Gjobë në shumë prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

1) e fshirë <sup>37</sup>

2) nuk mban evidencë për urdhëresat e dhëna të udhëtimit dhe të njëjtat nuk i ruan më së paku 1 vit (neni 6 paragrafi 5);

2-a) bën hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve në transportin e udhëtarëve në linjë komunale në vendndalimet e autobusëve në kundërshtim me itinerarin e regjistruar (neni 21, paragrafi 1);

3) gjatë kryerjes së transportit në automjet nuk gjendet leja dhe orari vozitës i vërtetuar (neni 26 paragrafi 5);

4) nuk e paraqet ndërprerjen e përkohshëm të transportit në organin që e ka dhënë lejen (neni 29 paragrafi 2);

5) te organi kompetent që e ka dhënë lejen nuk paraqet kërkesë për ndërprerjen e përkohshme ose ndërprerjen e përhershme të transportit (neni 30 paragrafi 1);

6) ndërprerjen e përkohshme ose ndërprerjen e përhershme të transportit dhe ndryshimin e orarit për vozitje në linjë të caktuar nuk e shpall në mjetet e informimit publik dhe në stacionin e autobusit (neni 31);

- 7) bën hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve, përkatësisht ngarkimin dhe shkarkimin e bagazhit, në stacionet e autobusit dhe ndalesë që nuk kanë hyrë në leje dhe orarin vozitës për linjën (neni 34);
- 8) nuk ndalet në stacionin e autobusit përkatësisht vendprirje të përmendura në leje dhe orarin vozitës për linjën (neni 35);
- 8-a) nuk e verifikon fletudhëtimin në çdo stacion autobusi të lejuar në itinerarin dhe në lejen (neni 35);
- 9) bën transportin e udhëtarëve auto - taksi pa licencë (neni 52);
- 10) gjatë kryerjes së transportit auto - taksi në automjet nuk ka instaluar taksimetër të rregullt, të plombuar dhe të paguar (neni 55 paragrafi 1);
- 11) gjatë kryerjes së transportit nuk e ka aktivizuar taksimetrin dhe çmimin e transportit nuk e paguan në bazë të shumës së caktuar në taksimetër (neni 54 paragrafi 2);
- 12) në kulmin e veturës me të cilën bëhet auto - taksi transporti nuk e ka vendosur emrin "TAKSI" (neni 54 paragrafi 3);
- 13) stacioni i autobusit nuk e ka harmonizuar orarin e punës në pajtim me nenin 59 nga ky ligj;
- 14) stacioni i autobusit nuk mban ditar për arritjen dhe nisjen e autobusit dhe në urdhëresën e udhëtimit nuk e vërteton kohën e arritjes dhe nisjes të autobusëve (neni 60 paragrafi 1 dhe 3);
- 15) stacioni i autobusit nuk e informon Inspektorati Shtetëror për Transport për moskryerjen e transportit në linjë të caktuar (neni 60 paragrafi 2);
- 15-a) personit juridik kryerës të qarkullimi ndërkombëtar të mallit i cili nuk ka mbajtur kopje të lejes ndërkombëtare nga transportuesi i huaj (neni 70-a paragrafët 1 dhe 2)
- 16) nëse transportuesi i automjetit që i tejkalon kushtet e përcaktuara në drejtim të dimensioneve, masës së përgjithshme, bosht ngarkesës nuk ka leje për transport të jashtëzakonshëm (neni 75);
- 17) bën transportin për nevoja personale në kundërshtim me kushtet nga neni 77 të këtij ligji;
- 17-a) transportin për nevoja personale nuk e kryen në pajtim me nenin 78 të këtij ligji;
- 18) gjatë kryerjes së transportit ndërkombëtar të mallrave për nevoja personale në automjet nuk ka listë ngarkuese (neni 79);
- 18-a) nuk i kthen në afatin e përcaktuar të gjitha ekzemplarët e lejes e cila i është hequr (neni 89, paragrafi 2);
- 19) nuk vepron në bazë të vendimit të inspektorit (neni 89 dhe 90);
- 20) inspektorit për komunikacion rrugor nuk i mundëson kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, nuk i jep informata të nevojshme dhe nuk ia vë në shikim dokumentacionin e duhur (neni 93).

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni gjobë në lartësi prej 30% të dënimit të matur për personin juridik do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 3, 4, 7, 8, 8-a, 15, 16 dhe 20 të këtij neni transportuesit të huaj aty për i jepet urdhërpagesë e mandatit në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë, përkohësisht i merret leja e komunikacionit dhe i kumtohet masë plotësuese ndalim për qarkullimin e automjetit në territorin e Republikës së Maqedonisë deri në pagesën e gjobës së kumtuar. Inspektori i komunikacionit rrugor detyrimisht i njofton shërbimet kompetente kufitare për masën plotësuese të kumtuar ndalim për qarkullimin e automjetit në fjalë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

## Neni 99

Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik - tregtar individ nëse:

1) bën transport publik pa licencë dhe ekstrakt licenca (neni 4 paragrafi1);  
1-a) kryen transportit auto taksi me ngasës që nuk posedon certifikatë për ngasës auto taksi (neni 3 paragrafi 1 pika 21-b).

2) bën transport në komunikacionin rrugor me automjete që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me dispozitat për siguri në komunikacionin rrugor dhe kushtet e përcaktuara të veçanta eksploatuese teknike (neni 5 paragrafi 1);

2-a) transportuesi nuk ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafi 5 të këtij ligji;

3) bën transportin komunal në linjë të udhëtarëve pa licencë (neni 18);

4) në automjet me të cilin bëhet transporti komunal i udhëtarëve nuk ka licencë, certifikatë e licencës, leje urdhëruardhëtimi në origjinal dhe orar udhëtimi të regjistruar në origjinal ose kopje të vërtetuar (neni 20 paragrafi 1);

5) bën hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve në transportin komunal në linjë në vend pritje të autobusit në kundërshtim me orarin vozitës të regjistruar (neni 21 paragrafi 1);

6) bën transportin ndërkomunal të udhëtarëve pa leje (neni 25 paragrafi 1);

7) bën transportin ndërkomunal të udhëtarëve në linjë në kundërshtim me lejen e dhënë dhe orarin vozitës të vërtetuar (neni 26 paragrafi 4);

8) gjatë kohës së kryerjes së transportit në automjet nuk ka leje dhe orar udhëtimi (neni 26 paragrafi 5);

9) nuk e paraqet ndërprerjen e përkohshme të transportit në organin që e ka dhënë lejen (neni 29 paragrafi 2);

10) te organi kompetent që e ka dhënë lejen nuk e paraqet kërkesën për ndërprerjen e përkohshme ose ndërprerjen e përhershme të transportit (neni 30 paragrafi 1);

11) ndërprerjen e përkohshme ose ndërprerjen e përhershme të transportit dhe ndryshimin e orarit për udhëtim në linjë të caktuar nuk e shpall në mjetet e informimit publik dhe në stacionin e autobusit (neni 31);

12) bën hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve, përkatësisht ngarkimin dhe shkarkimin e bagazhit, në stacionet e autobusit dhe ndalesë që nuk kanë hyrë në lejen dhe orarin e udhëtimit për linjën (neni 34);

13) nuk ndalet në stacionin e autobusit përkatësisht vend pritjet e përmendur në leje dhe në orarin udhëtimit për linjën (neni 35),

14) bën transportin e veçantë në linjë (neni 44);

15) e fshirë 38

16) bën transportin e udhëtarëve auto - taksi pa licencë (neni 52);

17) në automjet me të cilin bëhet transporti auto - taksi, nuk ka instaluar në vend të dukur, taksimetër në rregull, të plombuar dhe të paguar (neni 55 paragrafi 1);

18) gjatë kryerjes së transportit nuk e ka aktivizuar taksimetrin dhe çmimin e transportit nuk e paguan në bazë të shumës së caktuar në taksimetër (neni 55 paragrafi 2);

19) në kulmin e veturës dhe anash me të cilën bëhet transporti auto - taksi nuk e ka vendosur emrin "TAKSI" (neni 55 paragrafi 3),

19-a) në automjetin me të cilin kryhet transporti i lirë i udhëtarëve në komunikacionin rrugor të brendshëm, nuk ka ekstrakt nga licenca, fletudhëtimi në origjinal, marrëveshje të lidhur ndërmjet transportuesit dhe porositesit të shërbimit dhe listë të udhëtarëve të nënshkruar dhe të vërtetuar nga transportuesi (neni 49 paragrafi1);

19-b) kryen transport të lirë të udhëtarëve në komunikacionin ndërkombëtar rrugor, në kundërshtim me nenin 49 paragrafi 2 të këtij ligji;

20) vozitësi i autobusit nuk e ka paraqitur kohën e secilës arritje dhe nisje

- të autobusit në stacionin e autobusit (neni 60 paragrafi 3);
- 21) automjeti me të cilin bën transport për nevoja personale nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat nga neni 5 paragrafi 2 të këtij ligji (neni 77 paragrafi 5);
- 22) në automjet nuk ka fletëngarkimi dhe dëshmi prej të cilës mund të konstatohet se bëhet transporti për nevoja personale (neni 79),
- 22-a) nuk ka ruajtur kopje nga leja ndërkombëtare e transportuesit të huaj (neni 70-a paragrafët 1 dhe 3)
- 23) nuk vepron në bazë të vendimit të inspektorit (neni 89 dhe 90);
- 24) inspektorit për komunikacion rrugor nuk i mundëson kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, nuk i jep informata të nevojshme dhe nuk ia vë në shikim dokumentacionin e duhur (neni 93).

Për kundërvajtje nga paragrafi 1, pikat 1, 3, 4, 7 dhe 8 të këtij neni, krahas gjobës, kryerësit do t'i kumtohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim i përkohshëm i kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej 3 muajsh deri në 1 vit.

### Neni 99-a

Gjobe në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik ose juridik, nëse:

- 1) kryen transport publik, transport për nevoja personale transport të lirë ose të veçantë të udhëtarëve dhe transport taksie pa licencë ekstrakt të licencës (neni 4 paragrafi 1 dhe neni 4-a);
- 1)-a kryen transport auto taksi në kundërshtim me aktvendimin nga neni 10-a paragrafi 2 i këtij ligji;" **39**
- "1-b) kryen transport të linjës komunale të udhëtarëve në kundërshtim me kushtet e përcaktuara nga ana e këshillit të komunës, respektivisht të Këshillit të qytetit të Shkupit (neni 22) **40**
- 2) e keqpërdor vërtetimin për anëtarësi dhe kartën e shoferit në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 4 të këtij ligji;
- 3) kryen transport të udhëtarëve në transport komunal transport të veçantë në linjë të lirë të udhëtarëve me elemente të transportit në linjë të udhëtarëve, komunikacionin rrugor ndërrurban dhe ndërkombëtar pa leje (neni 25 paragrafi 1 nenet 19 dhe 44 paragrafi 1);
- 4) kryen transport taksie në kundërshtim me kushtet e përcaktuara nga këshilli komunal, përkatësisht këshilli i Qytetit të Shkupit (neni 54 paragrafi 1);
- 5) kryen transport të udhëtarëve në kundërshtim me nenin 27-a të këtij ligji:
- 6) inspektorit të komunikacionit rrugor nuk i mundëson kryerje të mbikëqyrjes inspektuese, nuk ia jep njoftimet e nevojshme dhe nuk ia paraqet në disponim dokumentacionin e nevojshëm;
- 7) certifikata e gatishmërisë për komunikacion të automjetit (certifikata EKMT) është me afat të skaduar;
- 7-a) nuk posedon certifikatë për shofer autotaksi ose certifikatë për shofer autotaksi të cilën e posedon është me afat të skaduar të vlefshmërisë;
- 8) certifikata për pjesëmarrjen e vozitësve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar është me afat të skaduar;
- 9) transportuesi gjatë kryerjes së transportit auto taksi vepron në kundërshtim me nenin 55 paragrafi 5 të këtij ligji dhe
- 10) vozitësi gjatë transportit të udhëtarëve apo mallit në komunikacionin rrugor të brendshëm apo ndërkombëtar në automjet nuk ka urdhëruhdhëtimi.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni kërkesa për ngritje të procedurës kundërvajtëse, parashtrohet në Ministrinë e Transportit dhe

Lidhjeve para Komisionit për mbajtje të procedurës kundërvajtëse (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

*I shfuqizuar* **41**

Përveç gjobës nga paragrafi 1 këtij neni për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 1 dhe 3 të këtij neni, automjeti i shfrytëzuar për transport me të cilin është kryer kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 1 dhe 3 të këtij neni, merret përkohësisht me asistencë të nëpunësit policor në uniformë në momentin e kryerjes së kundërvajtjes për periudhë prej gjashtë muajsh deri në një vit, e pas lëshimit të aktvendimit për marrje të përkohshme të automjetit nga inspektori i komunikacionit rrugor.

Përveç gjobës nga paragrafi 1 të këtij neni për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 3-a të këtij neni, automjeti i cili është shfrytëzuar për transport autotaksi me të cilin është kryer kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 3-a të këtij neni në merret përkohësisht me asistencë të nëpunësit policor në uniformë në momentin e kryerjes së kundërvajtjes për periudhë prej gjashtë muajsh deri në një vit, e pas dhënies së aktvendimi për marrje të përkohshme të automjetit nga ana e inspektorit për komunikacion rrugor. Në rast të përsëritjes së kundërvajtjes nga ana e kryerësit të njëjtë ose me automjetin e njëjtë, automjeti i cili është shfrytëzuar për transport autotaksi merret në mënyrë të përhershme në pronësi të Republikës së Maqedonisë me asistencë të nëpunësit policor në uniformë në momentin e kryerjes së kundërvajtjes, e pas dhënies së aktvendimit për marrje të përhershme të automjetit nga ana e inspektorit për komunikacion rrugor.

Kundër aktvendimit të inspektorit të komunikacionit rrugor nuk lejohet ankesë.

Kundër aktvendimit të inspektorit të komunikacionit rrugor mund të parashtrohet padi për kontest administrativ në afat prej tetë ditësh nga kryerja e kundërvajtjes.

Padia për kontest administrativ nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit për marrjen e përkohshme dhe në mënyrë të përhershme të automjetit, të miratuar nga inspektori i komunikacionit rrugor.

Shpenzimet që do të krijohen gjatë zbatimit të aktvendimit për marrjen e përkohshme dhe në mënyrë të përhershme të automjetit deri në kalimin e afatit për kthimin e automjetit, bien në llogari të kryerësit të kundërvajtjes.

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 pika 3 të këtij neni transportuesit të huaj i lëshohet urdhër pagesë mandatore në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë, përkohësisht i merret leja e qarkullimit dhe i shqiptohet masë plotësuese ndalim për lëvizje të automjetit në territorin e Republikës së Maqedonisë deri në pagimin e gjobës së shqiptuar. Inspektori për komunikacion rrugor detyrimisht i njofton shërbimet kufitare kompetente për shqiptimin e masës plotësuese ndalim për lëvizje të automjetit në fjalë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

## **Neni 99-b**

Gjobë në shumë prej 200 eurosh me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet vozitësit të automjetit me të cilin bëhet transporti, nëse:

1) hip dhe zbret udhëtarë dhe ngarkon e shkarkon bagazh jashtë stacioneve të autobusëve ose vendqëndrimeve të cilat nuk janë caktuar në orarin e vozitjes (17-a paragrafi 4);

- 2) hip dhe zbret udhëtarë në transportin komunal të linjës në vendqëndrime të autobusëve në kundërshtim me orarin e vozitjes (neni 21 paragrafi 1);
- 2-a) në kryerjen e transport të linjës komunale të udhëtarëve në kundërshtim me kushtet e përcaktuara nga ana e këshillit të komunës, respektivisht të Këshillit të qytetit të Shkupit (neni 22)
- 3) nuk jep llogari fiskale për biletat e shitura në autobus (neni 33 paragrafi 2);
- 4) nuk ndalet në stacionin e autobusëve, përkatësisht në vendqëndrimin e caktuar të theksuar në leje dhe në orarin e vozitjes (neni 35);
- 5) gjatë kryerjes së transportit me auto - taksi të udhëtare në automjetin transportues nuk ka montuar taksimetër të rregullt, të plumbuar dhe bazhduar dhe aparat fiskal (neni 55 paragrafi 1);
- 6) gjatë kryerjes së transportit me auto - taksi nuk e aktivizon taksimetrin dhe çmimin e transportit nuk e ka paguar në bazë të shumës së caktuar në taksimetër (neni 55 paragrafi 2);
- 7) në kulmin e automjetit transportues me të cilin kryhet transporti me auto - taksi nuk është vënë shenja "TAXI" (neni 55 paragrafi 3);
- 8) në vend të dukshëm në automjet nuk ka vënë listën e çmimeve me tarifa të caktuara dhe me ekstraktin e licencës (neni 55 paragrafi 4) dhe
- 9) nuk e vërteton fletudhëtimin në çdo stacion autobusi të lejuar në orarin e vozitjes dhe ekstraktin e licencës (neni 60 paragrafi 3).
- 10) kryen hipje dhe zbritje të udhëtarëve në transportin e veçantë në linjë jashtë stacioneve të lejuara në orarin e udhëtimit;

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni inspektori nga neni 87 i këtij ligji, kryerësit të kundërvajtjes do t'i dorëzojë urdhërpagesë të kundërvajtjes.

Inspektorët nga neni 87 të këtij ligji detyrohen të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara të kundërvajtjes dhe urdhërpagesat e mandatit dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

Në evidencën nga neni 3 të këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës së kundërvajtjes, përkatësisht urdhërpagesa e mandatit që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 3 të këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

### **Neni 99-v**

Për kundërvajtjet nga nenet 96, 97, 98, 99, 99-a, 99-b dhe 99-d të këtij ligji, para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës së kundërvajtjes, inspektori nga neni 87 i këtij ligji do të zbatojë procedurë për barazim. Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen inspektori kryerësit do t'i lëshojë urdhërpagesë të kundërvajtjes për shkak të arkëtimit të gjobës të paraparë për kundërvajtje. Me nënshkrimin në urdhërpagesë konsiderohet se kryerësi i kundërvajtjes pajtohet ta paguajë gjobën e paraparë.

Kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni detyrohet ta paguajë gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimin të urdhërpagesës së kundërvajtjes në llogari të shënuar në urdhërpagesë. Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin e dhënë, do të paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar të përcaktuar në urdhërpagesë.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar në paragrafin 2 të këtij neni, inspektori do të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës së kundërvajtjes para gjykatës kompetente përkatësisht para Komisionit për Mbajtje të Procedurës së Kundërvajtjes (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i formuar nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Komisioni është i përbërë prej dy anëtarëve dhe kryetarit.

Anëtarët e Komisionit duhet të kenë arsim të lartë të kryer dhe përvojë pune së paku dy vjet, kurse kryetari duhet të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës dhe përvojë pune së paku katër vjet.

Kundër aktvendimit të Komisionit mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit përmes organit të kundërvajtjes të Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse.

Inspektorët nga neni 87 i këtij ligji detyrohen të mbajnë evidencë për procedurat e ngritura për barazim dhe për rezultatin e tyre.

### **Neni 99-g**

Mjetet nga gjobat e kumtuara në procedurën mandatore nga inspektorët shtetërorë të komunikacionit rrugor, si dhe mjetet nga gjobat e kumtuara në procedurën për kundërvajtje të ngritur me kërkesë të inspektorëve shtetërorë të komunikacionit rrugor janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Mjetet nga gjobat e kumtuara në procedurën mandatore nga inspektorët e autorizuar të komunave të komunikacionit rrugor ose inspektorët e autorizuar të qytetit të Shkupit të komunikacionit rrugor, si dhe mjetet nga gjobat e kumtuara në procedurën për kundërvajtje me kërkesë të inspektorëve të autorizuar të komunave të komunikacionit rrugor ose inspektorëve të autorizuar të qytetit të Shkupit të komunikacionit rrugor, janë të hyra të komunave ose qytetit të Shkupit.

Mjetet nga gjobat e shqiptuara në procedurë kundërvajtëse të ngritura në bazë të propozimit të kontrollorëve në pajtim me nenin 88 paragrafi 10 të këtij ligji janë të hyra të transportuesit që e mban transportin.

### **Neni 99-d**

Gjobë në shumë prej 50 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik - udhëtar, nëse:

- nuk ka biletë udhëtimi gjatë udhëtimit (neni 17-a paragrafi 1) dhe
- inspektorit të komunikacionit rrugor, nuk ia jep për shikim biletën e udhëtimit (neni 17-a paragrafi 2).

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, për udhëtar vendas kërkesa për ngritjen e procedurës për kundërvajtje paraqitet te Ministria e Transportit dhe Lidhjeve në Komisionin për udhëheqjen e procedurës kundërvajtëse e për udhëtar të huaj gjoba arkëtohet aty për aty.

### **Neni 99-gj**

Gjobë në shumë prej 2.000 deri më 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet përfaqësuesve të autorizuar nga neni 8-gj paragrafi 4 të këtij ligji nëse lejojnë që kandidati të veprojnë në kundërshtim me nenin 8-a paragrafi 12 të këtij ligji.



Me gjobë prej 2000 deri më 3000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohen anëtarët e komisionit nga neni 8-zh paragrafi 4 të këtij ligji nëse përcaktojnë parregullsi në zbatim të provimit, kurse për të nuk e njoftojnë ministrin e Drejtësisë.

Me gjobë prej 2.000 deri më 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohet personi nga neni 8-z paragrafi 2 të këtij ligji që do të lejojë të japë provim kandidati i cili nuk i përmbush kushtet e përcaktuara të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 100 deri më 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kandidatit që vepron në kundërshtim me nenin 8-e paragrafi 12 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit të autorizuar juridik që teknikisht e zbaton provimin nga neni 8-z i këtij ligji nëse nuk e bllokoi shtrirjen e radio frekuencave në lokalitetin për dhënie të provimit.

### **Neni 99-e**

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afatin e përcaktuar në nenin 8 paragrafin (6) dhe neni 69 paragrafi 6 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar në komunë, përkatësisht Qytetin e Shkupit nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afatin e përcaktuar në nenin 8 paragrafin 7 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dëshmitë nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në afatin e përcaktuar në nenin 8 paragrafin 8 dhe neni 69 paragrafi 7 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, komunë, përkatësisht Qytetin e Shkupit, nëse nuk vendos për kërkesën për licencë në afatin e përcaktuar në nenin 8 paragrafin 9 dhe neni 69 paragrafi 8 të këtij ligji.

Për kundërvajtjet nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni procedurë të kundërvajtjes mban dhe sanksion të kundërvajtjes shqipton gjykata kompetente.

## **XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 100**

Personat juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë transport publik të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin e brendshëm dhe komunikacionin rrugor ndërkombëtar, janë të obliguar që në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të paraqesin kërkesë për marrjen e licencës.

Në qoftë se personat, në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk paraqesin kërkesë për marrjen e licencës, organi kompetent do të marrë vendim për pushim të veprimtarisë.

Licencat të cilat janë lëshuar para hyrjes së këtij ligji në fuqi, vazhdojnë të vlejnjë deri në skadimin e afatit për të cilin janë lëshuar

### **Neni 100-a**

Personat të cilët kanë së paku 5 vjet përvojë pune në transport si drejtues ose personi i autorizuar, përgjegjës për transport dhe arsim sipëror, lirohen nga dhënia e provimit për marrjen e certifikatës për kompetencë profesionale.

### **Neni 101**

Transporti në linjë i udhëtarëve në komunikacionin e brendshëm rrugor do të bëhet në pajtim me orarin ekzistues të udhëtimit të regjistruar, më së voni në afat prej një viti nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Lejet për kryerjen e transportit në linjë ndërkombëtar të udhëtarëve dhe lejet për transportin e mallrave, të lëshuara para hyrjes së këtij ligji në fuqi, do të vlejnjë deri në skadimin e kohës për të cilën janë lëshuar.

### **Neni 102**

Rregullat më të përafërta sipas këtij ligji, do të nxirren në afat prej një viti nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Deri në hyrjen në fuqi të rregullave nga paragrafi 1 të këtij neni, do të zbatohen rregullat që kanë qenë në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 103**

Me ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, pushon të vlejë Ligji për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 63/1995 dhe 29/1998).

### **Neni 104**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

#### **DISPOZITA NGA LIGJE TJETËR**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 127/2006):

#### **Neni 46**

Rregullat më të përafërta të parapara me këtë ligj do të nxirren në afat prej gjashtë muajsh prej ditës së hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 114/2009 dhe 83/2010):

#### **Neni 64**

Personat juridikë dhe fizikë që bëjnë transport publik të

udhëtarëve dhe mallrave dhe transport të nevoja personale në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar, janë të obliguar që në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ta harmonizojnë punën e tyre në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Personat juridikë dhe fizikë të cilët bëjnë transport publik të udhëtarëve dhe të mallrave dhe transport për nevojat personale në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar nëse në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni nuk do ta harmonizojnë punën e tyre në pajtim me dispozitat e këtij ligji, organi kompetent do të miratojë aktvendim për pushimin e veprimtarisë.

Licencat që janë lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejnjë deri në skadimin e afatit për të cilin janë lëshuar.

#### **Neni 65**

Licenca për kryerjen e transportit me auto-taksi të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të vlejnjë më së shumti në afat prej katër vjetësh nga dita e lëshimit të licencave.

#### **Neni 66**

Procedurat për lëshimin ose për vazhdimin e lejeve për transport ndërkombëtar të linjës së udhëtarëve të filluara para 1 janarit 2008, nëse nuk mbarojnë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të njëjtat do të miratohet aktvendim për tërheqjen dhe shlyerjen e lejeve nga regjistri i orarit të vozitjes dhe lejeve.

Linjat sezonale të cilat janë mbajtur me orarin e vozitjes dhe të cilat janë harmonizuar në Odën Ekonomike, e për të cilat transportuesi me kohë ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e tyre, mund të vazhdohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Për vazhdimin e linjave nga paragrafi 2 i këtij neni transportuesi është i obliguar të parashtojë kërkesë të re.

#### **Neni 67**

Personi juridik ose fizik i cili udhëheq me stacionin e autobusëve është i obliguar që në afat prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, t'i paraqesë Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve kërkesë për kategorizimin e stacionit të autobusëve.

Nëse personi juridik ose fizik i cili udhëheq me stacionin e autobusëve nuk parashtron kërkesë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, ministri i Transportit dhe Lidhjeve do të formojë komision për kategorizimin e stacionit të autobusit dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara për kategorizimin e stacioneve të autobusëve do të miratojë aktvendim për kategorizim.

Nëse stacioni i autobusit nuk i plotëson kushtet për asnjë kategori nga neni 57 paragrafi 4 dhe 5 të këtij ligji, me raport paraprak të komisionit për kategorizim nga paragrafi 2 të këtij neni, ministri mund të miratojë aktvendim për mbylljen e stacionit të autobusit deri në plotësimin e kushteve për kategorizimin e tij në ndonjërin nga kategoritë e nenit 57 paragrafi 4 të këtij ligji.

#### **Neni 68**

Transportuesit të cilët në pajtim me dispozitat e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta zyrtare e

Republikës së Maqedonisë" numër 68/2004 dhe 127/2006) kanë fituar të drejta dhe obligime (leje, aktvendime dhe akte të tjera), mund të paraqiten në cilësinë e themeluesit të subjektit të ri juridik me veprimtari parësore/shifra kryesore e të ardhurave adekuate me veprimtarinë të cilën do ta kryejë, me ç'rast të gjitha të drejtat dhe obligimet (lejet, aktvendimet dhe aktet tjera) të cilat dalin nga veprimtaria të cilën do ta kryejë subjekti i ri, e të cilat i ka fituar firma themeluese mund t'i barten firmës së porsaformuar.

Subjekti i sapoformuar paraqet kërkesë për marrjen e licencës në pajtim me veprimtarinë parësore/shifra kryesore e të ardhurave për të cilën është regjistruar ose që është evidentuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

#### **Neni 69**

Dispozitat më të afërta të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 83/2010):

#### **Neni 31**

Dispozita nga neni 5 paragrafi 1 i këtij ligji, do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 83/2010):

#### **Neni 32**

Certifikatat për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar, të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vlejnjë për periudhën prej pesë vitesh nga dita e lëshimit të tyre.

#### **Neni 33**

Transportuesit për të cilët vijon procedura e falimentimit dhe është miratuar plani për riorganizim nga gjykata themelore, e të cilët kanë marrë leje për kryerjen e transportit rrugor të udhëtarëve para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për vazhdimin e vlefshmërisë së lejeve, mund të dorëzojnë kërkesë në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Transportuesit për të cilët rrjedh procedura e falimentimit, mund të parashtrajnë kërkesë për marrjen e licencës, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për transportuesit nga paragrafi 2 i këtij neni që do të parashtrajnë kërkesë për licencë, nuk zbatohen dispozitat nga neni 8 paragrafi 1 pikat 3 dhe 7.

#### **Neni 34**

Procedurat për lëshimin ose vazhdimin e lejes për transport të udhëtarëve në linja ndërkombëtare të filluara para 1 janarit 2009, nëse nuk përfundojnë në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të njëjtat do të miratohet aktvendim për heqjen dhe shlyerjen nga regjistri i orareve të udhëtimit dhe lejeve.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/2010):

**Neni 21**

Dispozitat më të përlefërta të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2011):

**Neni 11**

Dispozitat nga neni 8 paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji, nuk zbatohen për personat juridikë të cilët në bazë të Marrëveshjes për koncesion e kanë fituar të drejtën për shfrytëzimin e automjeteve, përkatësisht personi juridik mund të jete shfrytëzues i automjeteve.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2011):

**Neni 12**

Dispozita nga neni 8-v paragrafi 1 i këtij ligji do të filloje të zbatohet nga 1 shtatori 2011.

**Neni 13**

Dispozitat nga nenet 1, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2011):

**Neni 16**

Personat juridikë dhe fizikë të cilët organizojnë transport të mallrave dhe\ose udhëtarëve në komunikacionin rrugor të brendshëm ose ndërkombëtar duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

**Neni 17**

Akti nënligjor nga nenet 6 paragrafi 4 dhe 11 paragrafët 4 dhe 21 i këtij ligji, do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2011):

**Neni 19**

Dispozitat e nenit 6 të këtij ligji me të cilat ndryshohet neni 10 paragrafi 9 dhe dispozitat e nenit 17 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit shtetëror për vendimmarrje në procedure administrative dhe procedurë për marrëdhënie të punës në shkallë të dytë.

**Neni 20**

Dispozitat e nenit 6 të këtij ligji, kryetarët e komunave

dhe kryetari i qytetit të Shkupit do t'i zbatojnë nga 1 shtatori 2011.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2012):

**Neni 21**

Marrëveshjet e lidhura në pajtim me nenin 23 të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 68/2004, 127/2006, 114/2009, 83/10, 140/10, 17/11 dhe 53/11) vazhdojnë të zbatohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në afatin për të cilën janë lidhur, por më së voni deri më 1 qershor 2012.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2012):

**Neni 22**

Dispozita nga neni 10 i këtij ligji do të zbatohet nga 1 janari 2012.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2013 dhe 187/2013):

**Neni 35**

Transportuesit për të cilët vijon procedura e falimentimit dhe ka plan të miratuar për riorganizim, e të cilët kanë marre leje për transport të udhëtarëve në linjë para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për vazhdimin e vlefshmërisë së lejeve mund të parashtrojnë kërkesë në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Transportuesit për të cilët vijon procedura e falimentimit mund të parashtrojnë kërkesë për marrje të licencës në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për transportuesit nga paragrafi 2 i këtij neni që do të parashtrojnë kërkesë për licencë, nuk zbatohen dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 pikat 1, 3, 7 dhe 8 të këtij ligji.

**Neni 36**

Personat juridikë të autorizuar për aftësim profesional të kandidateve për marrje të certifikatës për kompetencë profesionale të drejtorit ose personit të autorizuar përgjegjës për transport dhe për aftësim profesional të vozitësve për marrje të certifikatës për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, në afat prej një viti detyrohen të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji.

Procedurat e filluara për marrje të autorizimit për aftësim profesional të kandidateve për marrje të certifikatës për kompetencë profesionale të drejtorit ose personit të autorizuar përgjegjës për transport dhe aftësim profesional të vozitësve për marrje të certifikatës për pjesëmarrje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, do të vazhdojnë të zbatohen sipas dispozitave të këtij ligji.

**Neni 37**

Stacionet e autobusëve detyrohen që në afat prej një viti nga hyrja në fuqi të këtij ligji ta harmonizojnë punën e tyre sipas dispozitës së nenit 32 paragrafi 2 të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji.

Nëse inspektori shtetëror për komunikacion rrugor konstaton se stacioni i autobusit nuk ka filluar me shitjen e biletave të udhëtimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni te ministri i Transportit dhe Lidhjeve do të parashtrrojë propozim për përjashtimin e kategorizimit të stacionit të autobusëve.

### **Neni 38**

Vozitësit që kanë marrë leje për kryerje të trajnimit plotësues për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës për pjesëmarrje të vozitësve në transportin ndërkombëtar rrugor para hyrjes në fuqi të këtij ligji, pas kalimit të vlefshmërisë së certifikatës ekzistuese për pjesëmarrje të vozitësve në transportin ndërkombëtar, mund ta vazhdojnë vlefshmërinë e së njëjtës pa e dhënë provimin dhe pa poseduar vërtetim për provimin e dhënë për pjesëmarrje të vozitësve në transportin ndërkombëtar. Gjatë paraqitjes së kërkesës për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës, vozitësit detyrimisht paraqesin vërtetim për kryerjen e trajnimit plotësues për vazhdimin e certifikatës për pjesëmarrje të vozitësve në transportin ndërkombëtar të lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 39**

Lejet për kryerje të transportit të udhëtarëve të lëshuara sipas marrëveshjeve të lidhura në pajtim me nenin 23 të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 68/2004, 127/2006, 114/2009, 83/10, 140/10, 17/11 dhe 53/11), vazhdojnë të vlejné pas hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në afatin për të cilin janë lidhur, por më së voni deri më 1 shtator 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

### **Neni 8**

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 9**

Personat të cilët deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji kanë filluar me dhënien e provimeve të parashikuara me këtë ligj, do të japin provim sipas rregullave në fuqi deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

### **Neni 10**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa neni 1 do të fillojë të zbatohet pas një viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa nenet 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji 2014.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 187/2013):

**Neni 25**

Dorëzimi i njoftimeve dhe vendimeve të Komisionit për vendosje për kundërvajtje kryhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Nëse vendbanimi i personit të cilit njoftimi ose vendimi duhet t'i dorëzohet është i panjohur për organin shkresa e të cilit dorëzohet ose personi është shpërngulur, Komisioni për vendosje për kundërvajtje do ta vendosë njoftimin, respektivisht vendimin në tabelën e shpalljeve në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe me skadimin e tetë ditëve nga dita e vendosjes në tabelën e shpalljeve në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve do të konsiderohet se dorëzimi është i rregullt.

**Neni 26**

Licencat për organizimin e transportit të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejnjë deri në skadimin e afatit për të cilin janë lëshuar si licenca për organizimin e transportit të mallit.

**Neni 27**

Procedurat e filluara për lëshimin e lejes për transport të veçantë në linjë para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

**Neni 28**

Deri në fillimin e transportit në pajtim me nenin 22-a të këtij ligji, transporti në Qytetin e Shkupit dhe Komunat Haraçinë, Zelenikovë, Ilinden, Petrovec, Sopishtë, Studeniçan dhe Çuçer Sandevë do të zbatohet në pajtim me Vendimin për transport publik urban dhe ndërurban (periferik) të udhëtarëve në Qytetin e Shkupit ("Fletore Zyrtare e Qytetit të Shkupit numër 6/99, 16/99, 11/2000, 12/2000, 9/2003, 12/2003, 5/2007, 9/2009, 7/10, 15/10, 1/11, 4/11 dhe 9/12).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 187/2013):

**Neni 29**

Dispozita nga neni 8 paragrafi 1 pika 4 të këtij ligji për posedimin e certifikatës ndërkombëtare për njohjen e gjuhës angleze në nivel A1 sipas Kornizës së përbashkët referente evropiane për gjuhët (CEFR) të Këshillit të Evropës do të zbatohet nga 1 janari 2017, ndërsa për posedimin e certifikatës ndërkombëtare për njohjen e gjuhës angleze në nivel A2 sipas Kornizës së përbashkët referente evropiane për gjuhë (CEFR) të Këshillit të Evropës do të zbatohet nga 1 janari 2019.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/2014):

**Neni 21**

Personat juridikë që posedojnë licenca për kryerje të veprimtarisë autotaksi dhe shoferët e punësuar te ata persona të cilit kanë marrë licencë për kryerje të



veprimtarisë autotaksi para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji në afat prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

**Neni 22**

Komisioni nga neni 8-z paragrafi 3 i përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji do të formohet në afat prej tri ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

**Neni 23**

Bujqit individual të regjistruar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave janë të obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të parashtrojnë kërkesë në pajtim me nenin 9-v paragrafi 1 të këtij ligji për marrje të vërtetimi për kryerje të transportit.

**Neni 24**

Aktet nënligjore të paraparë me këtë ligj do të miratohen në afat prej një muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 25**

Drejtori i Inspektoratit shtetëror për transport i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 17 të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin deri në përfundim të mandatit për të cilin është emëruar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/2014):

**Neni 26**

Dispozitat e nenit 17 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kushtet për njohje të gjuhës së huaj të cilat do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 112/2014):

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2015.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 166/2014):

**Neni 16**

Dispozita nga neni 1 i këtij ligji me të cilën neni 8 plotësohet me paragrafin e ri 2 do të fillojë të zbatohet nga 1 prilli 2015.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/2015):

**Neni 18**

Personat juridikë që kanë marrë licencë për kryerje të veprimtarisë auto taksi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji më së voni deri më 1 nëntor 2015.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/2015):

**Neni 19**

Dispozita nga neni 12 i këtij ligji do të fillojë të zbatohet nga dita e fillimit të zbatimit të Ligjit për ndalim dhe pengim të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 199/14).

Dispozita nga neni 15 i këtij ligji do të fillojë të zbatohet me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për themelimin e komisionit shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/14).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 97/2015 dhe 71/2016):

**Neni 10**

Certifikatat ekzistuese të vlefshme për pjesëmarrje të shoferëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar do të vlejnjë deri në kalimin e afatit për të cilin janë lëshuar certifikatat ekzistuese.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

**Neni 7**

Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes dhe urdhërpagesës mandatore i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

**Neni 8**

Gjatë matjes së gjobave për kundërvajtjet zbatohen dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

**Neni 9**

Akti nënligjor i përcaktuar në këtë ligj do të miratohet më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

**Neni 10**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/2016):

**Neni 18**

Procedurat të filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/2016):

**Neni 19**

Dispozitat e neneve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 15 dhe 17 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2016):

**Neni 37**

Personat juridikë nga neni 69 paragrafi 4 të këtij ligji të cilët kanë marrë autorizim për lëshimin e certifikatës për gatishmëri për qarkullim të automjeteve deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat nga ky ligj më së voni deri më 1 shtator 2017.

**Neni 38**

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transport në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2016):

**Neni 41**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".